INSTITUTI
DEMOKRATIK
I KOSOVËS

NUR ÇEKU
LOTTE ROOIJENDIJK

LIGJI Nr. 065/L-085 PËR MBROJTJEN E SINJALIZUESVE

KOMENTAR

Botimi 1

Prishtinë, 2021

Nur Çeku / Lotte Rooijendijk

Komentar

Botimi 1

LIGJI Nr. 065/L-085 PËR MBROJTJEN E SINJALIZUESVE

I publikuar nga

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)

Autorët:

Nur Çeku & Lotte Rooijendijk

COPYRIGHT © 2021. Kosova Democratic Institute (KDI)

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jo komercialë. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Publikimi i këtij Kometari është bërë i mundur me përkrahjen e Ambasadës Holandeze në Kosovë. Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit. KDI-ja është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni www.kdi-kosova.org.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë: Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45, 10 000, Prishtinë, Kosovë. Tel.: +383 (0)38 248 038 E-mail: info@kdi-kosova.org Ueb: www.kdi-kosova.org

Falënderim:

Përfitojmë nga rasti të falënderojmë Institutin Demokratik të Kosovës (KDI) për besimin e dhënë si dhe për ndihmën profesionale dhe bashkëpunimin e shkëlqyer gjatë punës për përpilimin e Komentarit të Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve.
Falënderojmë zyrtar nga institucionet publike dhe subjektet private, përfaqësues të shoqërisë civile, avokatë, prokurorë, gjyqtarë, ekspertë të sundimit të ligjit dhe fushës së drejtësisë nga të cilët kemi marrë komente dhe sugjerime të vlefshme, dhe për ketë u jemi shumë mirënjohës.

Autorët

Fjala e Autorëve

Zhvillimi ekonomik, sundimi i ligjit, integriteti institucional dhe perspektiva euroatlantike janë aspiratat kryesore të shoqërisë kosovare. Avancimi i shtetit të së drejtës, mirëqenies sociale, përmirësimi i shërbimeve publike dhe private si dhe jetësimi i perspektivës integruese arrihen vetëm kur të gjithë qytetarët janë në shërbim të këtij misioni. Institucionet publike kanë përgjegjësinë më të madhe, mirëpo askush nuk duhet të shmanget nga përgjegjësia qytetare për të kontribuar. Një nga parimet kyçe të shtetit të së drejtës është parimi i ligjshmërisë, sipas të cilit, veprimet e institucioneve dhe qytetarëve duhet të jenë në pajtim me kornizën ligjore. Shteti konsiderohet si zgjatim i komunitetit dhe interesi i këtij komuniteti, në raste të caktuara, mbizotëron në raport me interesat individuale. Interesi i përgjithshëm ose publik jo rrallë herë dëmtohet përmes shkeljeve ligjore si korrupsioni, krimi i organizuar, keqadministrimi i drejtësisë, klientelizmi, degradimi i mjedisit, diskriminimi, nepotizmi, keqpërdorimi i parasë publike dhe pronës publike, punësimet jo-meritore në sektorin publik, etj. Dëmtimi i interesit publik ka për pasojë edhe dëmtimin e interesave individuale të njerëzve dhe të komunitetit.

Praktikat dyshuese, veprimet e dëmshme dhe shkeljet ligjore të cilat dëmtojnë interesin publik, nuk ndodhin vetvetiu apo si pasojë e ndonjë fuqie madhore *(Vis maior)* e të cilat nuk mund të parashikohen apo parandalohen. Këto veprime janë produkt i një "inxhinieringu njerëzor" të cilat kalojnë përmes një procesi ideimi dhe materializimi. Si të tilla, ato shpesh 'mbulohen' shumë mirë pas rregullave dhe procedurave, me ç'rast zbulimi apo të provuarit e tyre është i vështirë. Të punësuarit në sektorin publik dhe privat kanë mundësinë të shohin veprimet përgatitore dhe kryerjen e shkeljeve të tilla në dëm të interesit publik. Raportimi i këtyre veprimeve është shumë i rëndësishëm, pasi pengon ekzekutimin e tyre dhe, rrjedhimisht, shkaktimin e pasojave. Me qëllim të parandalimit në fazat e hershme të shkeljeve të cilat konsiderohen se dëmtojnë interesin publik, shtetet kanë miratuar legjislacionin përkatës i cili mundëson që i tërë komuniteti i të punësuarve në sektorin publik dhe privat të raportojnë apo shpalosin shkeljet e ndryshme në kontekstin e marrëdhënieve të tyre të punës. Për më shumë, ky legjislacion mbron dhe garanton të drejtat e personave që raportojnë për veprimet e tilla nga çdo formë e hakmarrjes ndaj tyre.

Edhe Kosova ka miratuar ligjin e veçantë që garanton mbrojtjen e personave që raportojnë dhe shpalosin shkeljet e ndryshme të cilat mund të dëmtojnë interesin publik. Ky ligj ka integruar standardet ndërkombëtare dhe vlerësohet se do të shërbejë si mjet efikas në parandalimin e shkeljeve në sektorin publik dhe privat. Zbatimi i këtij ligji është, pa dyshim, një sprovë për institucionet kosovare, për sektorin privat dhe për qytetarët aktivë e të përkushtuar në mbrojtjen e interesit publik. Jeta e një ligji nuk nënkupton të qenit në fuqi në aspektin formal por zbatimi i tij efikas në jetën e përditshme. Të punësuarit në sektorin publik dhe privat mund të luajnë rol aktiv në zbulimin dhe parandalimin e shkeljeve ligjore përmes sinjalizimit. Megjithatë, zbatimi i suksesshëm i ligjit parashtron domosdoshmërinë që njerëzit ta kuptojnë si duhet përmbajtjen e dispozitave të tij. Çdo i punësuar në sektorin publik apo privat, para se të raportojë apo shpalosë informacione rreth shkeljeve ligjore, veprimeve të dëmshme apo praktikave të dyshimta, duhet të ketë njohuri rreth procedurave se si mund ta bëjë këtë. Në të njëjtën kohë, është shumë me rëndësi që sinjalizuesit potencialë të kenë njohuri edhe rreth mbrojtjes ligjore që atyre iu garantohet në rast të përballjes me pasoja eventuale hakmarrëse dhe/apo veprimeve tjera të dëmshme kundër tyre.

Misioni i zbatimit efikas të dispozitave ligjore përmbushet nëse ato kuptohen dhe zbërthehen drejtë. Në funksion të zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve është edhe ky Komentar që prezantohet në vijim dhe i cili ka për qëllim themelor të lehtësojë të kuptuarit e dispozitave të ligjit. Komentari, në rend të parë, u drejtohet komunitetit të të punësuarve në sektorin publik dhe privat, të cilët mund të ndeshen me shkelje të ndryshme dhe që kanë vullnetin për t'i sinjalizuar ato. Duke njohur përmbajtjen dhe kuptimin e dispozitave ligjore, komuniteti i të punësuarave do të krijojë siguri lidhur me procedurën e sinjalizimit si dhe të mbrojtjes së tyre nga pasojat potenciale që mund të kenë si rezultat i sinjalizimit. Por në të njëjtën kohe, Komentari mund të shërbejë si një instrument i dobishëm edhe për zytaret përgjegjës, institucionet publike, subjeket private lidhur me procedurat për zbatimin e dispozitave të këtij Ligji.

- Teksti i komentimit të neneve dhe vështrimi i përgjithshëm është përpiluar nga autori vendor, Nur Çeku.

- Teksti për praktikat më të mira ndërkombëtare është përpiluar nga Lotte Rooijendijk nga "Transparency International" Holandë.

Si autorë të këtij Komentari, ne jemi të vetëdijshëm se ky ligj është në fillim të zbatimit të tij, andaj praktikimi i ndonjë dispozite mund të jetë ndryshe nga përmbajtja e komentimit të tij. Ne mirëpresim çdo sugjerim profesional me qëllimin e mirë dhe që mund të kontribuojë në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe avancimit të zbatimit të Ligjit.

Nur Çeku
Lotte Rooijendijk
Prishtinë/Amsterdam 2021

PËRMBAJTJA

Falënderim: 5
Fjala e Autorëve 7
Literatura: 11
Lista e shkurtesave 16
Vështrim i përgjithshëm 17
1. E drejta e lirisë së shprehjes dhe sinjalizimit 17
2. Të drejtat dhe liritë e njeriut në sistemin ligjor të Kosovës 19
3. Sfondi i Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve 21
Udhëzues për përdorimin e Komentarit 22
KAPITULLI I - Dispozitat Themelore 23
Neni 1 - Qëllimi 23
Neni 2 - Fushëveprimi 24
Neni 3 - Përkufizimet 27
Neni 4 - Parimet e përgjithshme të detyrave dhe përgjegjësive të zyrtarit përgjegjës 32
KAPITULLI II - Sinjalizimi, të Drejtat dhe Mbrojtja e Sinjalizuesve 35
Neni 5 - Raportimi dhe shpalosja e mbrojtur 35
Neni 6 - Ndalimi i pengimit të sinjalizimit 38
Neni 7 - Të drejtat e sinjalizuesit 40
Neni 8 - Të drejtat e personit të lidhur me sinjalizimin 42
Neni 9 - Mbrojtja e sinjalizuesve 43
Neni 10 - Ndalimi i keqpërdorimit të sinjalizimit 45
Neni 11 - Konfidencialiteti 47
Neni 12 - Mbrojtja e të dhënave personale të sinjalizuesit 50
KAPITULLI III - Llojet dhe Procedura e Sinjalizimit 51
Neni 13 - Llojet e sinjalizimit 51
Neni 14 - Forma dhe përmbajtja e sinjalizimit 52
Neni 15 - Pranimi dhe evidentimi i sinjalizimit 54
Neni 16 - Sinjalizimi i brendshëm 55
Neni 17 - Obligimet e punëdhënësit 58
Neni 18 - Sinjalizimi i jashtëm 60
Neni 19 - Sinjalizimi i jashtëm në sektorin privat 63
Neni 20 - Sinjalizimi publik 64
Neni 21 - Sinjalizimi lidhur me sigurinë kombëtare, mbrojtjen, inteligjencën dhe marrëdhëniet ndërkombëtare 67
Neni 22 - Mbrojtja nga veprimet e dëmshme 70
Neni 23 - Dëmshpërblimi në rast të veprimeve të dëmshme 72
KAPITULLI IV - Procedura Gjyqësore 74
Neni 24 - Mbrojtja gjyqësore 74
Neni 25 - Barra e provës 76
Neni 26 - Sigurimi i kërkesëpadisë dhe masa e sigurimit 77
Neni 27 - Dispozitat kundërvajtëse 79

KAPITULLI V - Dispozitat Kalimtare dhe Përfundimtare 82
Neni 28 - Vetëdijësimi i të punësuarve 82
Neni 29 - Raporti vjetor 83
Neni 30 - Aktet nënligjore..... 84
Neni 31 - Shfuqizimi..... 85
Neni 32 - Hyrja në fuqi 86

Literatura:

1. Allan Rosas & Martin Scheinin, "Kategoritë e të Drejtave të Njeriut dhe Përfituesit e Tyre," Rija Hanski & Markku Suksi ed., *"Hyrje në Mbrojtjen Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut"*(versioni shqip botuar nga Projekti Finlandez për të Drejtat e Njeriut, Prishtinë 2000).
2. Arron Phillips and David Lewis*,"Whistleblowing to Regulators: Are Prescribed Persons Fit for Purpose?"* (Middlesex: University Research Repository Project Report, 2013). https://minhalexander.files.wordpress.com/2018/08/whistleblowing-to-regulators-are-prescribed-persons-fit-for-purpose-david-lewis-2013.pdf.
3. Ashley Savage *"Whistleblowers for change: the social and economic costs and benefits of leaking and whistleblowing"*(Open Society Foundations, 2018).
4. Australi, Akti i Punës Fer (2009). Australi, www.legislation.gov.au/Details/C2017C00147.
5. Bahri Beqiri dhe Nur Çeku, "Hyrje në Politikat e Sigurisë" (Prishtinë, 2016) fq. 37.
6. Bahrie Lecaj, "*Komunikimi efektiv përmes postës elektronike – Email,*" (USAID, dhjetor 2013) http://naserkastrati.weebly.com/uploads/3/8/8/3/38831473/komunikimi-efektiv-permes-email_final_january-2014.pdf/.
7. Benjamin Buckland and Aidan Wills, "*Blowing in the Wind,Whistleblowing in the Security Sector"* (DCAF, 2013) https://www.right2info.org/resources/publications/pretoria-finalization-meeting-april-2013-documents/whistleblowing-and-security-sector-buckland-and-wills.
8. Blueprint for Free Speech, (2016), https://www.blueprintforfreespeech.net/en/library/reports.
9. Civil Law Convention of the Council of Europe on Corruption
10. Council of Europe, *"Protection of Whistleblowers: A Brief Guide for Implementing a National Framework",* (2015). https://rm.coe.int/16806fffbc
11. Council of Europe, *"Recommendation CM/Rec(2014)7 and explanatory memorandum"* (2014), fq.30.
12. Dajana Kumbaro "Hyrje në të Drejtën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut," Kapitulli I, në Qerim Qerimi dhe Gentian Zyberi *"E Drejta Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut"* (Prishtinë, 2015).
13. Daniele Santoro & Manohar Kumar, "Speaking Truth to Power A Theory of Whistleblowing," (Springer International Publishing AG, part of Springer Nature 2018).
14. DavidBanisar,"*Whistleblowing:InternationalStandardsandDevelopments"*(2011). *https://papers.ssrn.com/sol3/Delivery.cfm/SSRN_ID1753180_code1573110.pdf?abstractid=1753180&mirid=1.*
15. Deklarata e Pavarësisë së Republikës së Kosovës (2008).
16. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (1948).
17. Direktiva e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Bashkimit Evropian për Mbrojtjen e Personave që raportojnë shkeljen e Ligjit në Bashkimin Evropian. Bruksel, 25 shtator 2019.
18. Enver Hasani, "E Drejta Kushtetuese dhe të Drejtat e Njeriut - Parimet dhe Institucione" në "*Hyrje në Sistemin Ligjor në Kosovë*" (Prishtinë, 2019, Akademia e Drejtësisë)

19. EQS Group, ”*Whistleblowing Report”* (2019).https://www.eqs.com/en-us/compliance-knowledge/white-papers/whistleblowing-report-2019/.
20. Flutura Kusari, ‘*Whistleblowers in Kosovo Struggle for Protection’.* Southeast European Coalition on Whistleblower Protection, (9 September 2016). https://see-whistleblowing.org/whistleblowers-in-kosovo-struggle-for-protection/
21. Flutura Kusari, Sinjalizuesi i dyfishtë Thaçi. https://sbunker.net/teh/42789/sinjalizuesi-i-dyfishte-thaci/.
22. Francis Fukuyama, *‘Ndërtimi i shtetit’ (Botimi shqip,* Tiranë*,* 2010).
23. Global Principles on National Security and the Right to Information” (2013, South Africa)
24. Government Accountability Project (GAP), International Best Practice for Whistleblower Policies,(2016).
25. GJEDNJ, Dichand dhe të tjerët kundër Austrisë, 26 shkurt 2002.
26. GJEDNJ, Guja v. Moldova.
27. GJEDNJ, Matúz v. Hungary and Görmüş a.o. v. Turkey.
28. GJEDNJ, Şener kundër Turqisë, 18 korrik 2000.
29. GJEDNJ, Zana kundër Turqisë, 25 Nëntor 1997.
30. Gjykata Kushtetuese e Kosovës, AKTGJYKIM në rastin nr. KO54/20.
31. Harris Interactive, *“Lanceurs d’alerte”: quelle perceptimi de la part des salariés* ?(2015), fq.9. http://harris-interactive.fr/wp-content/uploads/sites/6/2015/12/Rapport-Harris-Perception-des-lanceurs-dalerte-Transparency-International-France-Tilder.pdf.
32. Haxhi Xhemajli*,”Interim Measures for Securing the Claim in Civil Proceedings in Kosovo: Legal and Practical Aspects,”* (Balkan Social Science Review, 2020 Skopje) https://js.ugd.edu.mk/index.php/BSSR/article/view/3977/3565
33. Hayden Teo and Donella Caspersz, “*Dissenting discourse: Exploring alternatives to the whistleblowing/silence dichotomy”,* Journal of Business Ethics, 104(2), 2011. https://whistleblower.org/international-best-practices-for-whistleblower-policies/ https://www.unodc.org/documents/corruption/Publications/2015/15-04741_Person_Guide_eBook.pdf/
34. Human Rights, Office of the Hight Commissioner. https://www.ohchr.org/EN/Issues/Pages/WhatareHumanRights.aspx.
35. International Organization for Standardization,*“Whistleblowing management systems –Guidelines no. ISO/DIS 37002”*. https://www.iso.org/obp/ui/#iso:std:iso:37002:dis:ed-1:v1:en.
36. Janet Smith DBE, The Shipman Inquiry, Fifth Report - Safeguarding Patients: Lessons from the Past - Proposals for the Future (2004).
37. John Stuart Mill, *On Liberty,* (ed.by David Bromwich and George Kateb: Yale University Press, New Haven and London, 2003).
38. Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian (2000).
39. Kate Kenny, Wim Vandekerckhove, and Marianna Fotaki, “*The Whistleblowing Guide, Speak-up Arrangements, Challenges, and Best Practices”,* (First published in 2019, UK).
40. Kodi Nr. 06/l-074 Penal i Republikës së Kosovës/Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 2 /14 janar 2019, Prishtinë.
41. Kombet e Bashkuara, “*Promotion and protection of the right to freedom of*

opinion and expression" (2015) https://digitallibrary.un.org/record/805706/files/A_70_361-EN.pdf.
42. Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut.
43. Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore (1950).
44. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (1966).
45. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Sociale dhe Ekonomike dhe Kulturore (1966).
46. Krenar Gashi, "*Kosovo: The Republic without Whistleblowers.* Balkan Investigative Reporting Network and Southeast Europe Coalition on Whistleblower Protection (2016). https://see-whistleblowing.org/kosovo-the-republic-without-whistleblowers/
47. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (2008).
48. Lëvizjes FOL"*Doracak me 10 skenarë të reagimit për rastet e sinjalizimit në sektorin privat,"*(Prishtinë,2020).https://levizjafol.org/wp-content/uploads/2020/11/Doracak-me-10-skenar%C3%AB-t%C3%AB-reagimit-p%C3%ABr-rastet-e-sinjalizimit-n%C3%AB-sektorin-privat.pdf.
49. Ligji Nr 03/l-025 për Mbrojtjen e Mjedisit. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, /Nr.65/05 shkurt 2010, Prishtinë.
50. Ligji Nr. 01, 02 -02010-39/13, date 16.12. 2013 për mbrojtjen e personave që raportojnë korrupsion në institucionet e Bosnje dhe Hercegovinës. http://sps.gov.ba/dokumenti/korupcija/Korupcija_zakon.pdf .
51. Ligji Nr. 02/L—37 për Përdorimin e Gjuhëve; Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë / Prishtinë: Viti II / Nr. 10 / 01 mars 2007.
52. Ligji Nr. 03/L- 159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, /Nr.65/05 shkurt 2010, Prishtinë.
53. Ligji Nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti III / Nr. 26 / 02 qershor 2008.
54. Ligji Nr. 04/l-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë / Nr. 16 / 19 Qershor 2012.
55. Ligji Nr. 04/L-184 për Administrimin e Punës në Zyrë. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 18 / 28 maj 2013, Prishtinë.
56. Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ / Nr. 16 / 26 qershor 2015, Prishtinë.
57. Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Nr. 20/21/ Qershor 2016. Prishtinë.
58. Ligji Nr. 05/l-087 për Kundërvajtje / Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 33 /8 shtator 2016, Prishtinë.
59. Ligji Nr. 06/ 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 6/25 shkurt 2019, Prishtinë.
60. Ligji Nr. 06/L -016 për Shoqëritë Tregtare/ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 9 / 24 Maj 2018, Prishtinë.
61. Ligji Nr. 06/L- 054 për Gjykatat / Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 22 /18 dhjetor 2018, Prishtinë.
62. Ligji Nr. 06/l -113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Nr.7/ 01 mars 2019, Prishtinë.

63. Ligji nr. 06/l -114 për Zyrtarët Publikë/ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 8 /11 mars 2019, Prishtinë.
64. Ligji Nr. 065/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 22 /18 dhjetor 2018, Prishtinë.
65. Ligji Nr. 60/2016 për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në Shqipëri. https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2018/01/ligj-nr-60-dt-per-sinjalizimin-dhe-mbrojtjen-sinjalizuesve.pdf.
66. Ligji Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 5 / 27 prill 2018, Prishtinë.
67. Ligji Nr.06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Jo-Qeveritare/ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.11/24 Prill 2019, Prishtinë.
68. Ligji për Procedurën Kontestimore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 38/20 Shtator 2008, Prishtinë.
69. Marcia P. Miceli, Janet P. Near, Terry Morehead Dworkin *"Whistle-blowing in Organizations"(* New York, by Taylor & Francis Group, LLC, 2008).
70. Mark Worth dhe bashkautorët: Suelette Dreyfus, Cannelle Lavite dhe Garreth Hanle "*Safe or Sorry: Whistleblower Protection Laws in Europe Deliver Mixed Results"* (Blueprint for Free Speech, 2018). www.blueprintforfreespeech.net.
71. Michael Hamilton, "Freedom of Speech in International Law" in Adrienne Stone & Frederick Schauer *"The Oxford Handbook of Freedom of Speech"* (Oxford University Press, 2021).
72. Micheal Freeman, *"Lloyd's Introduction to Jurisprudence"* (London, 2014).
73. OECD Anti-Bribery Convention.
74. OECD, *"Corporate Governance and Business Integrity, A Stocktaking of Corporate Practices".* (2015), fq. 80. https://www.oecd.org/daf/ca/Corporate-Governance-Business-Integrity-2015.pdf
75. Paul Latimer & AJ Brown, *" Whistleblower Laws: International Best Practice* " in UNSW Law Journal (2008).
76. Public Interest Disclosure Act (2013),www.legislation.gov.au/Details/C2013A00133.
77. Raporti i Progresit i Komisionit Evropian i vitit 2016 për Kosovën. www.meiks.net/repository/docs/20170717114956_raporti_i_progresit_2016_shqip.pdf
78. Raportin Vjetor i Punës së AKK-së për vitin 2020, fq- 16-21. https://www.akk-ks.org/assets/cms/uploads/files/Publikimet/Raporte/3.%20Raporti_Vjetor_AKK_2020_Shqip.pdf.
79. Rasti C.nr. 3372/12, Gjykata Themelore në Prishtinë.
80. Rasti, C.nr. 255/15, Gjykata Themelore në Prishtinë.
81. Rregullore (QRK) - Nr. 03/2021 për Përcaktimin e Procedurës për Pranimin dhe Trajtimin e Rasteve të Sinjalizimit. https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=41216.
82. Rregullorja e Kuvendit (2010).
83. South African Law Reform Commission*" Discussion Paper, Protected Disclosures 107"*(2014), fq. 45. https://www.justice.gov.za/salrc/dpapers/dp107.pdf.
84. Steven Swinford and Caroline Gammell, "*Warnings of care home 'were ignored for months"*", The Telegraph, 1 June 2011.www.telegraph.co.uk/news/health/news/8551025/Warnings-of-care-home-were-ignored-for-months.html.

85. Trace International, ISIS Management, IBLF, First to Know – Robust Internal Reporting Programs (2004).
86. Transparency International, "A *Best Practice Guide for Whistleblowing Legislation"*(2018). https://www.transparency.nl/wpcontent/uploads/2018/03/2018_GuideForWhistleblowingLegislation_EN.pdf
87. Transparency International, *"Hidden Costs",*www.transparency.org/news/story/hidden_costs.
88. Transparency International*,"International principles for whistleblower legislation best practices for laws to protect whistleblowers and support whistleblowing in the public interest"* (2013).
89. Udhëzimi Administrativ Nr.03/2013 për standardet e hartimit të akteve normative. https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8696
90. Udhëzues për sinjalizimin në sektorin privat, (Levizja FOL, 2020, Prishtinë). https://levizjafol.org/wp-content/uploads/2020/11/Udh%C3%ABzues-p%C3%ABr-sinjalizimin-n%C3%AB-sektorin-privat.pdf.
91. United Nations Convention against Corruption.
92. United Nations, Human Rights, Office of the High Commissioner https://www.ohchr.org/EN/Issues/Pages/WhatareHumanRights.aspx
93. United Nations Office on Drugs and Crime, (UNODC), "*Resource Guide on Good Practices in the Protection of Reporting Persons"* (2015).
94. Wim Vandekerckhove, *"Udhëzuesi për Mbrojtjen e Sinjalizuesve"* (Këshilli i Evropës, 2019). https://rm.coe.int/handbook-on-protection-of-whistleblowers-alb/168097ed0c
95. Wofgang Benedek ed. *"Kuptimi i të Drejtave të Njeriut, Manual për Arsimin e të Drejtave të Njeriut"* (Botimi shqip: Qendra për të Drejtat e Njeriut të Universitetit të Prishtinës, 2000). www.blueprintforfreespeech.net/en/library/reports
96. Zejnullah Gruda, "*E Drejta Ndërkombëtare Publike"* (Prishtinë,2002).

LISTA E SHKURTESAVE

AKI	Agjencia e Kosovës për Inteligjencë
AKK	Agjencia Kundër Korrupsionit
BE	Bashkimi Evropian
DUDNJ	Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
IP	Inspektorati i Punës
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut
KiE	Këshilli i Evropës
KNDCP	Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike
KNDESK	Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Ekonomike
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
TI	Transparency Internacional
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin
GAP	Government Accountability Project

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

1. E drejta e lirisë së shprehjes dhe sinjalizimit

E drejta e personave për të sinjalizuar shkeljet ligjore, praktikat e dyshimta apo veprimet e dëmshme në kontekstin e marrëdhënieve të tyre të punës, të cilat dëmtojnë interesin publik, buron nga e drejta e lirisë së shprehjes dhe është zgjerim i saj. E drejta e lirisë së shprehjes, së bashku me lirinë e asociimit, fesë dhe tubimit, përbëjnë esencën e të drejtave politike të njeriut. E drejta e lirisë së shprehjes është kusht i domosdoshëm për realizimin e parimeve të llogaridhënies dhe transparencës, të cilat po ashtu janë thelbësore për avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.[1] Të drejtat dhe liritë civile dhe politike konsiderohen si bërthama e të drejtave dhe lirive të njeriut në përgjithësi. Të drejtat dhe liritë themelore janë të drejta të cilat njerëzit i gëzojnë për faktin se janë qenie njerëzore dhe si të tilla ato nuk janë të dhëna nga shtetet individualisht, por janë universale për të gjithë njerëzit pavarësisht dallimeve etnike, racore, gjinore, fetare, kulturore etj.[2]
Të drejtat e njeriut janë të lidhura, të ndërvarura dhe të pandashme me njëra tjetrën, duke formuar kështu arkitekturën e tërësishme të këtyre të drejtave - p.sh. e drejta për jetë është e lidhur detyrimisht me të drejtën për ushqim, strehim, higjienë apo kujdes shëndetësor. Sipas James Nickel, të drejtat e njeriut janë garancione bazike morale që njerëzit në të gjitha vendet dhe kulturat i kanë për vetë faktin se janë njerëz.[3] Me gjithë faktin se të drejtat e njeriut kanë karakter universal dhe janë të pandashme, ato listohen në kategori të ndryshme. Një ndarje klasike dhe pothuajse e referuar përherë është ndarja e *"tri gjeneratave apo brezave të të drejtave të njeriut"* [4] si në vijim: (1) të drejtat civile dhe politike apo liritë themelore; (2) të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, pra kushtet e jetesës, dhe (3) të drejtat kolektive të paqes, zhvillimit dhe ambientit.[5]
Historia njerëzore, në të gjitha fazat e saj, tregon për përpjekjet e mëdha e të pandërprera që njerëzit të gëzojnë të drejtat dhe liritë gjatë përditshmërisë së tyre. Zhvillimi i shtetit ligjor, sistemit demokratik dhe mirëqenies sociale lidhet pikërisht me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në shoqëri. Mirëpo, realizimi i këtyre të drejtave ka njohur një proces afirmativ përmes universalitetit të tyre, i cili është arritur përmes një rendi juridik ndërkombëtar me standarde të cilat duhet të respektohen nga shtetet në raport me shtetasit. E drejta ndërkombëtare pa dyshim se ka pasur ndikim të madh në formësimin e të drejtave të njeriut.[6] Drejt këtij qëllimi, struktura dhe standardet ndërkombëtare për promovimin dhe mbrojtjen të drejtave të njeriut u zhvilluan kryesisht nën organikën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) me miratimin e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut (DUDNJ), të cilën e pasuan instrumentet ligjërisht të

1 Michael Hamilton, "Freedom of Speech in International Law" in Adrienne Stone & Frederick Schauer *"The Oxford Handbook of Freedom of Speech"* (Oxford University Press, 2021) Chapter 11. fq. 193-212.
2 Lidhur me kuptimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, shih faqen zyrtare të United Nations, Human Rights, Office of the High Commissioner https://www.ohchr.org/EN/Issues/Pages/WhatareHumanRights.aspx.
3 Micheal Freeman, *"Lloyd's Introduction to Jurisprudence"* (London, 2014,) fq. 2409.
4 Përveç kësaj ndarjeje klasike në aspektin doktrinar trajnohet edhe "*gjenerata e katërt e të drejtave të njeriut",* e cila ka të bëjë me inxhinieringun gjenetik apo edhe të drejtat e gjeneratave të ardhshme". Shih: Enver Hasani, "E Drejta Kushtetuese dhe të Drejtat e Njeriut - Parimet dhe Institucionet" në "*Hyrje në Sistemin Ligjor në Kosovë*" (Prishtinë, 2019, Akademia e Drejtësisë) fq. 44.
5 Allan Rosas & Martin Scheinin, " Kategoritë dhe të Drejtave të Njeriut dhe Përfituesit e Tyre", Rija Hanski & Markku Suksi ed., *"Hyrje në Mbrojtjen Ndërkombëtare të të Drejtave te Njeriut"(*versioni shqip botuar nga Projekti Finlandez për të Drejtat e Njeriut, Prishtinë, 2000.) fq.61.
6 Dajana Kumbaro "Hyrje në të Drejtën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut" Kapitulli I, në Qerim Qerimi dhe Gentian Zyberi *"E Drejta Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut"* (Prishtinë, 2015) fq.25.

detyrueshme, siç ishin: Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike si dhe Konventa për të Drejtat Sociale dhe Ekonomike dhe Kulturore.[7] Këto tri akte së bashku përbëjnë atë që quhet Kodi Ndërkombëtar i të Drejtave të Njeriut.[8] Përveç sistemit global nën organikën e OKB-së, të drejtat e njeriut mbrohen dhe garantohen edhe në kuadër të sistemeve rajonale, siç janë sistemi evropian, amerikan dhe afrikan, në kuadër të së cilëve funksionojnë standarde dhe mekanizma mbikëqyrës shumë të rëndësishëm.

Origjina e të drejtës së lirisë së shprehjes na kthen prapa në shekullin e 18-të dhe 19-të, tek lufta për liritë individuale, dhe sipas John Stuart Millit, "Liria e shprehjes ishte një nga siguritë kundër qeverive të korruptuara dhe tiranike."[9] Si rezultat i iluminizmit, e drejta e lirisë së shprehjes u mishërua edhe në Kushtetutën Amerikane (1787) dhe në Deklaratën Franceze për të Drejtat e Njeriut dhe Shtetasit (1789). Nën dritën e parimeve iluministe, presidenti amerikan Roosvelt, në vitin 1941, proklamoi se liria e shprehjes bashkë me lirinë nga frika, mjerimi dhe besimi, duhet të ishin bazamenti mbi të cilin duhej të ngrihej rendi i ardhshëm botëror.[10] Këto *"katër liri"* patën ndikim të madh në perspektivën e standardeve universale për të drejtat dhe liritë e njeriut.

E drejta e lirisë së shprehjes është e garantuar me shumë instrumente juridike ndërkombëtare dhe rajonale[11] të cilat janë të integruara në sistemet ligjore kombëtare. Sipas përmbajtjes së rregullimit të përgjithshëm ligjor, e drejta e lirisë së shprehjes është një e drejtë kornizë e cila përfshin: (1) lirinë e mendimit; (2) të drejtën për të kërkuar informacion dhe ide; (3) të drejtën për të marrë informacion dhe ide, dhe (4) të drejtën për të dhënë informacion dhe ide. Sipas standardeve ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare, liria e shprehjes garantohet jo vetëm në përmbajtje por edhe në mjetet e saj të shprehjes, sikurse me gojë, me shkrim, përmes shtypit, internetit, artit, muzikës, etj.

Megjithatë, duhet theksuar se ushtrimi i lirisë së shprehjes mund t'i nënshtrohet kufizimeve, kushteve apo edhe dënimeve që janë të përcaktuara me ligj dhe të domosdoshme për një shoqëri demokratike. Këto kufizime mund të jenë: (1) ruajtja e sigurisë dhe sovranitetit kombëtar; (2) mbrojtja e rendit dhe mbrojtja nga krimet; (3) mbrojtja e moralit dhe shëndetit publik; (4) respektimi i të drejtave ose reputacionit të të tjerëve, dhe (5) sigurimi i paanshmërisë dhe pavarësisë së sistemit gjyqësor.[12]

Sistemi rajonal evropian i të drejtave të njeriut paraqet një sistem afirmativ të mbrojtjes së lirisë së shprehjes, dhe në këtë kontekst, edhe të sinjalizuesve. Pothuajse të gjitha shtetet në kornizën e Këshillit të Evropës (KiE) e kanë të integruar KEDNJ në legjislacionin e brendshëm si një instrument detyrues për institucionet publike përfshirë edhe gjykatat. KEDNJ duhet të lexohet në mënyrë të integruar njëkohësisht me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), sepse vendimet e GJEDNJ-së

7 Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut u miratua më 10 qershor 1948, ndërsa Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Sociale, Ekonomike dhe Kulturore u miratuan më 1966 dhe hynë në fuqi 10 vjet më vonë, më 1976.

8 Wofgang Benedek ed. *"Kuptimi i të Drejtave të Njeriut, Manual për Arsimin e të Drejtave të Njeriut",* (Botimi shqip: Qendra për të Drejtat e Njeriut të Universitetit të Prishtinës, 2000) fq. 42.

9 John Stuart Mill, *On Liberty,* (ed.by David Bromwich and George Kateb: Yale University Press, New Haven and London, 2003), Chapter II, Of the Liberty of Thought and Discussion. fq. 86-120.

10 Zejnullah Gruda*,"E Drejta Ndërkombëtare Publike"(* Prishtinë, 2002) fq. 364.

11 Instrumentet kryesore ndërkombëtare dhe rajonale në të cilat përcaktohet e drejta e lirisë së shprehjes janë: Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (Neni 19); Konventa për të Drejtat Civile dhe Politike (Neni 19); Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore (Neni 10); Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut (Neni 9); Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian (Neni 11).

12 Neni 19, Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut - DUDNJ; Neni 19, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike - KNDCP; Neni 10, Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj - KEDNJ; Karta Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Neni 11.

gëzojnë statusin e normave detyrimisht të zbatueshme. Lidhur me të drejtën e lirisë së shprehjes, GJEDNJ në mënyrë të vazhdueshme ka mbajtur qëndrimin se *"liria e shprehjes përbën një prej themeleve kryesore të një shoqërie demokratike dhe një prej kushteve bazë për përparimin e saj dhe vetërealizimit të çdo individi."* Ndërsa, lidhur me kufizimin e të drejtës së lirisë së shprehjes, sipas GJEDNJ-së, "*Kjo liri u* nënshtrohet përjashtimeve të cilat, gjithsesi, *duhet të interpretohen në mënyrë rigoroze dhe bindëse, ndërsa fjala 'e domosdoshme' nënkupton ekzistencën e një 'nevoje të ngutshme shoqërore.'*"[13]

Duke interpretuar Nenin 10-të të KEDNJ-së, GJEDNJ ka nxjerrë disa nga vendimet kryesore për mbrojtjen e sinjalizuesve, të cilat edhe kanë ndërtuar standardet ndërkombëtare afirmative për të drejtën e sinjalizimit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.[14] Për shkak të rolit të rëndësishëm që sinjalizuesit e kanë në shoqëritë demokratike, GJEDNJ u ka ofruar atyre mbrojtje të posaçme. Sipas GJENDJ-së, individët të cilët raportojnë apo shpalosin informacion që dëmton interesin publik, kontribuojnë në forcimin e llogaridhënies, transparencës dhe sundimit të ligjit. Në dritën e këtyre parimeve dhe standardeve, shumë vende evropiane kanë miratuar ligje të veçanta lidhur me këtë fushë.[15] Mbrojtja dhe mirëqenia e sinjalizuesve është përcaktuar edhe në nivel të Bashkimit Evropian përmes Direktivës për mbrojtjen e personave që raportojnë shkeljet e ligjit të Bashkimit Evropian (Direktiva), e cila obligon shtetet anëtare të BE-së që brenda dy viteve ta transpozojnë në kuadër të legjislacionit të tyre kombëtar.[16]

2. Të drejtat dhe liritë e njeriut në sistemin ligjor të Kosovës

Në kuadër të sistemit ligjor të Kosovës, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të përcaktuara sipas standardeve dhe instrumenteve ndërkombëtare. Kushtetuta e Kosovës përgjatë tërë tekstit të saj përmban dispozita lidhur me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Fryma dhe shkronjat e saj janë të mishëruara me standardet afirmative për të drejtat e njeriut, kufizimin e pushtetit, pavarësinë e gjyqësorit dhe sundimin e ligjit. Dispozitat themelore kushtetuese përcaktojnë se barazia para ligjit dhe respektimi i plotë i të drejtave dhe lirive të njeriut janë parime thelbësore për ushtrimin e autoritetit publik.[17] Respektimi i të drejtave dhe lirive themelore është gjithashtu një prej vlerave themelore mbi të cilat ndërtohet rendi kushtetues i Republikës së Kosovës.[18] Rendi kushtetues nënkupton jo vetëm normën kushtetuese por edhe organizimin dhe strukturat institucionale, të cilat zbatojnë autorizimet e tyre sipas mandatit të dhënë kushtetues dhe ligjor.

13 Shih rastet e GJEDNJ: Zana kundër Turqisë, 25 nëntor 1997; Şener kundër Turqisë, 18 korrik 2000; Dichand dhe të tjerët kundër Austrisë, 26 shkurt 2002.

14 Rastet kryesore të GJEND-së lidhur me fushëveprimin e sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve janë: Guja v. Moldova, Matúz v. Hungary and Görmüş a.o. v. Turkey, shih: Dirk Voorhoof; Ad van Loon; Charlotte Vier and Ronan Ó Fathaigh, *"Freedom of expression, the Media and Journalists Case-law of the European Court of Human Rights"* (ed. Tarlach McGonagle IRIS Themes, vol. III 6 th edition, April 2021).

15 Mbretëria e Bashkuar është vendi i parë në Evropë që ka miratuar një akt të tillë të quajtur "The UK's Public Interest Disclosure Act" (1988). Për trendët e miratimit të ligjeve për shpalosjen e informacionit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, parimet dhe standardet ndërkombëtare, shih: M. Worth S. Dreyfus dhe G. Hanley,"*Gaps in the System: Whistleblowers Laws in the EU"* (2018), www.blueprintforfreespeech.net.

16 Direktivën e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Bashkimit Evropian për Mbrojtjen e Personave që raportojnë shkeljen e Ligjit në Bashkimin Evropian. Bruksel, 25 shtator 2019. https://data.consilium.europa.eu/doc/document/PE-78-2019-INIT/en/pdf Transpozimi përfshin masat legjislative dhe administrative nga autoritetet kompetente të një shteti anëtar për të integruar brenda sistemit ligjor kombëtar detyrimet, të drejtat dhe detyrat e parapara nga Direktiva.

17 Neni 3 [Barazia para Ligjit] i Kushtetutës së Kosovës.

18 Neni 7 [Vlerat] i Kushtetutës së Kosovës.

Kushtetuta e Kosovës, ngjashëm me kushtetutat e vendeve tjera, përmban kapitull të veçantë për të drejtat dhe liritë e njeriut, respektivisht kapitulli i II i saj. Në kuadër të këtij kapitulli listohen të drejtat dhe liritë e njeriut të të tri gjeneratave. Ndërsa Neni 22 përcakton shprehimisht instrumentet kryesore ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut që janë të vetëzbatueshme dhe me status të njëjtë në rang me vetë dispozitat kushtetuese. Dispozitat e këtyre instrumenteve kanë prioritet në rast të konflikteve me ligjet apo aktet tjera të institucioneve publike.[19] Lidhur me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, Kushtetuta e Kosovës përmban dy risi të cilat e dallojnë nga kushtetutat e vendeve tjera. E para është Neni 53, i cili si i tillë, nuk gjendet në asnjë Kushtetutë tjetër në Evropë.[20] Ky nen përcakton se *"të drejtat dhe liritë e njeriut, të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut."*[21] E dyta ka të bëjë me kontrollin preventiv nga Gjykata Kushtetuese të propozim amendamenteve kushtetuese me qëllim të vlerësimit të tyre nëse të njëjtat i pakësojnë të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Në rast të vlerësimit të Gjykatës se propozim amendamenti i propozuar i pakëson të drejtat dhe liritë e njeriut, të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës, i njëjti nuk mund të procedohet për votim nga deputetët e Kuvendit.[22]

Garantimi i të drejtave dhe lirive të njeriut është rregull, ndërsa kufizimi i tyre nga ana tjetër është përjashtim. Kushtetuta e Kosovës, në Nenin 55, përcakton kriteret sipas të cilave mund të kufizohen të drejtat e garantuara. Kriteret kryesore janë se ato mund të kufizohen me ligj, për aq sa është e nevojshme për një shoqëri demokratike, vetëm për aq sa i shërbejnë qëllimit të ligjshëm të kufizimit dhe pa dëmtuar esencën e të drejtës së garantuar. Këto parime janë rikonfirmuar edhe nga Gjykata Kushtetuese në tekstin e kushtetutës, të Nenit 55, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 01/15 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të 23 marsit 2020, për masat kundër pandemisë Covid-19 në territorin e vendit.[23] Sipas Gjykatës, kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore mund të bëhet "vetëm me ligj" të aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Përveçse me kushtetutë, të drejtat dhe liritë themelore garantohen edhe përmes korpusit të legjislacionit në fushën civile, penale dhe administrative. Po ashtu, ligjet e veçanta për mbrojtjen nga diskriminimi, barazinë gjinore, mbrojtjen e të dhënave personale, qasjen në dokumentet publike - të cilat përpunojnë gjerësisht dispozitat kushtetuese - kanë impakt të rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.

19 Neni 22[Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] i Kushtetutës, përcakton këto instrumente si në vijim: (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj; (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollet e saj; (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; (5) Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor; (6) Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Gruas; (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës; (8) Konventa Kundër Torturës dhe Trajtimeve dhe Ndëshkimeve tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.

20 Enver Hasani (2019), fq. 57.

21 Sipas nenit 53, autoritet publike në Kosovë kanë detyrim t'i referohen jurisprudencës së GJENDJ-së, por në praktikë kjo rrallë ndodhë. Përjashtim pozitiv këtu bën Gjykata Kushtetuese e Kosovës e cila në mënyre aktive i është referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së e cila zbaton Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.

22 AKTGJYKIM në Rastin nr. K013/15 Vlerësim i një amendamenti të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të propozuar nga pesëdhjetë e pesë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, dhe të referuar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 6 shkurt 2015 me shkresën nr. 05-259/DO-179. https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10750.

23 Gjykata Kushtetuese e Kosovës, AKTGJYKIM në rastin nr. KO54/20.

3. Sfondi i Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve

Kushtetuta e Kosovës e përcakton të drejtën e lirisë së shprehjes sipas instrumenteve ndërkombëtare, sikurse: DUDNJ, KNDCP dhe KEDNJ, të cilat janë të zbatueshme drejtpërdrejt në Kosovë.[24] Fusha e sinjalizimit dhe mbrojtja e sinjalizuesve deri në vitin 2011 është mbuluar pjesërisht me legjislacionin e fushave tjera sikurse legjislacioni penal, legjislacioni për klasifikimin e informacionit, legjislacioni kundër korrupsionit, etj. Ndërsa në vitin 2011 është miratuar Ligji për Mbrojtjen e Informatorëve i cili kishte si qëllim të nxiste njerëzit, që në kapacitetin e tyre zyrtar apo si qytetarë, të paraqisnin veprimet kundërligjore.[25]

Pavarësisht se ky ligj pretendonte të ofronte një kornizë ligjore për paraqitjen e informacioneve për veprimet penale apo kundërvajtëse dhe mbrojtjen e informatorëve, zbatimi i tij në praktikë nuk kishte pasur ndonjë efekt. Ligji mbi informatorët nuk ishte në përputhje me standardet ndërkombëtare, për faktin se ai nuk i plotësonte mekanizmat minimalë të zbulimit të informacioneve apo kërkesave për mbrojtje.[26] Të metat kryesore të Ligjit për Mbrojtjen e Informatorëve ishin se (1) nuk përcaktonte sinjalizimin si veprim; (2) informatorët mund të raportonin vetëm brenda institucionit publik ose privat dhe jo në media ose në ndonjë institucion tjetër; (3) nuk përcaktonte as sanksionet penale, civile dhe kundërvajtëse në rast se pengohej informimi apo dështimi i mekanizmave institucionalë në mbrojtjen e informatorëve.[27]

Përveç përmbajtjes së ligjit, edhe aspekti sociokulturor ka ndikuar në mos-efikasitetin e tij, pasi termi *'informator'*, dukej i papërshtatshëm për shkak të konotacioneve historikisht negative gjatë epokës komuniste.[28] Termi 'informator' asocionte me ish-bashkëpunëtorët e shërbimeve famëkeqe të sigurisë të cilat kishin shkelur masivisht të drejtat dhe liritë e njeriut. Në fakt, situata nuk është e njëjtë, pasi tani informatorët (sinjalizuesit) raportojnë për shkeljet ligjore, në të mirë të interesit publik, megjithëse kodi i heshtjes në të shumtën e rasteve akoma është mbizotërues.

Me qëllim të avancimit të kornizës ligjore për mundësimin e sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve në pajtim me standardet ndërkombëtare, Kuvendi i Kosovës, më 23 nëntor 2018, ka miratuar Ligjin Nr. 065/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Ky ligj është shpallur nga Presidenti i Republikës së Kosovës me dekretin Nr. DL-062-2018, më 13.12.2018. Ndërsa i njëjti është publikuar në Gazetën Zyrtare më 18 dhjetor 2018 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit. Dispozitat që i referohen sektorit privat fillojnë të zbatohen një (1) vit pas hyrjes së tij në fuqi.[29] Me hyrjen në fuqi *ex lege* është shfuqizuar Ligji Nr. 04/L-043 për Mbrojtjen e Informatorëve.

24 Neni 40 [Liria e Shprehjes] i Kushtetutës.

25 Ligji Nr. 04/L-043 për Mbrojtjen e Informatorëve, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Nr.14/9 shtator 2011 Prishtinë.

26 Raporti i Progresit i Komisionit Evropian i vitit 2016 për Kosovën, Sundimi i Ligjit, fq 17. https://www.meiks.net/repository/docs/20170717114956_raporti_i_progresit_2016_shqip.pdf

27 Shih F. Kusari, '*Whistleblowers in Kosovo Struggle for Protection'.* Southeast European Coalition on Whistleblower Protection, (9 September 2016). https://see-whistleblowing.org/whistleblowers-in-kosovo-struggle-for-protection/

28 K. Gashi, "*Kosovo: The Republic without Whistle blowers.* Balkan Investigative Reporting Network and Southeast Europe Coalition on Whistleblower Protection (12 September 2016). https://see-whistleblowing.org/kosovo-the-republic-without-whistleblowers/.

29 Ligji Nr. 065/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 22 /18 dhjetor 2018, Prishtinë.

Udhëzues për përdorimin e Komentarit

Në aspektin metodologjik, ky Komentar është realizuar duke interpretuar nen për nen Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Komentimi i nenit ka strukturë të thjeshtë dhe të kuptueshme për lexuesin, dhe i përgjigjet përmbajtjes së nenit dhe jo ndarjes së paragrafëve apo nënparagrafëve. Pas secilit nen të ligjit jepet teksti i komentimit i cili organizohet sipas numrave rendor (1, 2, 3, etj.). Komentimi është bazuar në sqarimin e kuptimit të normës nga vetë përmbajtja e saj, dhe duke i konceptualizuar edhe me normat (nenet) e ligjeve tjera, me qëllim të sqarimit se si një nen i caktuar mund të zbatohet në praktikë. Për më shumë, komentimi i neneve mbështetet edhe nga praktikat më të mira ndërkombëtare duke pasqyruar kështu nëse dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve janë në përputhje me praktikat më të mira përkatëse.Në fund, kur është e përshtatshme dhe relevante, përdoren praktika gjyqësore si dhe raste konkrete të sinjalizuesve nga vende tjera për të demonstruar se si janë trajtuar ose zgjidhur paqartësitë e caktuara në legjislacionin e sinjalizimit.

KAPITULLI I - DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është mundësimi i sinjalizimit të shkeljeve në sektorin publik dhe privat dhe mbrojtja e sinjalizuesve

Koment, neni 1

1. E drejta për të sinjalizuar është e drejta e personave për të kërkuar, për të marrë dhe për të shpërndarë informacione për shkeljet ligjore, praktikat dyshuese apo veprimet e dëmshme në kontekstin e marrëdhënieve të tyre të punës. Të punësuarit në sektorin publik apo privat janë të parët të cilët mund të kenë informacione për shkelje të ndryshme që kanë ndodhur apo janë në fazën përgatitore për të ndodhur. Personat të cilët raportojnë shkeljet e ndryshme luajnë rol thelbësor në parandalimin e shkaktimit të dëmit dhe mbrojtjen e interesit publik. Mirëpo, sinjalizimi përmban edhe rrezikun nga veprimet hakmarrëse. Prandaj, komuniteti i të punësuarëve në sektorin publik dhe privat, në të shumtën e rasteve, qëndrojnë të heshtur apo indiferentë ndaj këtyre veprimeve. Ata konsiderojnë se mundësia e raportimit nuk është efikase apo se raportimi mund t'u sjellë probleme në vendin e punës në një formë apo tjetër. Sinjalizimi kërkon guxim dhe aktivizëm qytetar, dhe njerëzit që raportojnë kanë nevojë për mbrojtje të duhur.[30]
2. Ligji Nr 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve *(tutje: Ligji)* ka si qëllim të krijojë një mjedis të sigurt për të gjithë të punësuarit që raportojnë veprimet e tilla, dhe në të njëjtën kohë, një mjedis të pasigurt për të gjithë individët që pretendojnë të përfshihen në shkelje ligjore.
3. Fusha e sinjalizimit dhe mbrojtja e sinjalizuesve është një fushë e re dhe mund të konsiderohet edhe si *sui generis*. Për me tepër, qëllimi thelbësor i Ligjit, nga fryma dhe shkronja e tij, është të ndikojë në ndryshimin e kulturës së heshtjes lidhur me shkeljet që dëmtojnë interesin publik. Theksi kryesor i Ligjit është mbrojtja e sinjalizuesve të cilët raportojnë apo i bëjnë publike shkeljet e ndryshme. Zbatimi i Ligjit pritet të forcojë integritetin dhe llogaridhënien e institucioneve publike, nga njëra anë, si dhe do të krijojë parakushte që sektori privat të ofrojë shërbime më efikase, nga ana tjetër. Në këtë këndvështrim, ky Ligj është pjesë e rëndësishme e arkitekturës ligjore për luftimin dhe parandalimin e shkeljeve të ndryshme të cilat cenojnë apo dëmtojnë interesin publik.
4. Neni 1 i Ligjit përcakton qëllimin e përgjithshëm të rregullimit ligjor për sinjalizimin dhe për mbrojtjen e sinjalizuesve. Për dallim nga titulli i Ligjit që i referohet vetëm mbrojtjes së sinjalizuesve, dispozitat e nenit 1 zgjerojnë qëllimin e ligjit duke përfshirë edhe sinjalizimin si proces apo veprim. Sipas një interpretimi me të ngushtë,

30 Shih: Ashley Savage" *Whistleblowers for change: the social and economic costs and benefits of leaking and whistleblowing"* (Open Society Foundations, 2018).

qëllimi themelor i Ligjit është krijimi i bazës ligjore për përcaktimin e procedurave të sinjalizimit në sektorin publik dhe privat dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Mirëpo, sipas një interpretimi më të gjerë, qëllimi themelor i ligjit është të krijojë një mjedis i cili mundëson sinjalizimin dhe mbron sinjalizuesit nga pasojat e çfarëdo veprimi hakmarrës, krijimit të kanaleve të sinjalizimit, të strukturave për hetimin administrativ, vetëdijesimin dhe mbrojtjen gjyqësore.

5. Procesi demokratik, sundimi i ligjit dhe të drejtat e njeriut janë fryma e këtij Ligji. Këto komponente qëndrojnë të ndërlidhura në mënyrë të natyrshme, të pandashme dhe të ndërvarura nga njëra-tjetra. Të drejtat themelore janë të lidhura ngushtë me të drejtën e shprehjes së lirë dhe të drejtën e qasjes në informacione si vlera themelore të rendit kushtetues të Republikës së Kosovës.[31] Ligji ka për qëllim të garantojë që punonjësit e sektorit publik dhe privat mund të flasin për shkeljet e ndryshme ligjore, dhe se çdo punëdhënës duhet të garantojë që punonjësit të cilët sinjalizojnë akte të tilla të mbrohen nga veprimet e ndryshme të viktimizimit apo hakmarrjes ndaj tyre.

Praktikat më të mira ndërkombëtare

1. Parimi udhëzues mbi sinjalizimin i Transparency International thekson: "Individët e mbrojtur dhe zbulimet që u referohen të gjithë punonjësve dhe punëtorëve në sektorin publik dhe privat kanë nevojë për kanale të arritshme dhe të besueshme për t'i raportuar keqbërjet; mbrojtja e fuqishme nga të gjitha format e hakmarrjes; dhe mekanizmat për zbulime që promovojnë reforma të cilat korrigjojnë papërshtatshmëritë legjislative, politike ose procedurale dhe që i parandalojnë keqbërjet në të ardhmen".[32]
2. Ky Ligj synon që të sigurojë mbrojtje për sinjalizuesit si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, dhe në këtë kuptim është në përputhje me praktikat më të mira aktuale.

Neni 2

Fushëveprimi

Ky ligj përcakton rregullat për sinjalizimin, procedurën e sinjalizimit, të drejtat dhe mbrotjen e sinjalizuesve dhe detyrimet e institucioneve publike dhe subjekteve private në lidhje me sinjalizimin.

Koment, neni 2

1. Qëllimi dhe objekti i nenit 2 është përcaktimi i fushëveprimi të Ligjit i cili përfshin të gjitha institucionet e sektorit publik dhe subjektet e sektorit privat, sepse veprimtaritë e këtyre sektorëve janë të ndërlidhura. Praktikat tregojnë se në shumë raste një veprim apo shkelje bëhet përmes bashkëpunimit mes organizatave (personave) nga sektori publik dhe privat. Dispozitat e nenit 2 përcaktojnë fushëveprimin e Ligjit, dhe për ketë arsye, këto dispozita janë themelore dhe jo vetëm thjesht deklarative. Fushëveprimi

31 Neni 7 [Vlerat], Neni 40 [Liria e Shprehjes] dhe Neni 41 [E drejta e qasjes në dokumentet publike] të Kushtetutës së Kosovës. https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702.

32 Shih: International Transparency, "*Internacional Principe for Whistleblower Legislation, Best Practices For Laws to Protect Whistleblowers and Support Whistleblowing in the Public Interest* (2013). https://images.transparencycdn.org/images/2013_WhistleblowerPrinciples_EN.pdf.

i Ligjit përmban katër elemente thelbësore të cilat së bashku ndërtojnë arkitekturën e përgjithshme të tij, dhe përfshijnë: (1) rregullat për sinjalizimin; (2) procedurën e sinjalizimit; (3) të drejtat dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, dhe (4) detyrimet e institucioneve publike dhe subjekteve private.

2. Këto elemente rregullohen gjerësisht me dispozitat vijuese të Ligjit, duke ndërtuar kështu kornizën brenda së cilës të punësuarit në sektorin publik dhe privat mund të bëjnë sinjalizimin e shkeljeve të ndryshme. Kjo kornizë përfshin fushat për të cilat mund të sinjalizohet, institucionet apo adresat se ku duhet të drejtohet një sinjalizues, procedurat për trajtimin e sinjalizimit, mbrojtjen dhe të drejtat e sinjalizuesve dhe personit të lidhur me sinjalizuesin, mbrojtjen gjyqësore dhe gjobat për kundërvajtje. Detyrimi i institucioneve të sektorit publik dhe subjekteve të sektorit privat për të caktuar zyrtarët përgjegjës për të bërë vetëdijësimin e të punësuarve dhe raportimet vjetore lidhur me sinjalizimin janë në funksion të përmbushjes së qëllimit të përgjithshëm të Ligjit.

3. Shtetet kanë praktika të ndryshme lidhur me rregullimin ligjor për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Disa vende ketë fushë e kanë të rregulluar me legjislacion penal, ndërsa disa tjera e kanë të shpërndarë në disa ligje tjera, si në legjislacionin penal apo në atë të punës. Disa shtete, me theks të veçantë të Evropës, këtë fushë e rregullojnë me ligj të veçantë *(lex speciales*).[33] Por pavarësisht mënyrës së rregullimit ligjor, standardet ndërkombëtare janë se: 1) duhet të ketë një ligj që rregullon në mënyrë gjithëpërfshirëse sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve; 2) ligji të ketë fushëveprim në sektorin publik dhe privat; 3) institucionet e sektorit publik dhe privat kanë për obligim t'i trajtojnë sinjalizimet e raportuara, dhe 4) institucionet e sektorit publik dhe privat duhet të garantojnë mbrojtje ligjore të sinjalizuesve nga çfarëdo veprimi hakmarrës.

4. Ligji ka integruar parimet dhe standardet evropiane të përcaktuara me Rekomandimin e Këshillit të Evropës, (2014/7) dhe Direktivën 2019/1937 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit për mbrojtjen e personave të cilat raportojnë shkeljet e ligjit të Bashkimit Evropian. Sipas vlërsimit të Goverment Acountablity Project, nga 20 parimet me te mira nga lista kontrolluese e legjislacionit ndërkombëtar, Ligji i përmban 13 prej tyre. [34]

5. Është me rendësi të theksohet fakti se ky Ligj është *lex speciales* për fushën e sinjalizimit dhe nuk 'ndërhyn' në fushëveprimin e ligjeve tjera të cilat po ashtu përcaktojnë detyrime për raportimin e shkeljeve të ndryshme dhe mbrojtjen e personave që i raportojnë ato. Në funksion të sqarimit se për cilat ligjet bëhet fjalë, në vijim do të jepet një pasqyrë e tyre.

6. Kodi Penal, në Nenin 200(2), përcakton mbrojtjen e personave të cilët raportojnë në mbrojtje të interesit publik si në vijim: "*Personi nuk* është *penalisht përgjegjës nëse e ka zbuluar informacionin konfidencial për interes publik, nëse interesi i tillë peshon më shumë se moszbulimi i informatës së fshehtë.*" Ndërsa Neni 388(2) përcakton mbrojtjen e sinjalizuesve si në vijim: *"Kushdo që ndërmerr ndonjë veprim të dëmshëm për cilindo person me qëllim të hakmarrjes për shkak të raportimit ose shpalosjes së informacionit për veprimet dhe mosveprimet që paraqesin kërcënim ose cënim të interesit publik dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet*.[35]

33 Shih: Mark Worth dhe bashkautorët: Suelette Dreyfus, Cannelle Lavite dhe Garreth Hanle "*Safe or Sorry: Whistleblower Protection Laws in Europe Deliver Mixed Results"* (Blueprint for Free Speech, 2018). www.blueprintforfreespeech.net/en/library/reports.

34 Goverment Acountablity Project "*Are whistleblowing laws working? A global study of whistleblower protection litigation*" (London 2021) fq.75.

35 Kodi Nr. 06/l-074 Penal i Republikës së Kosovës/ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 2 /14 janar 2019, Prishtinë.

7. Edhe Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi përmban dispozita lidhur me mbrojtjen e personave që raportojnë diskriminim. Neni 4 (1.15) përcakton se "*Viktimizimi konsiderohet diskriminim mbi bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, dhe ndodhë kur personi përjeton trajtim të pafavorshëm apo pasoja negative si reagim ndaj ankimit apo mos ankimimit (procedurave të filluara) apo veprimeve me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë, ose në rastet kur personi i tillë ofron informacione, dëshmi apo ndihmë në lidhje me ankesën ose procedurën në rast të diskriminimit*".[36]
8. Po ashtu, edhe Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit, në Nenin 19, përcakton mundësinë e raportimit të korrupsionit si në vijim*: "1. Kur një person dyshon për korrupsion, ai/ajo mund të raportojë rastin e tillë në Agjenci; 2. Në rast se një person zyrtar, gjatë kryerjes së detyrës zyrtare vjen në dijeni në lidhje me veprimin korruptiv, ai/ajo duhet të njoftojë Agjencinë dhe njëkohësisht të ndërmarrë masat e nevojshme për të ruajtur të dhënat në lidhje me sjelljen korruptive; 3. Paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni nuk përjashton mundësinë e personit për t'i raportuar rastet drejtpërdrejt tek institucionet tjera kompetente për zbatimin e ligjit."*[37]
9. Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, i cili është një prej ligjeve më të rëndësishme për forcimin e integritetit të sektorit publik dhe garantimit të kryerjes së detyrave publike në mënyrë objektive, të paanshme dhe transparente në shërbim të interesit publik, në nenin 7(1) përcakton se: *"Pavarësisht* çdo *detyrimi tjetër ligjor,* çdo *person që ka njohuri ose dyshim të arsyeshëm për konflikt interesi të ndonjë zyrtari duhet ta lajmërojë institucionin punëdhënës të zyrtarit ose Agjencinë kundër Korrupsionit"*.[38]
10. Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë (AKI) është ligji bazë për organizimin dhe fushëveprimin AKI-së. Për shkak të mandatit specifik të AKI-së, Neni 18 shprehimisht përcakton detyrimet ligjore për pjesëtarët e AKI-së për të kryer detyrat në pajtim me ligjin. Poashtu, dispozitat e Nenit 18, përcaktojnë se *"Nëse një punonjës beson se AKI-ja apo një punonjës i AKI-së mund të ketë shkelur apo po shkel ndonjë ligj, rregullore apo politikë relevante, ai apo ajo duhet t'ia raportojë këtë Inspektorit të Përgjithshëm."*[39]

Praktikat më të mira ndërkombëtare

1. Një kërkesë e rëndësishme e çdo legjislacioni për sinjalizim është të sigurohemi se ai përcakton qartë qëllimin e tij të aplikimit, domethënë, cilat lloje të zbulimeve mbulohen, për kë aplikohet dhe çfarë niveli të besimit në shqetësimin e ngritur duhet të ketë sinjalizuesi. Fusha e aplikimit duhet të jetë sa më e gjerë që të jetë e mundur për ta përfshirë çdo situatë të mundshme të sinjalizimit dhe të sigurojë se të gjithë sinjalizuesit mbrohen nga legjislacioni.

2. Vakumet dhe mungesa e qartësisë mund të çojnë në situata ku individët vendosin të flasin me bindjen se janë të mbrojtur, kur në fakt nuk janë, dhe kështu janë të prekshëm nga trajtimet e padrejta.[40]

36 Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi; Gazeta Zyrtare e Republikës se Kosovës /Nr. 16 /6 qershor 2015, Prishtinë.
37 Ligji nr. 03/L- 159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, /Nr.65/05 shkurt 2010, Prishtinë.
38 Ligji Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 5 / 27 prill 2018, Prishtinë.
39 Neni 18, Ligji Nr.03/L-063 për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 30 /15 qershor 2008, Prishtinë.
40 Shih: Transparency International, "A *Best Practice Guide for Whistleblowing Legislation"*(2018). https://www.transparency.nl/wp-content/uploads/2018/03/2018_GuideForWhistleblowingLegislation_EN.pdf.

Neni 3

Përkufizimet

1. **Për qëllim të këtij ligji, shprehjet e mëposhtme do të kenë këto kuptime:**
   - **1.1. Sinjalizues - çdo person i cili raporton ose shpalos informacione për një kërcënim ose cënim të interesit publik në kontekstin e marrëdhënies së vet të punës në sektorin publik ose privat.**
   - **1.2. Raportim ose shpalosje në interes publik - nënkupton raportimin ose shpalosjen e informacionit për veprimet dhe mosveprimet që paraqesin kërcënim ose cënim të interesit publik**
   - **1.3. Raportim - nënkupton raportimin brenda institucionit publik apo subjektit privat ose tek autoriteti kompetent.**
   - **1.4. Shpalosje - nënkupton bërjen publike të informacionit.**
   - **1.5. Person në kontekst të marrëdhënies së punës - personi fizik i cili është apo ka qenë:**
     - **1.5.1. në marrëdhënie pune në një institucion publik ose subjekt privat, pavarësisht nga natyra e marrëdhënies së punës, kohëzgjatja ose pagesa;**
     - **1.5.2. bashkëpunëtor i jashtëm ose i rastit, vullnetar, në praktikë profesionale ose trajnim;**
     - **1.5.3. kandidat për punësim, aktivitete vullnetare, praktikë profesionale ose trajnim;**
     - **1.5.4. në marrëdhënie kontraktore punësh, shërbimesh ose lloje të tjera bashkëpunimi apo përdorim i shërbimeve të institucionit publik ose subjektit privat, përfshirë kontraktimin ose nënkontraktimin.**
   - **1.6. Punëdhënës - nënkupton çdo institucion publik dhe subjekt privat që i përket ndonjërës prej kategorive të përkufizuara sipas nënparagrafit 1.5 të këtij paragrafi.**
   - **1.7. Agjencia Kundër Korrupsionit ose ndonjë autoritet që ka të drejtë të marrë raporte në përputhje me legjislacionin në fuqi, në lidhje me sinjalizimin në sektorin publik, ndërsa rregullatorët sipas fushës në të cilën bëhet sinjalizimi në lidhje me sinjalizimin në sektorin privat.**
   - **1.8. Institucion publik - nënkupton organet, autoritetet dhe agjencitë publike në nivelin qendror dhe lokal që ushtrojnë kompetenca legjislative, ekzekutive, administrative, gjyqësore ose prokuroriale apo institucione të tjera publike të përcaktuara me ligj.**
   - **1.9. Subjekt privat – nënkupton shoqëritë tregtare, personat juridikë, sipas ligjit për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare dhe persona të tjerë juridikë të përcaktuar me ligj.**
   - **1.10. Zyrtar përgjegjës - personi i caktuar nga institucioni publik apo subjekti privat për të pranuar dhe trajtuar sinjalizimin.**
   - **1.11. Veprim i dëmshëm - çdo veprim apo mosveprim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë që cënon interesin e ligjshëm të sinjalizuesit apo personit të lidhur me sinjalizuesin.**

1.12. Person i lidhur me sinjalizuesin - personi i cili ndihmon sinjalizuesin ose mund të ofrojë prova të lidhura me sinjalizimin apo çdo person tjetër që mund të dëmtohet për shkak të çfarëdo lidhjeje me sinjalizuesin.

1.13. E dhënë personale - çdo informacion lidhur me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm siç përcaktohet me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

1.14. Informacion i klasifikuar - çdo informacion i klasifikuar siç përcaktohet me Ligjin për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë.

Koment, neni 3

1. Qëllimi i nenit 3 është përcaktimi i kuptimit të nocioneve/shprehjeve të cilat rregullohen më detajisht në nenet vijuese të Ligjit. *"Përkufizimet"* janë në funksion të sqarimit të shprehjeve që përdoren në tekstin e Ligjit dhe paraqesin një rëndësi të posaçme, sepse interpretimi i dispozitave tjera duhet të bëhet në harmoni me këto përkufizime. Parimet dhe standardet për hartimin e akteve normative, e në këtë rrafsh edhe ligjeve, përmbajnë këto kritere lidhur me përkufizimet: (a) përkufizohen vetëm ato terma që kanë dykuptimësi; (b) mund të keqinterpretohen; (c) janë të panjohura dhe (4) janë të veçanta për një fushë.[41]Përkufizimet e dhëna në nenin 3, në përgjithësi, janë në dritën e standardeve të lartcekura.

2. Sinjalizuesi është nocioni kryesor[42] i Ligjit, i cili sinjalizuesin e përkufizon si *"çdo person i cili raporton ose shpalos informacione për një kërcënim ose cenim të interesit publik në kontekstin e marrëdhënies së vet të punës në sektorin publik ose privat."* Sipas këtij përkufizimi, sinjalizuesi është person fizik. Sinjalizuesit kanë rol pozitiv për integritetin dhe performancën e institucionit publik apo subjektit privat. Zakonisht, sinjalizuesi shihet si një rrezik apo kërcënim për organizatën apo entitetin ku punon. Mirëpo, në fakt, rrezik paraqesin personat që abuzojnë apo përfitojnë nga shkeljet e ndryshme mirëpo jo sinjalizuesit. Meqenëse sinjalizimi në përgjithësi është një përgjigje pozitive ndaj rrethanave negative që ndodhin në organizatë, atëherë sinjalizuesit duhet të inkurajohen më shumë nga organizatat dhe nga shoqëria.[43]

3. Ligji përcakton se sinjalizuesi raporton apo shpalos informacione për një kërcënim apo cenim të interesit publik. Kërcënimi është veprimi apo mosveprimi i cili rrezikon interesin publik, ndërsa cenimi paraqet veprimin apo mosveprimin me të cilin cenohet, lëndohet apo shkaktohet ndonjë pasojë apo dëm i interesit publik. Ligji përcakton se sinjalizimi mund të bëhet vetëm në mbrojtjen e interesit publik dhe jo për *çështjet* apo interesat personale. Për mbrojtjen e të drejtave apo interesave individuale, individët ndjekin procedurat administrative brenda dhe jashtë institucionit apo procedurat gjyqësore. Në rast se një person vendos të sinjalizojë, ai duhet të jetë i bindur se është duke vepruar në të mirë të interesit publik.

4. Motivet që ndikojnë për të sinjalizuar mund të jenë të ndryshme, por Ligji vendos prezumimin e interesit publik për sinjalizim, por pa e përkufizuar se çfarë është *'interesi publik.'* Lidhur me interesin publik, ka përkufizime të shumta dhe se një përkufizim integrues mund të jetë si në vijim: interesi publik përfshin shumë aspekte

41 Udhëzimi Administrativ Nr.03/2013 për standardet e hartimit të akteve normative. https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8696

42 Për sinjalizuesit përdoren emra të ndryshëm, si: informator, njoftues, raportues. Në gjuhën angleze përdoret shprehja 'whistleblower.'

43 Marcia P. Miceli, Janet P. Near, Terry Morehead Dworkin"Whistle-blowing in Organizations" (New York, by Taylor & Francis Group, LLC, 2008) fq.34.

të cilësisë së jetës njerëzore, duke filluar me të drejtat themelore të njeriut, sigurinë njerëzore, zhvillimin ekonomik, mirëqenien sociale, dinjitetin dhe lumturinë e njerëzve, dhe trashëgiminë e vlerave kulturore.[44]

1. Sinjalizimi, në kuptim të përgjithshëm, është raportimi apo shpalosja e informacioneve apo veprimeve që konsiderohen joligjore, joetike, jokorrekte brenda një organizate, qoftë kjo në kuadër të sektorit publik apo privat e të cilat dëmtojnë interesin publik. Sinjalizimi është i *'dizajnuar'* si një mjet kryesor për të adresuar keqbërje të rrezikshme dhe sjellje jofunksionale në organizatat e sotme. Nuk ekziston një përkufizim i vetëm dhe i pranuar universalisht për sinjalizimin. Termi *"sinjalizim"* rrjedh nga fjala *"sinjalizues"* dhe për herë të parë është përkufizuar nga Ralp Nader si në vijim: "Sinjalizimi është akti i një burri apo gruaje i/e cili/a duke besuar se interesi publik mbizotëron organizatën që ai/ajo i shërben, sinjalizon se organizata është e përfshirë në veprimtari korruptive, të paligjshme, mashtruese ose të dëmshme."[45] Sinjalizimi është akt/veprim me vullnetin e lirë, dhe se askush nuk mund të detyrohet të sinjalizojë.

5. Ligji përcakton se sinjalizimi i cili bëhet brenda organizatës apo jashtë saj, tek një organ kompetent, quhet raportim. Në rastet kur sinjalizimi bëhet jashtë institucionit ku ka ndodhur shkelja dhe jashtë organit kompetent për trajtimin e sinjalizimit të jashtëm, atëherë ky sinjalizim quhet shpalosje. Në fakt, shpalosja është bërja publike apo akt i zbulimit i cili i vihet në dispozicion publikut të gjerë. Ky kategorizim është në pajtim me praktikat ndërkombëtare. Sipas Transparency International (TI), sinjalizuesit përfshijnë edhe individë që janë jashtë marrëdhënies tradicionale të punëdhënësit me të punësuarit, të tillë si: konsulentë, kontraktorë, kursantë/praktikantë, vullnetarë, studentë punëtorë, punëtorë të përkohshëm dhe ish-punonjës.[46]

2. Termi *"person në kontekstin e marrëdhënies së punës",* sipas kornizës së Ligjit, përfshin jo vetëm personat në marrëdhënie aktuale (aktive) të punës, por edhe kategoritë tjera të personave fizikë në kuadër të sektorit publik apo privat, siç janë: bashkëpunëtorët, vullnetarët, praktikantët, kandidatët për punësim, kontraktorë dhe nënkontraktorë shërbimesh, ofrues të shërbimeve pavarësisht kohëzgjatjes dhe pagesës. Ky përkufizim gjithëpërfshirës është bërë me qëllim të zgjerimit të kategorisë së personave të cilët mund të jenë sinjalizues.

6. Termi *"punëdhënës"* në kuptim të këtij Ligji, përfshin të gjitha institucionet e sektorit publik dhe subjektet e sektorit privat, në kuadër të të cilave veprojnë apo kanë vepruar "personat në kontekstin e marrëdhënies së tyre të punës."

3. Dispozitat e nënparagrafit 1.7 të nenit 3 nuk janë të qarta në mënyrën se si janë përpiluar. Por nga konteksti i këtij neni dhe Ligjit në përgjithësi mund të thuhet se qëllimi i këtyre dispozitave ka të bëjë me referimin e autoriteteve përgjegjëse (organeve) jo vetëm me zbatimin e Ligjit, por edhe me mbikëqyrjen e zbatimit të tij. Këto autoritete kryesore janë: (1) Agjencia Kundër Korrupsionit si organ kompetent për sinjalizimin në sektorin publik; (2) Organet rregullatore tek t**ë** cilat b**ë**het sinjalizimi i jashtëm për sektorin privat.

---

44 Legjislacioni kosovar në dy raste i referohet definimit të interesit publik. Kodi Penal, në Nenin 200(4), përcakton: *"Interes publik nënkupton që mirëqenia e përgjithshme e publikut mbipeshon interesin individual."*
Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, në Nenin 3 (1.1.1), përcakton: *'Interes publik – interesi material ose jo material i ligjshëm dhe i drejtë në dobi të qytetarëve'.*

45 Daniele Santoro & Manohar Kumar*,"Speaking Truth to Power A Theory of Whistleblowing"*(Springer International Publishing AG, part of Springer Nature 2018) fq. 11.

46 Transparency International *,"International principles for whistleblower legislation best practices for laws to protect whistleblowers and support whistleblowing in the public interest"* (2013), fq.4.

7. Lidhur me sektorin publik, autoritete kompetente janë edhe institucionet përkatëse të sigurisë, mbrojtjes, inteligjencës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, por edhe komisionet funksionale parlamentare, në këto fusha, për të cilat do të flitet në nenet përkatëse. [47]
8. Me termin *"institucion publik"* Ligji përfshin të gjitha organet, entitetet, agjencitë, autoritetet, apo struktura tjera në nivel lokal dhe qendror, të cilat në mandatin e tyre ligjor dhe kushtetues ushtrojnë kompetenca legjislative, ekzekutive, administrative, gjyqësore ose prokuroriale, apo institucione të tjera publike të përcaktuara me ligj. Lidhur me termet: institucion, autoritet, organ, agjenci, këto janë terma të cilët përmenden në legjislacionin pozitiv. Kushtetuta e Kosovës, si akti me i lartë juridik, për shembull, përmend këto terma në rastin e përcaktimit të fushëveprimit të institucioneve të ndryshme të pushtetit qeverisës.[48]
9. Qëllimi dhe objekti i nënparagrafit 1.9. është kuptim i termit "subjekti privat" që sipas këtij Ligji, nënkupton tri kategori: (1) shoqëritë tregtare, të cilat përfshijnë çfarëdo lloji të shoqërisë tregtare të themeluar në Kosovë, duke përfshirë bizneset individuale, ortakëritë e përgjithshme, ortakëritë e kufizuara, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare;[49] (2) personat juridikë sipas ligjit për lirinë e asocimit në organizata joqeveritare të cilët kanë statusin e personit juridik të pavarur dhe jopërfitues, të themeluar për realizimin e qëllimeve të ligjshme për përfitim publik ose interes të ndërsjellë. Organizata joqeveritare janë personat juridikë të cilët mund të organizohen në tri forma si në vijim: shoqatë, fondacion dhe institut,[50] dhe **(**3) persona të tjerë juridikë të përcaktuar me ligj përfshijnë personat juridikë të cilët kanë fushëveprim specifik dhe rregullohen me ligje apo akte (statute) të veçanta si: partitë politike, komunitetet fetare, sindikatat; kryqi i kuq, etj.
10. Shprehjet tjera të përcaktuara në nenin 3, komentohen tek nenet përkatëse të Ligjit.[51]

Praktikat më të mira ndërkombëtare

1. Sikur TI e gjithashtu edhe Këshilli i Evropës theksojnë rëndësinë e një përkufizimi të gjerë të sinjalizuesve në zemër të legjislacionit të sinjalizuesve. Sipas përkufizimit të marrë nga parimet udhëzuese të TI, sinjalizues është çdo punonjës apo punëtor i sektorit publik ose privat që zbulon informacionin e mbuluar nga përkufizimi i gjerë i TI për sinjalizimin (shih piken 3 më poshtë) dhe që rrezikon të ndëshkohet. Kjo përfshinë individë që janë jashtë marrëdhënies tradicionale punonjës-punëdhënës, të tilla si konsulentë, kontraktorë, kursantë/praktikantë, vullnetarë, studentë, punëtorë të përkohshëm dhe ish-punonjës. Mbrojtja shtrihet në sinjalizuesit që tentojnë dhe perceptohen si të tillë; individët që ofrojnë informacion mbështetës në lidhje me zbulimin; dhe ata që asistojnë ose përpiqen të asistojnë një sinjalizues.
2. Kategorizimi në këtë ligj është në përputhje me praktikat ndërkombëtare.[52]Është e rëndësishme që ta keni një përkufizim të gjerë dhe të qartë të sinjalizimit që mbulon

47 Lidhur me *" autoritetet tjera"* për sektorin publik shih komentet e neneve, 18 dhe 21.
48 Shih p.sh.Neni 3 [Barazia para Ligjit], Neni 41 [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike]; Neni 130 [Autoriteti Civil i Aviacionit], Neni 142 [Agjencitë e Pavarura].
49 Ligji Nr. 06/L -016 për Shoqëritë tregtare/ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 9 / 24 Maj 2018, Prishtinë.
50 Ligji Nr.06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Jo Qeveritare/Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.11/24 Prill 2019, Prishtinë.
51 Shih komentin e neneve 4, 8, 9, 21. te Ligjit.
52 Transparency International,(2013), fq. 4.

një gamë sa më të gjerë të veprimeve të gabuara. Kufizimi i fushës së informacionit për të cilin do të mbrohen individët, do ta pengojë sinjalizimin. Në të vërtetë, nëse njerëzit nuk janë plotësisht të sigurt se sjellja që ata duan të raportojnë u përshtatet kritereve, ata do të heshtin, që do të thotë se organizatat, autoritetet dhe publiku mbesin të panjoftuar ndaj keqbërjeve që mund të dëmtojnë interesat e tyre.[53]

3. Një përkufizim i sinjalizimit pasqyrohet në parimin udhëzues të TI për sinjalizimin si në vijim: "zbulimi i informacionit në lidhje me aktivitete të korruptuara, të paligjshme, mashtruese ose të rrezikshme që kryhen brenda ose nga organizatat e sektorit publik ose privat* - të cilat shqetësojnë ose kërcënojnë interesin publik – pranë individëve ose entiteteve që besohet të jenë në gjendje që të ndërmarrin veprime".

** Përfshirë keqbërje të perceptuara ose të mundshme.*

4. Këshilli i Evropës theksoi gjithashtu se kufizimi i mbrojtjes së sinjalizuesit për lloje të caktuara të veprimeve të gabuara, të tilla si veprat penale të korrupsionit, të zbuluara në organe të caktuara, mund të krijojë konfuzion midis sinjalizimit dhe informimit ose denoncimit dhe mund ta rrisë kundërshtimin ndaj ligjit dhe mosbesimin në qëllimin e tij. Prandaj është e rëndësishme që çdo dispozitë legjislative ta mundësojë ngritjen e një spektri të gjerë të shqetësimeve.[54]

5. Praktikat më të mira ndërkombëtare theksojnë rëndësinë e një përkufizimi të gjerë të keqbërjes (në këtë Ligj "raportimi ose zbulimi i interesit publik"). Një shembull i kësaj theksohet në parimet udhëzuese të TI : sinjalizimi është zbulimi ose raportimi i keqbërjes, duke përfshirë por pa u kufizuar në korrupsion; veprat penale; shkelje të detyrimit ligjor**; gabimet gjyqësore; rreziqet specifike për shëndetin publik, sigurinë ose mjedisin; keqpërdorimi i autoritetit; përdorimi i paautorizuar i fondeve ose i pronës publike; shkaktim i humbjes së madhe ose keqmenaxhim; konflikt interesi***; dhe vepron për ta mbuluar cilëndo nga këto.

** Përfshirë zbulimet financiare mashtruese të bëra nga agjencitët/zyrtarët qeveritarë dhe korporatat publike.

**** Mund të përfshijë edhe shkeljen e të drejtave të njeriut nëse justifikohet ose është e përshtatshme brenda një konteksti kombëtar*

6. Për këtë qëllim, përkufizimi i sinjalizimit në këtë Ligj nuk është plotësisht në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare pasi Ligji përcakton prezumimin e interesit publik për sinjalizim, pa përcaktuar se çfarë është "interesi publik". Përveç kësaj, keqbërja e perceptuar ose e mundshme nuk përfshihet në përkufizimin e "raportimit ose zbulimit të interesit publik" në këtë Ligj.

53 United Nations Office on Drugs and Crime, (UNODC), "*Resource Guide on Good Practices in the Protection of Reporting Persons"* (2015), fq. 22.
https://www.unodc.org/documents/corruption/Publications/2015/15-04741_Person_Guide_eBook.pdf/

54 Council of Europe, *"Protection of Whistleblowers: A Brief Guide for Implementing a National Framework",* (2015), fq. 8. https://rm.coe.int/16806fffbc.

Neni 4

Parimet e përgjithshme të detyrave dhe përgjegjësive të zyrtarit përgjegjës

1. Në ushtrimin e funksioneve të tij/saj, zyrtari përgjegjës:
1.1. vepron me ndershmëri, paanshmëri dhe efikasitet, duke pasur parasysh interesat legjitim të sinjalizimit;
1.2. ruan konfidencialitetin e informatave;
1.3. vepron i pavarur ndaj qëndrimeve politike apo ndaj çfarëdo ndikimi tjetër të padrejtë që mund të pengojë ushtrimin e detyrave të tij/saj nga ky ligj;
1.4. shmang çdo lloj konflikti potencial të interesit, dhe zbulon menjëherë para autoritetit kompetent çfarëdo lloj konflikti të interesit para fillimit të hetimit administrativ të sinjalizimit;
1.5. ndërmerr të gjitha masat e duhura për të mbrojtur dokumentacionin dhe provat në lidhje me njoftimin e zhdukjes, fshehjes, ndryshimit, falsifikimit dhe veprimeve të tjera që kanë për qëllim shkatërrimin e tyre.

Koment, neni 4

1. Neni 4 përcaktimon parimet dhe përgjegjësitë e zyrtarit përgjegjës i cili pranon dhe trajton rastet e sinjalizimit. Zyrtari përgjegjës është personi i caktuar në kuadër të institucionit publik apo subjektit privat që të pranojë rastet e sinjalizimit dhe t'i trajtojë ato sipas detyrës zyrtare. Në ushtrimin e funksionit të tij/saj, zyrtari përgjegjës duhet të veprojë me ndershmëri, paanshmëri, efikasitet, gjithnjë duke pasur parasysh interesat legjitime të sinjalizuesit, të shmang konfliktin e interesit, dhe të administrojë në mirëbesim provat dhe faktet nga fshehja zhdukja, falsifikimi etj.

2. Këto parime mund të thuhet se janë parimet mbizotëruese të punës së zyrtarit përgjegjës për sinjalizimin, sepse kjo është në funksion të besueshmërisë dhe integritetet të procesit të sinjalizimit. Parimi i konfidencialitetit, është një prej parimeve themelore të punës së zyrtarit përgjegjës. Sipas këtij parimi, zyrtari përgjegjës është i detyruar për të ruajtur fshehtësinë e informatave në të cilat ka qasje për shkak të funksionit të tij/saj. Ky parim ka rëndësi thelbësore për besueshmërinë e sinjalizimit dhe mbrojtjen e sinjalizuesit.[55]

3. Parimi i pavarësisë nga qëndrimet politike apo ndikimet tjera është po ashtu në listën e parimeve themelore. Theksi është te neutraliteti politik, sepse mos zbatimi i këtij parimi mund të dëmtojë procesin e sinjalizimit. Shmangia e konfliktit të interesit është po ashtu një prej parimeve kryesore. Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare."[56] Në situata të tilla, zyrtari përgjegjës, në pajtim me legjislacionin në fuqi, njofton autoritetin kompetent, i cili mund të jetë udhëheqësi i drejtpërdrejt në institucionin publik apo subjektin privat ose Agjencinë Kundër Korrupsionit.

55 Më gjerësisht rreth parimit të konfidencialitetit, shih komentin e nenit 11.
56 Neni 6. Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

4. Gjithashtu, parimi i organizimit administrativ dhe kryerjes së detyrës është një nga parimet kryesore. Sipas këtij parimi, zyrtari përgjegjës duhet të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur dhe ruajtur informacionin/ provat/ të cilat mund të jenë objekt i zhdukjes, fshehjes, ndryshimit, falsifikimit dhe veprimeve të tjera që kanë për qëllim shkatërrimin e tyre. Dështimi i tij/saj për të përmbushur këtë parim, ashtu sikurse edhe parimet tjera, mund të rezultojë me përgjegjësi penale për keqpërdorim të detyrës zyrtare.

Praktikat më të mira ndërkombëtare

1. Konfidencialiteti është një kërkesë minimale e çdo legjislacioni që synon të mbrojë sinjalizuesit. Është linja e parë e mbrojtjes dhe e shton besimin në sistemin e sinjalizimit. Garantimi i konfidencialitetit do të ndihmojë në uljen e zbulimeve anonime.[57]Konfidencialiteti vlen jo vetëm për emrin e sinjalizuesit, por edhe për "identifikimin e informacionit". Në organizata të vogla, ose kur disa fakte janë të njohura vetëm për pak persona, disa informacione mundësojnë identifikimin e sinjalizuesit.[58]
2. Një nga mënyrat më efikase për të parandaluar ndëshkimin ndaj një sinjalizuesi është që të sigurohet se hakmarrësit e mundshëm nuk e dinë identitetin e sinjalizuesit. Nëse nuk e dinë se kush e ka bërë zbulimin, ata nuk mund të ndërmarrin masa negative ndaj tyre. Mosnjohja e identitetit të sinjalizuesit ka avantazhin shtesë të zhvendosjes së fokusit nga individi në shqetësimin e ngritur. Prandaj, praktika më e mirë ndërkombëtare është sigurimi i mundësisë individuale për të raportuar në mënyrë anonime dhe për t'u dhënë mbrojtje të plotë atyre sinjalizuesve që kanë zbuluar informacion në mënyrë anonime dhe që më pas janë identifikuar pa pajtimin e tyre të qartë.
3. Raportimi anonim siguron një mekanizëm për të bërë zbulim të informacionit për individët të cilët kanë frikë nga pasojat negative ose supozojnë se do të merret kujdes i pamjaftueshëm për ta mbrojtur identitetin e tyre dhe përndryshe nuk flasin.[59] Lejimi i raportimit anonim duhet të konsiderohet veçanërisht në vendet ku sistemi ligjor është i dobët, ose ku siguria fizike e sinjalizuesve është shqetësuese.[60]
4. Duhet të theksohet se anonimiteti, megjithatë, i ka kufizimet e tij. Së pari, është praktikisht e vështirë të sigurohet mbrojtje gjithëpërfshirëse për një person, identiteti i të cilit është i panjohur. Së dyti, dialogu midis marrësit të zbulimit dhe sinjalizuesit është i rëndësishëm në rastet kur zbulimi nuk përmban informacion të mjaftueshëm për të bërë hetime dhe për të ndërmarrë veprime sanuese. Atëherë mund të nevojitet që të kërkoni nga sinjalizuesi sqarim ose informacion shtesë që ata mund ta kenë. Së treti, sinjalizuesi mund të mos jetë i informuar për përparimin dhe rezultatin e hetimit. Për të sanuar këtë, emaili anonim mund të përdoret nga sinjalizuesit, ndërsa ka edhe platforma në internet që mundësojnë raportimin anonim dhe sigurojnë

57 South African Law Reform Commission*" Discussion Paper, Protected Disclosures 107"*(2014), fq. 45. https://www.justice.gov.za/salrc/dpapers/dp107.pdf.
58 Government Accountability Project (GAP), International Best Practice for Whistleblower Policies, Principle 6 (2016). https://whistleblower.org/international-best-practices-for-whistleblower-policies/
59 Paul Latimer & AJ Brown, *" Whistleblower Laws: International Best Practice* " in UNSW Law Journal (2008) fq. 744, shih, UNODC 2015, fq. 50; shih gjithashtu, për shembull, një sondazh francez që zbuloi se 20 për qind e punëtorëve do të sinjalizojnë vetëm në mënyrë anonime (Harris Interactive, "Lanceurs d'alerte": quelle perceptimi de la part des salariés ?(2015), fq.9. http://harris-interactive.fr/wp-content/uploads/sites/6/2015/12/Rapport-Harris-Perception-des-lanceurs-dalerte-Transparency-International-France-Tilder.pdf.
60 David Banisar,"*Whistleblowing: International Standards and Developments"* (2011). *https://papers.ssrn.com/sol3/Delivery.cfm/SSRN_ID1753180_code1573110.pdf?abstractid=1753180&mirid=1,*

kanale për dialog midis sinjalizuesit dhe marrësit të zbulimit. Organizatat gjithashtu mund të përdorin shërbimet e një pale të jashtme, të tilla si Avokati i Popullit ose organizatat e shoqerisë civile. Në Rumani, zyra e Transparency International vepron si ndërmjetës midis Electrica, një ofrues i madh i energjisë elektrike dhe punonjësve sinjalizues. TI Rumania i merr dhe i anonimizon raportet përpara se t'ia transmetojë ato punëdhënësit. TI Rumania më pas vepron si një ndërmjetës për ta mundësuar dialogun midis sinjalizuesit dhe punëdhënësit. Sinjalizuesi nuk është anonim në kuptimin e përgjithshëm, por kompania nuk e di kush është ai ose ajo.

5. Në çdo rast, ndërsa zbulimet anonime mund ta bëjnë më të vështirë hetimin e një shqetësimi, kjo nuk duhet të bëjë që një shqetësim të mos merret seriozisht. Dhe nëse zbulohet identiteti i sinjalizuesit anonim, atyre duhet t'u jepen të njëjtat të drejta dhe mbrojtje si sinjalizuesve të tjerë. Legjislacioni në Australi është një shembull që i mbron sinjalizuesit anonimë.[61]

6. Ky Ligj nuk parashikon lejimin e raportimit anonim dhe prandaj e përmbushë vetëm praktikën e mirë aktuale duke marrë parasysh raportimin konfidencial. Nëse Ligji nuk përfshinë një dispozitë për raportimin anonim nuk do të thotë se organizatat në sektorin publik dhe privat nuk duhet ta ofrojnë mundësinë e një kanali anonim të raportimit. Nëse një sinjalizues ka frikë nga hakmarrja dhe reprezaljet, është e arsyeshme që ata kanë më pak gjasa të raportojnë. Organizata pastaj humbet informacionin potencialisht të rëndësishëm dhe çdo dëm mund të jetë dukshëm më i madh për kompaninë.

7. Mundësimi i raportimit anonim thyen barrierat, inkurajon numrin më të gjerë të njerëzve që të paraqiten, dhe për këtë arsye u ofron kompanive shkallën më të madhe të mbrojtjes nga rreziku. Sipas Report te sinjalizimit për vitin 2019 te EQS group, për kompanitë që e ofrojnë mundësinë e raportimit në mënyrë anonime, 58 për qind e raporteve fillestare u dorëzuan në mënyrë anonime.[62]

61 Public Interest Disclosure Act 2013,www.legislation.gov.au/Details/C2013A00133.
62 EQS Group, "*Whistleblowing Report"* (2019).
https://www.eqs.com/en-us/compliance-knowledge/white-papers/whistleblowing-report-2019/.

KAPITULLI II - Sinjalizimi, të Drejtat dhe Mbrojtja e Sinjalizuesve

Neni 5

Raportimi dhe shpalosja e mbrojtur

1. **Raportimi dhe shpalosja në interes publik është e mbrojtur kur bëhet për shkak se:**
   - **1.1. shkelja është kryer, është duke u kryer apo ka gjasa të kryhet;**
   - **1.2. personi ka dështuar, është duke dështuar ose ka gjasa të dështojë të përmbush ndonjë detyrim ligjor;**
   - **1.3. ka ndodhur, është duke ndodhur ose ka gjasa të ndodhë keqadministrimi i drejtësisë;**
   - **1.4. shëndeti apo siguria e individit është rrezikuar, është duke u rrezikuar ose ka gjasa të rrezikohet;**
   - **1.5. mjedisi është dëmtuar, është duke u dëmtuar ose ka gjasa të dëmtohet;**
   - **1.6. ka pasur keqpërdorim të detyrës zyrtare apo autoritetit, keqpërdorim të parave publike ose resurseve të një institucioni publik; kjo është duke ndodhur ose ka gjasa të ndodhë;**
   - **1.7. një veprim apo mosveprim nga ose në emër të një institucioni publik është diskriminues, shtypës, kryhet nga pakujdesia ose përbën keqmenaxhim të rëndë;**
   - **1.8. informacioni që synon të tregojë ndonjë nga çështjet që bien në ndonjë nga nënparagrafët e mësipërm ka qenë, është ose ka gjasa të jetë fshehur ose shkatërruar.**
2. **Raportimi apo shpalosja do të supozohet se është në interes publik, përveç nëse vërtetohet e kundërta.**

Koment, neni 5

1. Neni 5 është një prej neneve më të rëndësishme të Ligjit. Ky nen përcakton fushat dhe rrethanat sipas të cilave sinjalizimi është i mbrojtur. Sipas dispozitave të këtij neni, sinjalizimi i mbrojtur është ai sinjalizim i cili bëhet për një dyshim të arsyeshëm se është kryer një shkelje, është duke u kryer aktualisht apo se ka gjasa të kryhet. Termi "shkelje" është gjithëpërfshirës dhe Ligji nuk e përkufizon çka është një "shkelje." Shkeljet mund të jenë veprime apo mosveprime që ndodhin vetëm një herë ose sjellje që përsëriten, dhe disa shkelje të vogla së bashku mund të përbëjnë një shkelje të rëndë. [63]

2. Dispozitat e nënparagrafit 1.1. të nenit 5 kanë këtë përmbajtje: "shkelja është kryer, është duke u kryer apo ka gjasa të kryhet." Këto dispozita mund të interpretohen në dy kuptime: (a) E para lidhet me momentin kohor të sinjalizimit të shkeljes, dhe për këtë nuk ka kufizim, por sinjalizimi i hershëm është me rëndësi të madhe sepse në këtë mënyrë mund të bëhet parandalimi i shkeljes apo praktikës dyshuese dhe të pengohet shkaktimi i dëmit. Vetë sinjalizimi si veprim është i modeluar si një instrument preventiv; (b) Ndërsa interpretimi i dytë ka të bëjë se këto dispozita janë *"një preambulë"* e nënparagrafëve 1.2. deri te 1.8 që ndërlidhen me sinjalizimin e shkeljeve si fushat e caktuara shprehimisht.

63 Wim Vandekerckhove, *"Udhëzuesi për Mbrojtjen e Sinjalizuesve"* (Këshilli i Evropës, qershor 2019) fq. 8. Ky udhëzues gjendet në: https://rm.coe.int/handbook-on-protection-of-whistleblowers-alb/168097ed0c.

3. Termi *"ka gjasa të kryhet"* i referohet *"dyshimit t*ë *arsyeshëm"* se një shkelje mund të ndodhë në bazë të informatave, perceptimit apo analizimit të profilit të rastit konkret. Ligji përfshin disa fusha në kuadër të të cilave mund të ndodhin shkelje të ndryshme, sinjalizimi i të cilave është i mbrojtur.
4. Një prej fushave për të cilat mund të bëhet sinjalizimi i mbrojtur është nëse *personi ka dështuar t*ë *përmbush*ë *një detyrim ligjor.* Dështimi për të përmbushur një detyrim ligjor, sipas këtij neni, i referohet rastit kur personi në kuadër të autorizimeve të tij/saj ligjore ka dështuar, është duke dështuar apo ekziston dyshimi i arsyeshëm se do të dështojë për të përmbushur detyrimin ligjor, sipas afatit të dhënë kohor dhe standardeve të kërkuara. Dështimi mund të jetë si pasojë e veprimeve të qëllimshme apo edhe mosveprimeve, por edhe si pasojë e neglizhencës dhe joefikasitetit. Kjo mund të ketë efekt negativ, jo vetëm në punën e organizatës ku punon, por edhe të dëmtojë interesin publik. *"Detyrim ligjor,"* nënkupton çdo detyrim i cili imponohet nga kushtetuta, ligjet, vendimet e institucioneve të gjyqësisë, rregulloret, statutet, urdhërat, direktivat, njoftimet, kërkesat apo vendim i gjyqësoret i cili është i ndërlidhur me ushtrimin e profesionit, pozitës, veprimtarisë biznesore, shërbimeve publike, në kuadër të sektorit publik apo privat.[64]
5. *Keqadministrimi i drejtësisë* është një fushë tjetër e sinjalizimit të mbrojtur, e përcaktuar me nënparagrafin 1.3. Të drejtat e njeriut, të garantuara me instrumentet kryesore ndërkombëtare dhe kombëtare, jetësohen kur institucionet përgjegjëse japin drejtësi në kohë dhe drejtësia mirëadministrohet. Keqadministrimi i drejtësisë është i ndërlidhur me punën e institucioneve përgjegjëse në rast se dështojnë të kryejnë mandatin e dhënë kushtetues dhe ligjor, i cili është i detyrueshëm për këto institucione. Jo rrallë, mund të ketë keqadministrim të drejtësisë nga institucionet dhe personat përgjegjës që kryhet përmes veprimeve si: ushtrimi i ndikimit, ryshfeti, fshehja e provave relevante, falsifikimi i dokumenteve, pakujdesia, neglizhimi, mosqasja në drejtësi, mungesa e transparencës, vonesa në miratimin e një numri të caktuar aktesh, refuzimi për të dhënë informacion, diskriminimi, anshmëria, mungesa e paanësisë, abuzimi me pushtetin, etj.
6. *Rrezikimi i shëndetit dhe sigurisë s*ë *individit* është një prej fushave kryesore të sinjalizimit të mbrojtur. Në sektorin publik apo privat mund të ndodhin veprime të ndryshme përmes të cilave rrezikohet shëndeti apo siguria e individit. Këto veprime përshijnë (por nuk kufizohen): siguria e ambientit të punës; kujdesi shëndetësor; shërbimet profesionale spitalore; cilësia dhe siguria e ushqimit dhe e ujit; cilësia e shërbimeve të ndryshme që ofrohen nga sektori privat; siguria në trafik, etj.
7. Me dispozitat e nënparagrafit 1.5. është përcaktuar se *dëmtimi i mjedisit* është një nga fushat e sinjalizimit të mbrojtur. Sipas legjislacionit të aplikueshëm, dëmtim i mjedisit "është prishja e karakteristikave fiziko-kimike dhe strukturore të ekosistemit natyror, zvogëlimi i llojllojshmërisë biologjike dhe peisazheve të ekosistemeve natyrore, prishja e ekuilibrit ekologjik dhe cilësisë së jetës të shkaktuara kryesisht nga ndotja e ujit, ajrit dhe tokës prej veprimtarive të njeriut ose fatkeqësive natyrore."[65] Në kuptim të këtij neni, veprimet apo mosveprimit të cilat mund të dëmtojnë mjedisin

64 P.sh. raste të detyrimeve ligjore janë: mosdiskriminimi në vendin e punës, pagesa e tatimit, deklarimi i pasurisë së zyrtarëve publikë, mbrojta e të dhënave personale, ofrimi i kujdesit shëndetësor, zbatimi i vendimeve të gjyqësorit, mospirja e duhanit në ambientet e punës, mos shkaktimi i demit tjetrit, mbajta e maskës gjatë pandemisë Covid -19, etj.
65 Ligji Nr 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Prishtinë: Viti IV / nr. 50 / 06 prill 2009.

janë: ndotja e ujit; ndërtimet pa leje, dëmtimi i lumenjve; prerja e pyjeve; djegia e mbeturinave; zjarrvënia e qëllimshme; peshkimi dhe gjuetia pa leje, etj.

8. Objekti dhe qëllimi i nenparagrafit 1.6. është sinjalizimi i mbrojtur *lidhur me keqpërdorimin e pozitës zyrtare.* Ky keqpërdorim kryhet nga veprimet përmes të cilave personi zyrtar, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin e tij, i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim të përftimit personal apo personave tjerë. Kjo fushë lidhet me veprat penale të korrupsionit, mashtrimit, keqpërdorimit të parasë publike, konfliktit të interesit, ushtrimit të ndikimit, keqpërdorimeve në prokurimin publik, mashtrimeve me tenderë, punësimeve jomeritore, falsifikimit të dokumentit zyrtar, dhënies së ryshfetit; nxjerrjes së kundërligjshme të vendimeve gjyqësore.[66]

9. Nënparafi 1.7 i nenit 5 i referohet *veprimeve apo mosveprimeve diskriminuese dhe shtypëse* të cilat mund të ndodhin nga ose në emër të institucionit publik, por kjo vlen edhe për sektorin privat. Nëse në ndonjë institucion të sektorit publik apo privat ka veprime të tilla, ato mund të sinjalizohen dhe ky sinjalizim është i mbrojtur. Veprimet diskriminuese dhe shtypëse janë shkelje që lidhen kryesisht me të drejtat e njeriut. Një prej vlerave themelore të rendit kushtetues të Kosovës është mosdiskriminimi. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.[67]

10. Dispozita e nënparagafit 1.8. nuk rregullon një fushë të caktuar brenda së cilës mund të ndodhin shkelje, siç janë fushat e sipërtheksuara. Kjo për faktin se kjo dispozitë i referohet vetëm informacionit lidhur me fushat përkatëse por që i njëjti është shkatërruar apo ka gjasa të jetë shkatërruar apo fshehur. Fshehja apo shkatërrimi i informacionit mund të bëhet me qellim të pengimit të procesit të dokumentimit të shkeljeve të ndryshme. Pra duke fshehur apo shkatërruar informacionin relevant, atëherë minimizohet apo humbet edhe mundësia e trajtimit (provuarit) të sinjalizimit.

11. Paragrafi 2 i nenit 5 përmban *prezumim juridik* se sinjalizimi i bërë është në interes publik, përveç nëse vërtetohet e kundërta. Vërtetimi i kundërt bëhet përmes procesit të dokumentimit apo filtrimit të rastit të sinjalizuar. Vetëm pas filtrimit të rastit të sinjalizimit, mund të vërtetohet nëse sinjalizimi i plotëson kriteret për të qenë i mbrojtur, nëse është bërë në interes publik, dhe nëse kemi të bëjmë me shkelje ligjore, shkelje të standardeve profesionale të punës apo kodit të etikës.

Praktikat më të mira ndërkombëtare

1. Në praktikën krahasuese, legjislacioni përkatës për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në disa shtete u referohet vetëm veprave apo praktikave të korrupsionit dhe jo shkeljeve tjera.[68]

66 Kodi Penal, Kapitulli XXXIII, Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, Nenet 414-430.
67 Neni 24 [Barazia para Ligjit] i Kushtetutës së Kosovës.
68 Shih Ligjin Nr. 01, 02 -02010-39/13 datë 16.12. 2013 për mbrojtjen e personave që raportojnë korrupsion në institucionet e Bosnjes dhe Hercegovinës. http://sps.gov.ba/dokumenti/korupcija/Korupcija_zakon.pdf .
Shih Ligjin nr. 60/2016 për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në Shqipëri. https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2018/01/ligj-nr-60-dt-per-sinjalizimin-dhe-mbrojtjen-sinjalizuesve.pdf.

2. Ndërsa Direktiva Evropiane për mbrojtjen e personave të cilët raportojnë shkeljet e ligjit në BE, në nenin 2, përcakton tri kategori të shkeljeve të mundshme të cilat mund sinjalizohen. Kategoria e parë liston një katalog të fushave ku mund të ketë shkelje si në vijim: 1) prokurimi publik; 2) shërbimet financiare, produktet dhe tregjet, dhe parandalimi i pastrimit të parave dhe financimi i terrorizmit; 3) sigurinë dhe pajtueshmërinë e produktit; 4) siguria e transportit; 5) mbrojtja e mjedisit; 6) mbrojtja nga rrezatimi dhe siguria bërthamore; 7) siguria e ushqimit, shëndetit dhe mirëqenia e kafshëve; 8) shëndeti publik; 9) mbrojtja e konsumatorit; 10) mbrojtja e privatësisë dhe të dhënave personale, dhe 11) siguria e rrjeteve dhe sistemeve të informacionit. Kategoria e dytë përfshin shkeljet që ndikojnë në interesat financiare të Unionit, siç përmendet në nenin 325 të TBE dhe luftimin e krimit ekonomik.[69] Kategoria e tretë përfshin shkelje në lidhje me tregun e brendshëm, siç përcaktohet me nenin 26(2) të TBE[70], të cilat kanë të bëjnë me shkeljet e konkurrencës, të ndihmës shtetërore, të tatimit të korporatave.
3. Një shembull udhëheqës është përkufizimi i gjerë i keqbërjes në udhëzimet e sistemeve të menaxhimit të sinjalizimit ISO/DIS 37002. Keqbërja: veprim(e) ose mosveprim(e) që mund të shkaktojnë dëm. *Shënim 1* për tekstin: keqbërja mund të përfshijë, por nuk kufizohet në sa vijon: sjellje joetike, mashtrim, korrupsion, përfshirë ryshfet, shkelje e ligjit (kombëtar ose ndërkombëtar), shkelje e organizatës ose kodin tjetër të mirësjelljes të sjelljes, neglizhencë e rëndë, shkelje e politika e organizatës, diskriminim, ngacmim, bullizëm, përdorim i paautorizuar i fondeve ose burimeve publike, abuzim i autoritetit, konflikt i interesit, shkaktim i humbjes së madhe ose keqmenaxhim. *Shënim 2* për tekstin: keqbërja përfshinë edhe veprim ose mosveprim që rezulton në dëmtim ose rrezik dëmtimi të: të drejtave të njeriut, mjedisit, shëndetit dhe sigurisë publike, praktikave të sigurta të punës ose interesit publik. *Shënim 3* për tekstin: keqbërja ose dëmi mund të ketë ndodhur në të kaluarën ose aktualisht po ndodh ose mund të ndodhë në të ardhmen. *Shënim 4* për tekstin: dëmi i mundshëm mund të përcaktohet duke iu referuar një ngjarjeje të vetme ose një serie ngjarjesh.[71]

Neni 6

Ndalimi i pengimit të sinjalizimit

1. Çdo veprim ose mosveprim që synon pengimin e raportimit apo shpalosjes në interes publik është i pavlefshëm dhe zyrtari përgjegjës apo cilido person tjetër në rastet përkatëse ndiqet penalisht sipas dispozitave penale në fuqi në Kosovë.
2. Çdo dispozitë në një marrëveshje është e pavlefshme nëse synon të:
2.1. ndalojë ose kufizojë raportimin apo shpalosjen në interes publik;
2.2. përjashtojë ose kufizojë zbatimin e ndonjë dispozite të këtij ligji;
2.3. pengojë një person për të filluar ndonjë procedurë në bazë të këtij ligji;

69 Neni 325(1) i TBE, përcakton se "Bashkimi Evropian dhe shtetet anëtare luftojnë krimin ekonomik dhe çdo aktivitet tjetër të paligjshëm që prek interesat e Bashkimit Evropian, përmes masave që duhen marrë në përputhje me këtë nen, të cilat veprojnë si frenues dhe janë të tilla që ofrojnë mbrojtje efektive në shtetet anëtare dhe në të gjitha institucionet, organet, zyrat dhe agjencitë e Bashkimit Evropian." https://www.mei-ks.net/repository/docs/Traktati_i_Lisbones_-_Verzioni_i_Konsoliduar.pdf.

70 Neni 26(2) i TBE përcakton se: "Tregu i brendshëm përfshin një zonë pa kufij të brendshëm, në të cilën sigurohet lëvizja e lirë mallrave, personave, shërbimeve dhe kapitalit, në përputhje me dispozitat e Traktateve".

71 Shih International Organization for Standardization, *"Whistleblowing management systems –Guidelines no. ISO/DIS 37002"*. https://www.iso.org/obp/ui/#iso:std:iso:37002:dis:ed-1:v1:en.

2.4. pengojë një person për të filluar ndonjë procedurë për shkelje të kontratës në lidhje me çdo gjë që bëhet si pasojë e raportimit apo shpalosjes së informatave në interes publik

Koment, neni 6

1. Objekti dhe qëllimi themelor i nenit 6 është përcaktimi i ndalimit të sinjalizimit. Tri elementet themelore të cilat përcaktohen nga dispozitat e këtij neni janë: (1) pavlefshmëria e çdo veprimi që pengon sinjalizimin; (2) përgjegjësia penale e personave që pengojnë sinjalizimin, dhe (3) pavlefshmëria e marrëveshje të cilat mund të kenë në përmbajten e tyre dispozita të tilla.
2. Paragrafi 1 përcakton se çdo veprim i cili pengon sinjalizimin është i pavlefshëm dhe rrjedhimisht nuk prodhon kurrfarë efekti. Në kontekstin e këtij neni, fjala '*veprim'* i referohet aktiviteteve të ndryshme të cilat mund pengojnë kryerjen e sinjalizimin. P.sh.: presioni; kërcënimi me hakmarrje; fshehja e provave apo dokumenteve relevante; bërja e ndonjë marrëveshje me pengim sinjalizimin etj. Ndërsa fjala, *'mosveprim'* lidhet me mospërmbushjen e detyrimeve të ndryshme të cilat e pengojnë sinjalizimin. P.sh.: mostrajtimi i rastit të sinjalizimit, mospërgjigja brenda afateve procedurale, mosvënia në dispozicion e dokumenteve relevante etj. Ky paragraf përcakton edhe përgjegjësinë penale të personit fizik, qoftë ajo e zyrtarit përgjegjës apo cilido person që mund të merr veprime apo mosveprime për të penguar sinjalizimin. Theksi i kësaj dispozite jo rastësisht bie mbi personin zyrtar, sepse roli i tij/saj është thelbësor për trajtimin dhe mirëadministrimin e tij. Në rast të ekzistimit të përgjegjësisë penale, zbatohen dispozitat e legjislacionit penal.
3. Paragrafi 2 përcakton pavlefshmërinë e çfarëdo dispozite e cila mund të jetë e përfshirë në tekstin e një marrëveshjeje me qëllim për të penguar raportimin apo shpalosjen për interes publik. Cilado marrëveshje është e pavlefshme nëse: (1) ndalon apo kufizon sinjalizimin; (2) ndalon apo kufizon zbatimin e një dispozite konkrete të ligjit; (3) pengon një person të bëjë sinjalizimin, dhe (4) pengon një person për të filluar ndonjë procedurë për shkelje të kontratës për shkak të raportimit apo shpalosjes. Por pavarësisht që dispozitat e tilla janë të pavlefshme dhe të pazbatueshme, kjo nuk i liron nga përgjegjësia penale apo disiplinore personat të cilët i kanë përpiluar të njëjtat.

Praktikat më të mira ndërkombëtare

1. Legjislacioni duhet të sigurojë se askush nuk mund ta përjashtojë zyrtarisht të drejtën për sinjalizim.[72] Klauzolat e besnikërisë ose marrëveshjet e konfidencialitetit ose mos-zbulimit ("urdhrat e gjykatës") nuk duhet ta përjashtojnë sinjalizimin. Konsulentët, nënkontraktuesit, praktikantët, vullnetarët ose kursantët, si dhe punonjësit dhe ish-punonjësit, nuk duhet të detyrohen të nënshkruajnë kontrata ose marrëveshje mos-zbulimi që i ndalojnë ata të zbulojnë keqbërjen. Kjo pikëpamje përkrahet nga UNODC, i cili pranon se në rastet kur klauzolat e besnikërisë ose konfidencialitetit në kontratat e punonjësve ndalojnë një person që të ngrejë shqetësime, "ligji heq ose zgjidhë çdo dyshim se raportimi i keqbërjes ose dëmtimit të interesit publik tejkalon çdo detyrë të tillë ndaj punëdhënësit ".[73]

72 Council of Europe, *"Recommendation CM/Rec(2014)7 and explanatory memorandum"* (2014), fq.30.
73 UNODC, (2015) fq. 27; Council of Europe, (2014), Principle 11. & GAP, 2013, Principle 8.

2. Ky Ligj pasqyron praktikën më të mirë aktuale në lidhje me ruajtjen e të drejtave. Shembuj të tjerë të praktikave të mira mund të gjenden në Irlandë, Maltë dhe Zambia.[74]

Neni 7

Të drejtat e sinjalizuesit

1. Sinjalizuesi ka të drejtën e:
1.1. mbrojtjes së identitetit të tij gjatë procesit të sinjalizimit;
1.2. ruajtjen e fshehtësisë së burimit të informacionit të sinjalizuar;
1.3. mbrojtjes kundër veprimeve të dëmshme.
2. Të drejtat e sinjalizuesit garantohen sipas këtij ligji si në vijim:
2.1. gjatë kohëzgjatjes së procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit;
2.2. pas përfundimit të procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit, me qëllim të kryerjes normale të detyrave funksionale të sinjalizuesit në marrëdhënien e vet të punësimit;
2.3. pas përfundimit të marrëdhënies së punës së sinjalizuesit me punëdhënësin e tij, kur nga rrethana të arsyeshme sinjalizuesi ka kërkuar mbrojtjen sipas këtij ligji.

Koment, neni 7

1. Nenit 7 garanton një *korpus t*ë *t*ë *drejtave themelore t*ë *sinjalizuesve* dhe vlefshmërinë kohore e tyre. Këto të drejta janë të ndërlidhura edhe me nene të tjera të këtij Ligji. Ky nen përcakton tri të drejta themelore për sinjalizuesin: (1) të drejtën e mbrojtjes së identitetit gjatë procesit të sinjalizimit, e cila e mbron dhe i jep siguri sinjalizuesit; (2) të drejtën për të ruajtur fshehtësinë dhe burimet e informacionit, e cila *është* shum*ë* e rëndësishme për të mbrojtur jo vetëm sinjalizuesin por edhe personat tjerë të cilët mund të kenë ndihmuar apo 'pajisur' me informacione/dokumente/prova sinjalizuesin; dhe (3) të drejtën për t'u mbrojtur nga veprimet e dëmshme.
2. Veprimet e dëmshme janë veprime apo mosveprime direkte apo të tërthorta që cenojnë interesin e ligjshëm të sinjalizuesit apo personit të lidhur me sinjalizuesin. *Interesi i ligjshëm* ka të bëjë me ushtrimin e të drejtave ligjore të sinjalizuesit, i pa penguar nga subjektet tjera.
4. Ky nen garanton edhe vlefshmërinë kohore të të drejtave të sinjalizuesit, të cilat pa dyshim se janë thelbësore për mbrojtjen e tij/saj. Sipas këtyre dispozitave janë *tri garanci ligjore* të cilat mundësojnë që sinjalizuesi t'i gëzojë këto të drejta. *Garancia e par*ë ka të bëjë me garantimin e të drejtave gjatë kohëzgjatjes së hetimit administrativ. Kjo kohëzgjatje nënkupton periudhën kohore nga momenti i sinjalizimit deri në periudhën e përfundimit të saj.[75] *Garancia e dyt*ë përcakton se të drejtat e sinjalizuesit, sipas këtij neni, ai i gëzon edhe pas përfundimit të hetimit administrativ. Qëllimi i kësaj garancie është për të siguruar sinjalizuesin që edhe pas

74 Neni 4 i ligjit Zambian ka të njëjtin formulim si neni 21 i ligjit te Maltës. Ligji Zambian i qasshëm në: http://www.parliament.gov.zm/sites/default/files/documents/acts/Public%20Interest%20Disclosure%20%28Protection%20of%20Whistleblowers%29%20Act%202010.PDF/
75 Lidhur me procedurën e sinjalizimit dhe afatet kohore të saj, shih komentin e nenit 16.

përfundimit të hetimit administrativ, ai/ajo të vijojë të kryej normalisht detyrat e punës nga marrëdhënia e punësimit qoftë në sektorin publik apo privat, pa u shqetësuar nga pasojat e sinjalizimit. Ndërsa *garancia e tret*ë ka të bëjë me mbrojtjen e sinjalizuesit edhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës, për shkak të *rrethanave t*ë *arsyeshme,* të cilat mund të mbizotërojnë.

3. Në kuptim të këtij neni, përfundimi i marrëdhënies së punës, sipas frymës dhe shkronjës së Ligjit, ka të bëjë me përfundimin e marrëdhënies në kontekstin e punës, (shih komentin e nenit 3, pikën 7). Përfundimi i marrëdhënies së punës mund të bëhet për shkaqe të ndryshme si në vijim: përfundimi i kontratës së punës, ndërprerja e saj me vendim të gjykatës, dorëheqja, pensionimi, largimi apo përjashtimi, përfundimi i punës praktike, përfundimi i punës vullnetare, i kryerjes se shërbimeve kontraktuese, nënkontraktuese, etj.[76]

5. *"Rrethanat e arsyeshme"* mund të jenë të ndryshme dhe të ndërlidhura me individualitetin e sinjalizuesit. Në rast të parashtrimit të kërkesës për mbrojtje edhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës, organi përgjegjës do të vlerësojë këto rrethana për t'u kualifikuar si të arsyeshme. Rrethana të tilla mund të jenë: aspekti social, gjendja financiare, aspekti kulturor, religjioz, etj. Kjo garanci është shumë e rëndësishme, sepse publikimi i identitetit **t**ë sinjalizuesit apo informacionit **t**ë raportuar prej tij mund **t**ë ketë impakt negativ për personin q**ë** ka përfunduar marrëdhënien e punës edhe për faktin se kjo do të pakësonte mundësinë që ai person të sinjalizonte në të ardhmen në kontekstin e marr**ë**dhënies së re të punës.

Praktikat më të mira ndërkombëtare

1. Një nga mënyrat më efikase për të parandaluar hakmarrjen ndaj një sinjalizuesi është të sigurohet se hakmarrësit e mundshëm nuk e dinë identitetin e sinjalizuesit. Nëse ata nuk e dinë se kush e ka bërë zbulimin, ata nuk mund të marrin masa negative ndaj tyre. Mosnjohja e identitetit të sinjalizuesit ka avantazhin shtesë të zhvendosjes së fokusit nga individi në shqetësimin e ngritur. Ekzistojnë dy mënyra të ndryshme për të mbrojtur identitetin e një sinjalizuesi: ruajtja e konfidencialitetit dhe lejimi i raportimit anonim. Në rastin e parë, vetëm marrësi i zbulimit e di se kush është sinjalizuesi, dhe identiteti i sinjalizuesit mund të mos zbulohet pa pëlqimin e qartë të individit. Anonimiteti shkon një hap më tej pasi askush nuk e di identitetin e sinjalizuesit.

2. Konfidencialiteti është kërkesë minimale e çdo legjislacioni që synon të mbrojë sinjalizuesit. Është linja e parë e mbrojtjes dhe do të rrisë besimin në sistemin e sinjalizimit. Garantimi i konfidencialitetit ndihmon në uljen e zbulimeve anonime. Në çdo rast, mbrojtja e ofruar nga konfidencialiteti nuk është absolute, dhe marrësi i zbulimit duhet t'ia bëjë të qartë sinjalizuesit.

3. Para se të bëhet zbulimi duke përdorur kanale të përshtatshme, sinjalizuesi mund t'i ketë përmendur shqetësimet e tij para kolegëve, për shembull, e në këtë rast ekziston rreziku që të gjurmohet se ai/ajo e ka bërë zbulimin.

---

76 Shih p.sh. Ligji Nr. 03/L-212 i Punës, Kreu VIII, Ndërprerja e Marrëdhënies s**ë** Punës, Nenet, 67-77. https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2735.
Shih p.sh. Ligjin Nr. 06/L - 114 për Zyrtar**ë**t Publik**ë**, Kapitulli V, Përfundimi i Marrëdhënies s**ë** Punës në Shërbimin Civil, Nenet, 59-63. https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=25839.

Neni 8

Të drejtat e personit të lidhur me sinjalizimin

1. **Personi i lidhur me sinjalizuesin gëzon të njëjtën mbrojtje si sinjalizuesi, nëse personi i tillë provon se veprimi i dëmshëm është ndërmarrë kundër tij për shkak të lidhjes së tij me sinjalizuesin.**
2. **Personi që provon se veprimi i dëmshëm është ndërmarrë kundër tij për shkak se personi që ndërmerr veprimin e dëmshëm beson gabimisht se ai është sinjalizues ose person i lidhur me të gëzon të njëjtat të drejta dhe mbrojtje si sinjalizuesi.**
3. **Zyrtari përgjegjës gëzon të njëjtën mbrojtje ashtu si sinjalizuesi nëse provohet se veprimi i dëmshëm është ndërmarrë kundër tij në lidhje me pranimin dhe trajtimin e sinjalizimit.**

Koment, neni 8

1. Neni 8 përcakton të drejtat e personit të lidhur me procesin e sinjalizimit nga veprimet e dëmshme të cilat mund t'i pësojë për shkak të kësaj lidhshmërie. Sipas dispozitave të këtij neni, janë tri kategori të personave të cilët gëzojnë të njëjtën mbrojtje si sinjalizuesi, nëse provohet se ndaj tij/saj është ndërmarrë veprim i dëmshëm për shkak të lidhjes së tij me procesin e sinjalizimit.
2. Kategoria e parë përfshin personat e lidhur me sinjalizuesin. Sipas këtij Ligji, personi i lidhur me sinjalizuesin është ai person i cili ndihmon sinjalizuesin ose mund të ofrojë prova të lidhura me sinjalizimin, apo çdo person tjetër që mund të dëmtohet për shkak të çfarëdo lidhjeje me sinjalizuesin. *"Personi ndihmës"* është person fizik i cili në forma të ndryshme ndihmon sinjalizuesit, dhe ndihma e tij duhet të jetë konfidenciale. Kjo ndihmë mund t'i jepet përmes ofrimit të informacioneve, dokumenteve/provave, por edhe përmes mbështetjes dhe inkurajimit moral. Ndërsa, personat e tjerë që mund të pësojnë për shkak të lidhjes me sinjalizuesin janë anëtarët e familjes, kolegët e punës, të afërm të sinjalizuesit, dhe nëse provohet se edhe ndaj tyre është marrë veprim i dëmshëm për këtë shkak, ata gëzojnë të drejtën e mbrojtjes ligjore si sinjalizuesit.
3. Kategoria e dytë përfshin personat që mund të pësojnë nga veprimet e dëmshme të ndërmarra kundër tyre për shkak se gabimisht konsiderohet është ai është sinjalizuesi apo person i lidhur me sinjalizuesin. Për shkak të natyrës konfidenciale të sinjalizimit, personi i sinjalizuar (personi i shqetësuar nga sinjalizimi) mund të kenë dyshime në një rreth të caktuar të personave si sinjalizues të mundshëm apo persona të lidhur me sinjalizuesin. Deri te kjo situatë mund të vie për shkak të raporteve të punës, diskutimeve dhe mospajtimeve paraprake, gjykimit të gabuar të rrethanave të rastit, për shkak të fushëveprimit të caktuar të personit si menaxher kontrate; auditor, certifikues; etj, mbi bazën e të cilave një person mund të perceptohet gabimisht si sinjalizues apo person i lidhur me sinjalizimin.
4. Kategoria e tretë e personave të lidhur me sinjalizimin e që gëzojnë këto të drejta janë zyrtarët përgjegjës për trajtimin e sinjalizimit. Këta zyrtarë, për shkak të funksionit të tyre, mund të jenë objekt i veprimeve të dëmshme, dhe nëse kjo provohet, ata gëzojnë të drejtat e ligjshme sikur edhe sinjalizuesit.

Praktikat më të mira ndërkombëtare

1. Sipas praktikave më të mira ndërkombëtare, mbrojtja nuk duhet të kufizohet vetëm tek individët që kanë bërë zbulimin, por duhet të shtrihet në të gjithë individët që rrezikojnë të trajtohen padrejtësisht si pasojë e sinjalizimit. Kjo duhet të përfshijë: individët të cilët janë gati të bëjnë një zbulim, pasi ata mund të pësojnë masa diskriminuese që synojnë t'i dekurajojnë nga sinjalizimi, ose si "goditje paraprake" për ta shmangur mbrojtjen ligjore[77]; individët që japin informacion përkrahës në lidhje me zbulimin; individët që ndihmojnë ose përpiqen ta ndihmojnë një sinjalizues; individët që perceptohen si sinjalizues, madje gabimisht.[78]
2. Mbrojtja duhet të shtrihet edhe tek të afërmit dhe personat afër sinjalizuesit që rrezikojnë të hakmerren. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në situatat kur shoku ose i afërmi i sinjalizuesit punon për të njëjtën organizatë.
3. Neni 8 i këtij Ligji siguron mbrojtje për një grup të gjerë individësh në rrezik të trajtimit të padrejtë si pasojë e sinjalizimit, dhe për këtë arsye është në përputhje me praktikat më të mira aktuale ndërkombëtare.

Neni 9

Mbrojtja e sinjalizuesve

1. **Sinjalizuesi që raporton ose shpalos informata në pajtim me dispozitat e këtij ligji, nuk mund të jetë subjekt i përgjegjësisë penale ose civile apo procedurave disiplinore.**
2. **Sinjalizuesi ka të drejtën e mbrojtjes sipas këtij ligji, në rastet kur:**
   2.1 raporton ose shpalos informacion, siç është përcaktuar me këtë ligj;
   2.2 me arsye beson se informacioni i raportuar apo i shpalosur është i vërtetë.
3. **Sinjalizuesi nuk është i detyruar të provojë mirëbesimin dhe vërtetësinë e informacionit të sinjalizuar.**
4. **Mbrojtja e garantuar për sinjalizuesin sipas këtij ligji nuk duhet të paragjykohet nëse kërcënimi apo cenimi i interesit publik i pretenduar nuk është materializuar.**

Koment, neni 9

4. Shkronja dhe fryma e Ligjit *është* mbrojtja e sinjalizuesve, dhe kjo përkon edhe nga vetë emërtimi i tij. Lidhur me këtë neni 9 përcakton mbrojtjen e sinjalizuesve nga përgjegjësia penale, civile dhe administrative kur ata sinjalizojnë n*ë* pajtim me Ligjin. Kjo i garanton sinjalizuesit mbrojtje edhe në rast se kërcënimi apo cenimi i interesit publik nuk *është* materializuar. Paragrafi 1 përcakton garancitë ligjore se sinjalizuesi i cili raporton sipas këtij ligji nuk mund të jetë subjekt i përgjegjësisë penale, civile dhe administrative. Sipas kësaj dispozite, kundër sinjalizuesit nuk mund të paraqitet kallëzim penal apo aktakuzë; nuk mund të ketë padi për kompensim dëmi, dhe nuk mund t'i nënshtrohet procedimit disiplinor (administrativ).

77 GAP, (2015) Priciple 4.
78 Paul Latimer dhe AJ Brown (2008), fq. 790.

5. Mirëpo, që sinjalizimi të jetë i mbrojtur, duhet të plotësohen këto kushte: (1) sinjalizimi të jetë **në** pajtim me Ligjin, dhe (2) sinjalizuesi me arsye beson se informacioni **që** ai raporton apo shpalos *është* i vërtet**ë**. Ligji përdor termin *"besim i arsyeshëm"* që nënkupton se sinjalizuesi në momentin e sinjalizimit beson me vetëdije se ekziston kërcënimi apo cenimi i interesit publik. Para se gjithash, është me rëndësi fakti **që** sinjalizuesi të besojë se informacionet që i raporton janë të vërteta dhe sipas kronologjisë së ngjarjeve, beson me vetëdije se shkelja ka ndodhur apo dyshohet se do të ndodhë.
6. *"Besimi i arsyeshëm"* nuk është i njëjtë me *"provën"* - term juridik që nënkupton fakte që shkojnë përtej dyshimit se diçka ka ndodhur. Sinjalizuesi është person raportues dhe jo një zyrtar hetues i cili mbledh prova, sepse mbledhja e provave me qëllim të të provuarit të sinjalizimit nuk është e lejuar. Sinjalizim në interes të publikut nuk do të thotë që të shkelet ligji.[79] Nga sinjalizuesi nuk kërkohet t**ë** provojë apo dokumentojë pretendimet e ngutura përmes raportimit apo shpalosjes.
7. Edhe në rast se kërcënimi apo cenimi i interesit publik nuk është materializuar, prapëseprapë, sinjalizimi është veprimi i duhur. Mosmaterializimi është situata kur shkelja apo praktika dyshuese e sinjalizuar nuk ka ndodhur, nuk është duke ndodhur dhe nuk do të ndodhë realisht, dhe nuk ka cenim të interesit publik. Sinjalizuesi nuk është i detyruar të provojë mirëbesimin dhe vërtetësinë e informacionit të sinjalizuar, dhe nuk ka detyrim të mbledhë apo siguroj**ë** prova.
8. *Në Kosovë janë disa raste të evidentuara* kur personat të cilët kanë raportuar apo shpalosur informacione të tilla në interes publik u janë nënshtruar përgjegjësisë penale. Më i njohuri është rasti i A. Thaçit, ish-punëtor i një banke komerciale, i cili gjatë ushtrimit të detyrës së tij kishte vërejtur transaksione të dyshimta të cilat lidheshin me keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe keqpërdorim të autoritetit të parasë publike. Ai kishte bërë shpalosjen e informacionit rreth këtij rasti, dhe për pasojë, ishte dënuar në procedurë penale, nën akuzën e shkeljes së rregullativës ligjore të operimit të bankës dhe legjislacionit penal.[80]

Praktikat më të mira ndërkombëtare

1. Duke ndjekur praktikën më të mirë aktuale për pragun e mbrojtjes së sinjalizuesve është e rëndësishme që nëse një person beson në mënyrë të arsyeshme se informacioni që ai zbuloi tregon për keqbërje dhe se besimi ishte i arsyeshëm për dikë në pozicionin e tij bazuar në informacionin në dispozicion , atij personi i jepet mbrojtje[81]. Besimi i arsyeshëm në këtë kontekst përcaktohet kur një person në mënyrë të arsyeshme mund të dyshojë për shkelje në dritën e provave të disponueshme. Motivi i individit për të bërë zbulimin, ose nëse ndonjë hetim i mëvonshëm gjen prova të veprës së gabuar, duhet të jetë i jorelevant për statusin e mbrojtur që gëzon sinjalizuesi. Mbrojtja duhet të shtrihet tek ata që bëjnë zbulime të pasakta të bëra pa qëllim, dhe duhet të jetë në fuqi ndërsa vlerësohet saktësia e zbulimit.

79 Shih, WimVandekerckhove,(2019).
80 Rreth këtij rasti, shih: F. Kusari, Sinjalizuesi i dyfishtë, Thaçi. https://sbunker.net/teh/42789/sinjalizuesi-i-dyfishte-thaci/.
81 UNODC, (2015), fq. 24.

2. Disa instrumente ndërkombëtare kërkojnë që zbulimet të bëhen "me mirëbesim".[82] Kjo kërkesë e mirëbesimit ka gjeneruar një debat të madh politik. Disa e lidhin kërkesën e mirëbesimit me informacionin e zbuluar, që do të thotë se kërkesa plotësohet nëse personi që bën zbulimin beson se informacioni që po e jep është i vërtetë. Të tjerët e lidhin kërkesën e mirëbesimit me motivimin personal të sinjalizuesit, duke konsideruar se mbrojtja duhet të kufizohet në punëtorët "e ndershëm" dhe/ose ata që janë të motivuar të flasin sepse duan që të hetohet keqbërja (jo sepse po ndjekin agjenda personale ose hakmarrja). Këto janë shqetësime të kuptueshme, por kërkesa në mirëbesim mund të ketë efektin negativ të zhvendosjes së vëmendjes nga vlerësimi i meritave të informacionit të dhënë në hetimin e motiveve të sinjalizuesit, duke e ekspozuar atë ndaj sulmeve personale. Kjo mund të paraqesë pengesë serioze për sinjalizuesit e mundshëm.
3. Kjo është arsyeja pse parimet e TI nuk i referohen mirëbesimit dhe kërkojnë vetëm "një besim të arsyeshëm se informacioni është i vërtetë në kohën kur zbulohet". Këshilli i Evropës shkon më tej duke deklaruar se parimi i tyre (Parimi 22) "është hartuar në mënyrë të tillë që ta përjashtojë motivin e sinjalizuesit në bërjen e raportit ose zbulimit, ose besimin e tij ose të saj se kjo është relevante për pyetjen nëse duhet të mbrohet sinjalizuesi apo jo".[83]
4. Fokusi i legjislacionit të sinjalizuesve duhet të jetë mesazhi e jo lajmëtari. Kërkesa e mirëbesimit e përfshirë në ligj në Mbretërinë e Bashkuar u hoq në 2013, në përputhje me parimin që sinjalizuesit mund të kenë një numër motivesh por duhet të mbrohen nëse flasin për çështje që janë me interes publik.[84]
5. Duke marrë parasysh sa më sipër, Ligji në Kosovë jep një shembull të praktikës së mirë në atë drejtim, pasi thuhet qartë se sinjalizuesi nuk është i detyruar që ta provojë besimin e mirë dhe vërtetësinë e informacionit të sinjalizimit.

Neni 10

Ndalimi i keqpërdorimit të sinjalizimit

1. Mbrojtja e sinjalizuesit përjashtohet në rastet kur:
1.1. sinjalizimi nuk është kryer për shkaqet e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji;
1.2. raportimi apo shpalosja kryhet në bazë të fakteve, informatave ose dokumenteve që sigurohen lidhur me dhënien e ndihmës juridike;
1.3. sinjalizuesi raporton ose shpalos informacion që ai ka ose mund të ketë dijeni se është i rremë.

Koment, neni 10

1. Sinjalizimi dhe mbrojtja e sinjalizuesve pa dyshim se ka impakt në forcimin e sundimit të ligjit, integritetit institucional dhe mirëqenies së përgjithshme. Në të njëjtën kohë,

82 Shih p.sh. OECD Anti-Bribery Convention; United Nations Convention against Corruption and the Civil Law Convention of the Council of Europe on Corruption.
83 Council of Europe, (2014), fq. 39.
84 Dame Janet Smith DBE, The Shipman Inquiry, Fifth Report - Safeguarding Patients: Lessons from the Past - Proposals for the Future (2004), p. 344. In Australia, the good faith requirement was also partly removed (Fair Work (Registered Organisations) Amendment Act 2016, s.230H (deleting former paragraph 337A(c)) and there are recommendations to remove it completely (Joint Parliamentary Committee on Corporations and Financial Services, Whistleblower Protections, Parliament House, Canberra (September 2017), Recommendation 6.6).

ekziston edhe rreziku i keqpërdorimit të sinjalizimit për motive të ndryshme. Dispozitat e nenit 10 përcaktojnë kornizën ligjore përmes së cilës ndalohet keqpërdorimi i sinjalizimit. Ky ndalim bëhet duke përcaktuar rastet e keqpërdorimit të sinjalizimit i cili nuk gëzon mbrojtje ligjore.

2. *Rasti i parë* i keqpërdorimit të sinjalizimit për të cilën sinjalizuesi nuk gëzon mbrojtje ligjore është nëse sinjalizimi nuk është kryer për shkaqet e përcaktuara në nenin 5 të këtij Ligji. [85]
3. *Rasti i dytë* që e përjashton sinjalizimin e mbrojtur është nëse sinjalizimi kryhet në bazë të informatave që sigurohen lidhur me ofrimin e ndihmës ligjore. Kjo i referohet komunikimeve mes avokatëve dhe klientëve të tyre por edhe mes personave tjerë që mund të ofrojnë ndihmë juridike. Edhe legjislacioni që rregullon ushtrimin e profesionit të avokaturës, në një prej detyrave themelore e përcakton detyrimin e avokati që "të ruaj fshehtësinë e të dhënave, fakteve dhe informatave që i janë dhënë gjatë përfaqësimit të klientëve."[86]
4. *Rasti i tretë* sipas të cilit përjashtohet mbrojtja e sinjalizuesit *është* nëse personi me vetëdije raporton apo shpalos informata të pavërteta për persona fizikë ose subjekte juridike, me qëllim të dëmtimit të një personi apo subjekti. Keqpërdorim i sinjalizimit konsiderohet edhe kur sinjalizuesi, brenda mundësive ekzistuese, nuk ka pasur kujdesin e mjaftueshëm dhe ndërgjegjshmërinë për të kontrolluar saktësinë dhe vërtetësinë e informacioneve.
5. *Në rast se dokumentohet/vërtetohet* keqpërdorimi i sinjalizimit, atëherë sinjalizuesi e humb të drejtën që i takon me ligj për t'u mbrojtur, dhe për më tepër, keqpërdorimi i sinjalizimit paraqet bazë për ngritjen e procedurës penale, civile apo disiplinore.

Praktikat më të mira ndërkombëtare

1. Hisedarët e kanë ngritur shqetësimin se mbrojtja e sinjalizuesve mund të abuzohet nga individë që bëjnë raporte të rreme për të shpifur dikë ose për të mbrojtur veten nga sanksionet disiplinore. Sidoqoftë, hulumtimet dhe praktikat sugjerojnë që raportet e parëndësishme ose të rreme janë të pazakonta.[87]
2. Zbulimet e rreme mund të kenë një ndikim negativ në organizata dhe njerëz dhe mund të diskreditojnë mekanizmat e sinjalizimit. Individët që bëjnë zbulim të rremë me vetëdije nuk duhet të përfitojnë nga mbrojtja e sinjalizuesve. Më tej, Transparency International konsideron se ata duhet t'i nënshtrohen sanksioneve të mundshme dhe detyrimeve civile, dhe ata që akuzohen gabimisht duhet të kompensohen përmes të gjitha masave të duhura. Sanksionet mund të jenë punësim/profesional ose penal, në varësi të asaj që konsiderohet e përshtatshme dhe proporcionale në kontekstin shtetëror. Sanksionet që konsiderohen shumë të rënda do të veprojnë si parandalues për sinjalizimin.
3. Kur ndërmerren masat kundër një personi i cili me vetëdije ka bërë zbulim të rremë, barra e provës duhet të bjerë mbi personin që pohon se informacioni ishte mashtrues, i pavërtetë ose i trilluar. Ata duhet të provojnë se sinjalizuesi e dinte se ishte i rremë në kohën e bërjes së zbulimit.

85 Shih komentin e nenit 5.
86 Ligji nr. 04/l-193 për Avokatinë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 20 / 31 maj 2013, Prishtinë.
87 Shih p.sh. Trace International, ISIS Management, IBLF, First to Know – Robust Internal Reporting Programs (2004), fq. 14; Transparency International (2017), fq. 12.

4. Ky Ligj është në përputhje me praktikat më të mira në lidhje me zbulimet e vetëdijshme të rreme. Sidoqoftë, ai shton një kriter shtesë që mund ta komplikojë atë në praktikë duke deklaruar se mbrojtja e sinjalizuesve përjashtohet në rastin e shpalosjes së informacionit që ai duhet të dijë se është i rremë. Kjo mund të jetë e vështirë në praktikë pasi është e paqartë se kur ndodh ky rast. Në të gjitha rastet, sinjalizuesi duhet të kushtojë kujdes dhe ndërgjegje të mjaftueshme për ta verifikuar saktësinë dhe vërtetësinë e informacionit.

Neni 11

Konfidencialiteti

1. **Zyrtari përgjegjës dhe çdo person tjetër i cili pranon apo përpunon raportime në interes publik gjatë kryerjes së detyrës zyrtare duhet të ruajë në çdo kohë në mënyrë konfidenciale informacionin e lidhur me sinjalizimin, duke mos e përhapur ose transmetuar tek persona të tretë brenda ose jashtë institucionit, si dhe të mos e përdorin për qëllime të tjera, përveç me pëlqimin me shkrim të sinjalizuesit ose për përmbushjen e një detyrimi ligjor që lidhet me:**
   1.1. hetimin efektiv të shkeljeve ligjore;
   1.2. parandalimin e rrezikut serioz për sigurinë e shtetit, shëndetin publik, sigurinë publike ose mjedisin;
   1.3. parandalimin e krimit ose ndjekjen penale;
   1.4. domosdoshmërinë e zbulimit në interes publik ose kur një gjë e tillë kërkohet me ligj.
2. **Zyrtari përgjegjës dhe personat tjerë nuk duhet të njoftojnë personin e përmendur në sinjalizim, përveç nëse kërkohet domosdoshmërisht me ligj.**
3. **Zyrtari përgjegjës duhet të marrë pëlqimin me shkrim të sinjalizuesit në rast se i kërkohet të japë të dhëna që mund të zbulojnë identitetin e sinjalizuesit tek një autoritet kompetent për veprime që nuk mund të ndërmerren pa e zbuluar identitetin e sinjalizuesit.**
4. **Në rastet kur kërkohet me ligj të zbulohet identiteti i sinjalizuesit, zyrtari përgjegjës njofton sinjalizuesin për këtë fakt para si t'ia zbulojë identitetin.**

Koment, neni 11

1. Qëllimi dhe objekti kryesor i nenit 11 është përcaktimi i detyrimit ligjor për zyrtarin përgjegjës dhe personat tjerë të përfshirë në procesin e sinjalizimit, për të ruajtur koncidencialitetin e informacionit të cilin e marrin gjatë këtij procesi. Në fakt, ky nen mund të cilësohet si zgjerim i nenit 4 të Ligjit.[88] *Thelbi i parimit të konfidencialitetit është garantimi për sinjalizuesin se korpusi i informatave të cilat i raporton për shkeljen e caktuar mbahen në fshehësi dhe ndalohet të përhapen apo transmetohen (rrjedhin) tek personat e tretë.*
2. Kriteret përcaktuese për konfidencialitetin e informacionit të raportuar janë: (1) të mos përhapet/apo të rrjedhë tek personat e tretë, brenda apo jashtë institucionit; (2) të mos përdoret për qëllime tjera, përveç nëse sinjalizuesi jep pëlqimin me shkrim, dhe

88 Shih komentin e nenit 4.

(3) për përmbushjen e një detyrimi ligjor. Përjashtimisht, zbulimi i informacionit të raportuar për një shkelje ligjore, standard profesional apo të etikës, mund të bëhet në rastet e caktuara si në vijim:

3. *Rasti i par*ë është për shkak të hetimit efektiv të shkeljes ligjore, përfshirë edhe procedurat gjyqësore. Hetimi efekiv i shkeljes ligjore parashtron domosdoshmërinë që një pjesë e informacionit të raportuar apo i tërë informacioni lidhur me shkeljen t'u bartet apo t'u lejohet qasja organeve kompetente të drejtësisë.
4. *Rasti i dytë* është detyrimi ligjor për parandalimin e rreziqeve serioze si në vijim: (1) siguria e shtetit; (2) siguria publike; (3) shëndeti publik, dhe (4) rrezikimi i mjedisit. Është me rëndësi të theksohet se dispozita ligjore jo rastësisht e diferencon sigurinë shtetërore dhe sigurinë publike. Siguria shtetërore ka të bëjë me sovranitetin e shtetit, ruajtjen e territorit, rendit kushtetues dhe organeve vitale të shtetit, ndërsa siguria publike i referohet sigurisë njerëzore e cila përfshin sigurinë e individit dhe komunitetit **në** mjedisin ku jeton dhe mund të rrezikohet nga kriminaliteti, korrupsioni politik, migrimi i detyrueshëm, shkelja sistematike e të drejtave të njeriut, etj.[89] Ndërsa shëndeti publik dhe mjedisi mund të rrezikohen në rast të përhapjes së sëmundjeve ngjitëse,[90] krizave sanitare, fatkeqësive natyrore apo si rezultat i veprimeve të njeriut.
5. *Rasti i tretë* ka të bëjë me detyrimin ligjor për parandalimin e krimit apo ndjekjes penale. Në këto raste, zyrtari përgjegjës për informacionin të cilin e posedon duhet të vlerësoj, dhe në bazë të përmbajtjes së tij, të njëjtit të procedoj me tutje duke e adresuar në institucionin i cili bën parandalimin e veprave penale apo ndjekjen e veprave penale. Po ashtu, kjo dispozitë është e kufizuar në aspektin e së drejtës lidhur me shpërndarjen e informacionit, sepse e njëjta mund të zbatohet vetëm në rastet specifike të cilat kanë të bëjnë me qëllimet e lartcekura. Andaj, zyrtari përgjegjës duhet të konsiderojë çdo rast kur pranon informata të tilla, dhe të njëjtat t'i adresoj sipas detyrimit ligjor që përcakton kjo dispozitë. Dispozita i referohet me shprehjen "parandalimin e krimit," mirëpo kjo dispozitë ka për qëllim të parandaloj kryerjen e ndonjë vepre eventuale penale, prandaj edhe emërtimi i saj do të duhej të ishte "parandalimin e veprave penale," sepse kështu do të ishte në përputhje me Kodin Penal të Kosovës, për faktin se Kodi Penal i Kosovës nuk e njeh një emërtim të tillë siç është "parandalimin e krimit." Ndërsa shprehja "ndjekja penale" nënkupton detyrimin e zyrtarit përgjegjës në ofrimin e informatave të cilat mund të shërbejnë me rastin e ndonjë hetimi penal.
6. *Rasti i katërt,* sipas të cilit përjashtohet konfidencialiteti i informacionit, sipas këtij neni, vie në shprehje në dy situata: (1) domosdoshmëria e zbulimit për interes publik, dhe (2) nëse kërkohet me ligj. Në fakt, dispozitat e nënparagrafit 1.4. që përcaktojnë rastin e katërt, janë në funksion të dispozitave që përcaktojnë rastet e sipërcekura. Zyrtari përgjegjës ka detyrim ligjor të bartë informacion e materiale të tjera nëse një gjë e tillë është e domosdoshme për interesin publik. E "domosdoshme" ka kuptimin një situate e ngutshme e cila nuk mund të trajtohet sipas procedurës së paraparë ligjore, sepse një gjë e tillë mund të ketë pasoja të renda për interesin publik.[91]
7. Në kudër të këtij neni është përcaktuar edhe detyrimi ligjor, sipas të cilit, zyrtari përgjegjës apo personat e tjerë të cilët sipas autorizimeve ligjore kanë lidhje me rastin

89 Bahri Beqiri dhe Nur Çeku, *"Hyrje ne Politikat e Sigurisë"* (Prishtinë, 2016) fq. 37.

90 P.sh. Pandemia Globale Covid -19, gjatë viteve 2019-2021 paraqet një rast **të** kërcënimit serioz **të** shëndetit publik **në** shumicën e shteteve.

91 Domosdoshmëria e zbulimit të informacionit në interes publik mund të jenë p.sh.: situata emergjente, rendi publik, shëndeti publik, helmimi i ujit apo skadenca e ushqimit, dëmtimi masiv i ambientit, prerja apo djegia e pyjeve, marrëveshje apo një kontratë e dëmshme, etj.

e sinjalizuar të mos e njoftojnë personin e përmendur në rastin e sinjalizimit i cili është subjekt i hetimit administrativ, përveç nëse kjo kërkohet me ligj. Mosrespektimi i kësaj dispozite mund të ketë pasojë juridike përgjegjësinë penale apo disiplinore për personat e përfshirë në rastin e sinjalizimit. *Persona t*ë *tjerë,* në kuptim t**ë** këtij neni, përfshijnë të gjithë personat tjerë, të cilët, për shkak të detyrës zyrtare mund të kenë lidhje me procesin e sinjalizimit, p.sh.: drejtuesi i institucionit i cili është person përgjegjës në mungesë të zyrtarit përgjegjës, persona drejtues të organizatës, zyrtarë të burimeve njerëzore, përkthyesë, ekspertë - prania e të cilëve lind si domosdoshmëri gjatë zbardhjes së rastit të raportuar.

8. Dispozitat ligjore të parapara në paragrafët 3 dhe 4 përcaktojnë kriteret e zbulimit të identitetit të sinjalizuesit. Kriteri ka të bëjë *me dhënien e pëlqimit* nga sinjalizuesi se identiteti i tij t'i bëhet i ditur organit kompetent, sepse rrethanat e rastit e imponojnë këtë gjë, sepse nuk mund të ndërmerren veprime pa zbulimin e identitetit të sinjalizuesit. Dispozitat nuk përcaktojnë se çfarë mund të ndodhë në rast të refuzimit të dhënies së pëlqimit. Por nga përmbajtja e dispozitës del se, në raste të tilla, nuk mund t'i zbulohet identiteti sinjalizuesit. Ndërsa, kriteri i dytë ka të bëjë me *njoftimin e sinjalizuesit* nga zyrtari përgjegjës se identiteti i tij do të zbulohet për shkak se një gjë të tillë e kërkon ligji. Mirëpo, njoftimi nuk ka të bëjë thjesht vetëm sa për ta njoftuar se do t'i zbulohet identiteti, por njoftimi duhet të përmbajë arsyetimin ligjor për këtë veprim.

Praktikat më të mira ndërkombëtare

1. Përveç praktikave të përmendura në Nenin 4, mbrojtja e ofruar nga konfidencialiteti nuk është absolute dhe marrësi i informatës së zbuluar duhet t'ia bëjë të qartë sinjalizuesit. Para se të bëhet zbulimi duke përdorur kanale të përshtatshme, sinjalizuesi mund t'i ketë përmendur shqetësimet e tij para kolegëve, për shembull, e në këtë rast ekziston rreziku që të gjurmohet se ai/ajo e ka bërë zbulimin.

2. Në disa shtete, në situata specifike, ligji mund të kërkojë zbulimin e informacionit identifikues, edhe pa pëlqimin e qartë të sinjalizuesit. Kjo mund të ndodhë, për shembull, kur zbulimi zbulon një vepër penale, nëse çështja shkon në gjyq dhe sinjalizuesi thirret si dëshmitar. Kjo nuk mund të konsiderohet praktikë e mirë. Praktika e mirë dikton që identiteti i sinjalizuesit të mos zbulohet pa pëlqimin e qartë të individit.

3. Nëse ato përjashtime nga konfidencialiteti nuk mund të shmangen, ato duhet të përcaktohen qartë në legjislacion. Më e rëndësishmja, kur informatat e identifikimit duhet të zbulohen, sinjalizuesve duhet t'u jepet njoftim mjaft paraprakisht dhe potencialisht të pajisen me masa shtesë mbrojtëse.

4. Kjo praktikë e mirë është reflektuar vetëm pjesërisht në këtë ligj si në rastin e detyrimit ligjor në lidhje me hetimin efektiv të shkeljeve ligjore, parandalimin e rrezikut serioz për sigurinë, sigurinë ose shëndetin publik në Kosovë, parandalimin e krimit të ndjekjes penale të një vepre penale ose domosdoshmërinë për zbulim në interes publik ose kur kërkohet nga ligji, përjashtohen nga detyrimi për ta mbajtur konfidencialitetin e informacionit dhe detyrimin për pëlqimin me shkrim të sinjalizuesit.

Neni 12

Mbrojtja e të dhënave personale të sinjalizuesit

1. **Të dhënat personale të sinjalizuesit dhe të personave të tjerë të përfshirë në sinjalizim përpunohen vetëm për qëllime të këtij ligji.**
2. **Zyrtari përgjegjës dhe çdo person tjetër që merr të dhëna personale sipas këtij ligji duhet t'i përpunojë ato në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.**
3. **Nëse gjatë trajtimit të informacionit të parashtruar nga sinjalizuesi, haset në të dhëna personale që nuk janë relevante për rastin që është duke u trajtuar, zyrtari përgjegjës apo autoriteti kompetent nuk mund t'i përpunojë më tutje të dhënat e tilla dhe duhet t'i arsyetojë ato.**

Koment neni 12

1. Njëra prej të drejtave themelore të sinjalizuesit dhe personave të tjerë të lidhur me sinjalizimin është mbrojtja e t**ë** dhënave të tyre personale. Sipas legjislacionit, të dhënat personale janë*:* "çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm i cili mund të identifikohet drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, veçanërisht duke iu referuar një identifikuesi në bazë të një emri, një numri identifikimi, të dhënave rreth vendndodhjes, një identifikues online, ose një apo më shumë faktorë specifikë për identitetin fizik, psikologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të atij personi fizik."[92]

2. Neni 12 përcakton detyrimin ligjor se të dhënat personale të sinjalizuesve dhe personave të tjerë që janë të përfshirë në një proces sinjalizimi duhet të përpunohen vetëm për qëllim të zbatimit të këtij ligji. Në rast se ka të dhëna tjera personale jorelevante për kornizën e këtij Ligji, zyrtarët apo institucionet kompetente i shkatërrojnë apo asgjësojnë ato të dhëna.

3. Zbulimi i identitetit të sinjalizuesit është i ndaluar, përveç në rastet kur kjo kërkohet si domosdoshmëri e zbatimit të ligjit. Besimi i sinjalizuesve në zbatimin e këtyre normave dhe procedurave, në parim, inkurajon veprimet lidhur me raportimet. Zyrtari përgjegjës për pranimin dhe trajtimin e sinjalizimeve është i detyruar t'i mbrojë të dhënat personale të sinjalizuesit, sidomos të atyre që kërkojnë të mos iu zbulohet identiteti.

4. Përpunimi i të dhënave personale të sinjalizuesve duhet të bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale nga mekanizmat institucionalë, ankesat, apo çështjet tjera lidhur me të dhënat personale gjatë procesit të sinjalizimit, janë fushëveprim i Komisionerit të Agjencisë për Informim dhe Privatësi.[93]

92 Neni 3, Ligji Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 6 / 25 Shkurt, 2019, Prishtinë.
93 Po aty neni, Neni 53(3).

KAPITULLI III - Llojet dhe Procedura e Sinjalizimit

Neni 13

Llojet e sinjalizimit

1. **Sinjalizimi mund të jetë i brendshëm, i jashtëm dhe publik.**
2. **Raportimi i informacionit të punëdhënësi konsiderohet si sinjalizim i brendshëm.**
3. **Raportimi i informacionit tek autoriteti kompetent konsiderohet si sinjalizim i jashtëm.**
4. **Shpalosja e informacionit në media, tek organizatat joqeveritare, përmes internetit, në një mbledhje publike ose në ndonjë mënyrë**

Koment, neni 13

1. *Sinjalizimi* është *veprim i paramenduar* (i vetëdijshëm/i qëllimshëm) me vullnetin e lirë, përmes të cilit bëhet raportimi apo shpalosja e informacionit për shkeljet të cilat e dëmtojnë interesin publik. Ky informacion nënkupton të dhënat apo njohuritë në bazë të të cilave sinjalizuesi ndërton besimin e arsyeshëm se shkelja ka ndodhur, është duke ndodhur apo do të ndodhë, në kontekstin e marrëdhënies së tij të punës, në institucion publik apo subjektin privat.
2. Mënyra e raportimit të këtij informacioni është kriteri themelor për të përcaktuar llojet e sinjalizimit. Sipas nenit 13, përcaktohen tre lloje të sinjalizimit: (1) sinjalizimi i brendshëm, i cili raportohet në kuadër të punëdhënësit përmes kanaleve të vendosura të raportimit; (2) sinjalizimi i jashtëm, i cili raportohet jashtë institucionit publik apo subjektit privat dhe (3) shpalosja e informacionit që mund të bëhet tek organizatat joqeveritare, në platformat e internetit, në televizion, radio, gazeta, portale, mbledhje (takime, tubime) publike, etj.
3. Sinjalizimi i brendshëm dhe i jashtëm *quhet raportim.* Edhe pse tradicionalisht këto dy lloje të sinjalizimit janë trajtuar si të pavarura, tani ekziston një konsensus i përgjithshëm se sinjalizimi përfshin raportimin e jashtëm dhe brendshëm.[94] Sinjalizimeve të jashtme zakonisht u paraprijnë, sinjalizimet e brendshme të cilat kanë qenë joefektive, apo sinjalizuesit shqetësohen nga frika e hakmarrjes nga punëdhënësi.

Praktikat më të mira ndërkombëtare

1. Gjithmonë ekziston rreziku që zbulimet në lidhje me keqbërjet të mos adresohen ose hetohen siç duhet nga ata që janë të ngarkuar ose nga ata që kërkohet ta bëjnë këtë, domethënë punëdhënësit ose autoritetet. Jo të gjitha keqbërjet mund të zgjidhen pas dyerve të mbyllura. Ndonjëherë debati publik është i nevojshëm për të sjellë ndryshime.
2. Mundësimi i zbulimeve publike lejon që publiku të kërkojë llogari nga organizatat dhe autoritetet. Mund të nxjerrë në pah keqbërje që është neglizhuar ose mbuluar. Siç

94 Kate Kenny, Wim Vandekerckhove, and Marianna Fotaki, "*The Whistleblowing Guide, Speak-up Arrangements, Challenges, and Best Practices",* (First published 2019, UK) fq.29.

është theksuar nga Këshilli i Evropës, sigurimi se sinjalizuesit mund të bëjnë të ditur për palët e jashtme (për publikun) është "një mbrojtje jetike për mbrojtjen e interesit publik". Kjo është përfshirë në të drejtën e lirisë së shprehjes.[95]

3. *Rast i sinjalizuesit nga Mbretëria e Bashkuar:* Një teknik medicinal që punonte në një spital rezidencial zbuloi informata punëdhënësit të tij për kujdesin ndaj pacientit në shtëpinë e kujdesit. Punëdhënësi injoroi shqetësimet e tij, kështu që ai shkoi te rregullatori. Kur ata nuk arritën ta sanojnë situatën, ai shkoi në BBC, i cili ndërmori një hetim të fshehtë. Transmetimi i dokumentarit rezultoi në atë se disa nga anëtarët e stafit u mbajtën penalisht përgjegjës për abuzimet. Kjo gjithashtu çoi në ndryshime brenda agjencisë rregullatore.[96] Kjo u bë e mundur nga fakti që Mbretëria e Bashkuar mundëson sinjalizuesit që të bëjnë zbulime në media.

Neni 14

Forma dhe përmbajtja e sinjalizimit

1. **Sinjalizuesi e paraqet informacionin te zyrtari përgjegjës.**
2. **Informata duhet të jetë e kuptueshme dhe duhet të përmbajë të dhënat e personit kundër të cilit paraqitet sinjalizimi si dhe faktet të cilat i disponon sinjalizuesi.**
3. **Sinjalizimi mund të paraqitet:**
   3.1. me shkrim;
   3.2. me postë apo e-mail; dhe
   3.3. gojarisht.
4. **Kur informata paraqitet gojarisht, zyrtari përgjegjës e përpilon informatën me shkrim dhe të njëjtën e nënshkruajnë sinjalizuesi dhe zyrtari përgjegjës.**

Koment, neni 14

1. Sinjalizimi për të qenë i mbrojtur dhe për t'u trajtuar, duhet të bëhet *sipas formave dhe përmbajtjes* së përcaktuar me Ligj dhe të paraqitet tek zyrtari përgjegjës për pranimin dhe trajtimin e sinjalizimeve. Neni 14 përcaktonë formën dhe përmbajtjen e sinjalizimit. Zyrtari përgjegjës në institucionin publik apo subjektin privat është i autorizuar nga punëdhënësi i tij për të trajtuar rastet e sinjalizimeve.
2. Në rast se punëdhënësi nuk e ka të caktuar zyrtarin përgjegjës, atëherë, *ex officio,* drejtuesi i punëdhënësit e merr vetë përsipër rolin e zyrtarit përgjegjës. Mirëpo, zbatimi në praktikë i këtij paragrafi vjen në shprehje vetëm në rastet e sinjalizimeve të brendshme, sepse, në rast kur bëhet paraqitje e sinjalizimeve të jashtme apo shpalosje, sinjalizuesi nuk mund të jetë në njohuri se cili është zyrtari përgjegjës në kuadër të institucionit apo rregullatorit.
3. Paragrafi 2 i referohet përmbajtjes së informacionit të paraqitur përmes sinjalizimit. Ky informacion duhet të jetë i kuptueshëm dhe relevant lidhur me shkeljen e sinjalizuar. Për aq sa është e mundur, shkelja e pretenduar duhet të jetë e referuar në bazën

95 Council of Europe (2014), fq. 31
96 Steven Swinford and Caroline Gammell, "*Warnings of care home 'were ignored for months'*", The Telegraph, 1 June 2011.www.telegraph.co.uk/news/health/news/8551025/Warnings-of-care-home-were-ignored-for-months.html.

ligjore. Informatat duhet të përmbajnë të dhënat e personit kundër të cilit paraqitet sinjalizimi. Të dhënat e personit në kuptim të këtij neni janë: emri personal, pozita/ vendi i punës, statusi civil, përshkrimi i veprimeve/fakteve për shkelje të mundshme për të cilat pretendohet etj. Këto të dhëna janë të domosdoshme për ndërtimin e profilit të personit/personave që janë subjekt i sinjalizimit.

4. Ligji nuk përkufizon kuptimin e personit kundër të cilit paraqitet sinjalizimi në lidhje me shkeljet e ndryshme. Direktiva e BE-së e përcakton këtë si *"person i shqetësuar,"* që nënkupton *një person fizik ose juridik* i cili është referuar në raport ose zbulim publik si person të cilit i atribuohet shkelja ose me të cilin ai person është i lidhur.[97];

5. Paragrafi 2 përcakton se sinjalizimi mund të bëhet në tri forma si në vijim: *1) me shkrim; 2) me postë/e-mail dhe 3) gojarisht.* Në fakt, dy format e para të sinjalizimit janë forma që bëhen me shkrim, mirëpo mënyra e sinjalizimit dallon. Sinjalizimi me shkrim bëhet në rastet kur sinjalizuesi harton informatën (raportin/njoftimin apo deklaratën) me shkrim rreth shkeljes së pretenduar. Informatat duhet të jenë të sistemuara qartë dhe të mbështetura në faktet e pretenduara. Raportit i bashkëngjiten edhe faktet të cilat mund t'i ketë në dispozicion sinjalizuesi. Në rastet kur sinjalizuesi e dorëzon informacionin personalisht tek zyrtari përgjegjës apo tek organi kompetent, konsiderohet si raportim me shkrim.[98] Kjo formë mund të konsiderohet forma më e përshtatshme e sinjalizimit.

6. *Sinjalizimi me postë/e-mail* bëhet në rastet kur sinjalizuesi harton informatën (raportin/ deklaratën) rreth shkeljeve të pretenduara dhe të njëjtën e dërgon tek mekanizmi kompetent përmes postës klasike/ apo elektronike. Sinjalizimi përmes e-mailit bëhet në rastet kur sinjalizuesi e dërgon informacionin me postë elektronike. Por sinjalizuesi duhet të jetë i njoftuar se kjo mund të mos jetë forma më e sigurt nëse informacioni është konfidencial. E-maili kurrë nuk është privat dhe mesazhi juaj mund të përcjellet tek njerëz të tjerë pa dijeninë tuaj. Një kopje rezervë e email-it tuaj është e ruajtur gjithmonë në një server ku mund të shikohet.[99]

7. *Sinjalizimi i bërë gojarisht* paraqet një formë të sinjalizimit ku sinjalizuesi raporton apo shpalos gojarisht informacionin tek zyrtari përgjegjës, organi kompetent apo tek publiku. Ligji përcakton se për të qenë i vlefshëm raportimi verbal, zyrtari përgjegjës i organit kompetent përpilon një informatë me shkrim e cila ndërtohet mbi rrëfimin e bërë nga sinjalizuesi, dhe të njëjtën deklaratë e nënshkruajnë personi përgjegjës dhe sinjalizuesi.

Praktikat më të mira ndërkombëtare

1. Objektivi kryesor i sinjalizimit është parandalimi ose ndalimi dhe sanimi i keqbërjes. Prandaj është e rëndësishme që marrësi i informatës së zbuluar të jetë në gjendje që ta adresojë keqbërjen e raportuar. Sinjalizuesit gjithashtu duhet t'i besojnë mekanizmit të raportimit dhe të ndihen të qetë lidhur me shfrytëzimin e informatës. Për këtë arsye, Këshilli i Evropës rekomandon që të jenë në dispozicion disa lloje të rrugëve

97 Direktiva e BE-së, Neni 5

98 Lidhur me formën e raportimit të brendshëm si model orientues mund të shërbejë *Modeli i raportit të hetimit të raportimit në interes publik,* sipas Shtojces 2 të Rregullores Nr. 03/2021 për Përcaktimin e Procedurës për Pranimin dhe Trajtimin e Rasteve të Sinjalizimit.

99 Shih Bahrie Lecaj,*"Komunikimi efektiv përmes postës elektronike – Email,"* (USAID, dhjetor 2013). http://naserkastrati.weebly.com/uploads/3/8/8/3/38831473/komunikimi-efektiv-permes-email_final_january-2014.pdf/

të raportimit dhe që rrethanat e secilës rast të përcaktojnë se cili është kanali më i përshtatshëm për t'u përdorur.

2. Nevojitet një gamë e gjerë e kanaleve dhe mjeteve të hapura të zbulimit për të përmbushur situatat e ndryshme me të cilat përballen sinjalizuesit e mundshëm dhe nevojat e ndryshme që mund të paraqiten gjatë zbulimit të informacionit. Duhet të merren parasysh, për shembull, faktorët e tillë si zonat kohore, gjuhët dhe kostoja. Më e rëndësishmja, kur caktoni marrësit e informacioneve të zbuluara, duhet pasur kujdes pavarësia e tyre nga çdo keqbërës i mundshëm i implikuar në atë rast.
3. *Kanalet e raportimit* mund të përfshijnë vendosjen e kutive anonime të brengave rreth organizatës, një adresë të caktuar emaili, linjë telefonike ose takim personal.

Neni 15

Pranimi dhe evidentimi i sinjalizimit

1. **Zyrtari përgjegjës evidenton sinjalizimin e pranuar dhe krijon një regjistër, i cili duhet të përmbajë:**
   1.1. datën e pranimit;
   1.2.emrin dhe mbiemrin e sinjalizuesit;
   1.3.të dhënat e kontaktit të sinjalizuesit;
   1.4. institucionin e sinjalizuesit, dhe
   1.5. përmbajtjen e shkurtër të informatës.
2. **Sinjalizuesit i jepet dëshmi për sinjalizimin e parashtruar dhe lista e çdo dokumenti të parashtruar bashkë me të.**

Koment neni 15

1. Pranimi i sinjalizimit dhe regjistrimi i tij nuk mund të refuzohet për asnjë shkak dhe për asnjë rrethanë. Dispozitat e nenit 15 përcaktojnë kriteret e domosdoshme sipas cilave zyrtari përgjegjës pranon dhe evidenton sinjalizimet. Përmbajtja e nenit gjithashtu i referohet aspektit procedural-teknik të pranimit të sinjalizimit. Me rastin e paraqitjes së sinjalizimit, zyrtari përgjegjës duhet ta pranojë dhe ta regjistrojë në librin (regjistrin) e protokollit. Ky regjistër duhet të jetë në formë fizike dhe elektronike sipas parimeve dhe kritereve të legjislacionit përkatës për administrimin e punës në zyre.[100]
2. Me rastin e paraqitjes së sinjalizimit, të dhënat të cilat duhet të regjistrohen në regjistër janë: emri dhe mbiemri i sinjalizuesit, kontaktet e tij, data e pranimit, institucioni i sinjalizuesit, dhe një përmbajtje e shkurtër e informatës. Institucioni i sinjalizuesit, sipas këtij neni, nënkupton institucionin e sektorit publik apo subjektit privat.
3. Personit që sinjalizon tek zyrtari përgjegjës, me rastin e sinjalizimit, i dorëzohet një letër dëshmi e nënshkruar nga zyrtari përgjegjës në të cilën evidentohet lista e dokumenteve (informacioni) të parashtruara. Kjo dëshmi mund t'i dërgohet edhe përmes postës elektronike.[101]

100 Ligji Nr. 04/L-184 për Administrimin e Punës në Zyrë. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 18 / 28 maj 2013, Prishtinë
101 Për procedurat më të detajuara të administrimit të sinjalizimit nga zyrtari përgjegjës, shih: Rregulloren , Nr. 03/2021 për Përcaktimin e Procedurës për Pranimin dhe Trajtimin e Rasteve të Sinjalizimit.
https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=41216.

Neni 16

Sinjalizimi i brendshëm

1. **Procedura e brendshme e hetimit administrativ të sinjalizimit iniciohet nga momenti i raportimit të informacionit të sinjalizuar.**
2. **Punëdhënësi e njofton sinjalizuesin për pranimin ose refuzimin e sinjalizimit brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të sinjalizimit.**
3. **Procedura e hetimit administrativ të sinjalizimit përfundon sa më shpejt që është e mundur, por në çdo rast, jo më vonë se dyzetepesë (45) ditë nga momenti i raportimit të informacionit të sinjalizuar, përveçse, kur nga rrethanat e rastit kërkohet shtyrja e afatit i cili nuk mund të jetë më i gjatë se dyzetepesë (45) ditë.**
4. **Në fazën e hetimit administrativ, zyrtari përgjegjës shqyrton dhe vlerëson pretendimet e ngritura nga sinjalizuesi.**
5. **Gjatë fazës së hetimit administrativ, zyrtari përgjegjës mund të kërkojë informacion shtesë dhe dokumente relevante, të urdhërojë inspektime ose të marrë deklaratë nga personat në dijeni për çështjen, si dhe të konsultohet me ekspertë të fushës përkatëse.**
6. **Në hetimin administrativ mund të marrë pjesë sinjalizuesi, personi i tretë për të cilin besohet se ka dijeni për rrethanat e sinjalizuara apo posedon dokumentacion relevant.**
7. **Çdo pale pjesëmarrëse në hetimin administrativ i garantohet një proces i rregullt, në pajtim me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe pala:**
   7.1. mund të japë deklaratë me shkrim;
   7.2. të paraqesë prova ose opinione;
   7.3. mund të konsultohet me dosjen e hetimit;
   7.4. ka të drejtë të dëgjohet në lidhje me pretendimet e tij.
8. **Punëdhënësi duhet të vendosë në dispozicion të hetimit të dhënat, dokumentacionin dhe provat e zotëruara prej tij.**
9. **Nëse në përfundim të procesit të hetimit administrativ të sinjalizimit nga punëdhënësi, rezulton se veprimi ose praktika e dyshuar e sinjalizuar përbën ose mund të përbëjë një shkelje ligjore sipas ligjit, punëdhënësi vë në dijeni organin kompetent.**
10. **Punëdhënësi merr masa të menjëhershme, të çastit dhe për aq sa është e mundur, për të parandaluar ose penguar vazhdimin e pasojave të dëmshme nga veprimi ose praktika e dyshuar e sinjalizuar.**
11. **Përveç nëse nuk parashihet ndryshe në këtë ligj, zbatohen dispozitat e legjislacionit për procedurën e përgjithshme administrative.**

Koment, neni 16

1. Neni 16 është një prej neneve themelore të Ligjit. Edhe pse neni titullohet "sinjalizimi i brendshëm," në fakt, përmbajta e tij rregullon procedurën e hetimit administrativ të sinjalizimit të brendshëm në sektorin publik dhe privat - e cila iniciohet nga momenti i raportimit të rastit të sinjalizimit. *Hetimi administrativ* është faza gjatë së cilës informacioni i raportuar i nënshtrohet vlerësimit nëse raportimi është bërë sipas

formës dhe përmbajtjes së përcaktuar me ligj. Hetimi administrativ nis me vlerësim fillestar (faza preliminare apo filtruese) që i bëhet informacionit të raportuar dhe është i ndërlidhur me këto kritere: (1) a është raportimi në interes publik; (2) shkelja e raportuar a është në fushëveprimin e zyrtarit përgjegjës apo ajo bie në kompetencë të një organi tjetër kompetent, dhe (3) nëse raportimi përmban informacion të klasifikuar për shqyrtimin e të cilit zyrtari përgjegjës nuk ka mandat, dhe i njëjti duhet t'i adresohet organit kompetent në fushën e inteligjencës.

2. Zyrtari përgjegjës e shqyrton informacionin e raportuar dhe varësisht nga vlerësimi, vendos nëse janë plotësuar kushtet për t'u pranuar sinjalizimi i mbrojtur dhe që personi raportues të marrë cilësinë e sinjalizuesit. Zytari pergjegjës e njofton sinjalizuesin, në afat prej 15 ditësh, nëse sinjalizimi i bërë pranohet apo refuzohet. Në fakt, kjo zbatohet në rastet kur zyrtari përgjegjës e din identitetin e sinjalizuesit, dhe jo për rastet e sinjalizimeve anonime.

3. Lidhur me kohëzgjatjen e procedurës së hetimit administrativ, Ligji përcakton se kjo procedurë duhet të përfundojë sa më shpejt që është e mundur dhe në çdo rast, jo më vonë se dyzetepesë (45) ditë nga momenti i raportimit të informacionit të sinjalizuar. Nëse rrethanat e rastit janë komplekse, ky afat mund të shtyhet vetëm një herë, por jo më shumë se dyzetë e pesë (45) ditë tjera.[102]

4. Gjatë hetimit administrativ, zyrtari përgjegjës shqyrton dhe vlerëson pretendimet e ngritura nga sinjalizuesi. Gjatë fazës së hetimit administrativ, zyrtari përgjegjës mund të kërkojë: 1) informacion shtesë dhe dokumente relevante; 2) të urdhërojë inspektime ose të marrë deklaratë nga personat në dijeni për çështjen; si dhe 3) të konsultohet me ekspertë të fushës përkatëse.

5. Gjatë hetimit administrativ zbatohen dispozitat e legjislacionit për procedurën e përgjithshme administrative, dhe çdo pale pjesëmarrëse i garantohet një proces i rregullt dhe pala mund të: 1) japë deklaratë me shkrim; 2) të paraqesë prova ose opinione; 3) ka të drejtë të dëgjohet në lidhje me pretendimet e tij/saj; dhe 4) mund të konsultohet me dosjen e hetimit. Pale në hetimin administrativ, të cilat janë: sinjalizuesi dhe personat e tretë të cilët vlerësohen se mund të kenë njohuri relevante rreth rastit të sinjalizuar. [103]

6. Gjatë procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit të brendshëm, palët pjesëmarrëse kanë të drejtë të përdorin gjuhën e tyre amtare, në pajtim me ligjin për gjuhët.[104] Edhe pse Ligji nuk ka dispozitë të caktuar për përdorimin e gjuhës zyrtare gjatë hetimit administrativ të sinjalizimit, kjo rregullohet me dispozitat e ligjit për gjuhët dhe dispozitat e ligjit për procedurën e përgjithshme administrative. Këto dispozita mes tjerash garantojnë të drejtën e sinjalizuesit që të mos ketë kosto buxhetore rreth përdorimit të gjuhës zyrtare. Kjo mund të jetë në rastet kur sinjalizuesi apo zyrtari administrativ apo personi i tretë flasin një gjuhë tjetër zyrtare dhe me këtë rast nevojitet përkthimi i dokumenteve, etj. Në këtë situatë, sinjalizuesi nuk ka detyrim të sigurojë përkthimin dhe ky është obligim i punëdhënësit (organit që zhvillon procedurën).

---

102 Ky afat është në pajtim me dispozitat (neni 98 dhe 99) e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Nr. 20/21/ Qershor 2016. Prishtinë.

103 Procedurat e hetimit administrativ të sinjalizimit, më gjerësisht janë përcaktuar me nenet 9-11 të Rregullores për Trajtimin e Sinjalizimit

104 Shih nenin 2 dhe 4 të Ligjit Nr. 02/L—37 për Përdorimin e Gjuhëve; Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë / Prishtinë :Viti II / nr. 10 / 01 mars 2007.

7. Gjatë hetimit administrativ punëdhënësi duhet të vë në dispozicion dokumentacionin dhe provat të cilat i posedon. Këto prova dhe dokumente përdoren nëse janë relevante për procesin e hetimit administrativ, dhe të njëjtat nuk mund të përdoren përtej këtij qëllimi. Pas përfundimit të hetimit administrativ të sinjalizimit, nëse rezulton se veprimi ose praktika e raportuar përbën ose mund të përbëjë një shkelje ligjore, punëdhënësi vë në dijeni organin kompetent.
8. Praktikisht, sipas kesaj dispozite, zyrtari përgjegjes, harton një raport cili i dorëzohet organit komptent. Organ kompetent i cili mund të vihet në dijeni pas përfundimit të një hetimi administrativ në kuptim të këtij neni mund të jenë: (1) organet e ndryshme/ strukturat brenda institucionit publik/ apo subjektit privat siç janë: komisioni disiplinor, auditori i brendshëm, komiteti i auditimit, zyra për standarde profesionale, inspektori gjeneral, inspektoriati, etj. Ndërsa organ kompetent jashtë institucionit janë: Agjencia Kundër Korrupsionit, Policia, Prokuroria, Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, Avokati i Popullit, Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Agjencia e Inteligjencës Financiare, Dogana e Kosovës, Prokuroria, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës, Administrata Tatimore, etj.
9. Nëse veprimi apo praktika e raportuar ka shkaktuar pasoja të dëmshme, punëdhënësi duhet të ndërmarrë veprime të menjëhershme, për aq sa është e mundur, për të parandaluar ose penguar vazhdimin e këtyre pasojave.Punëdhënësi është i obliguar të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme në lidhje me sinjalizimin duke përfshirë: 1) mbrojtjen nga zhdukja të dokumentacionit dhe provave lidhur me sinjalizimin, dhe 2) fshehja, ndryshimi, falsifikimi dhe veprime të tjera të cilat synojnë dëmtimin ose asgjësimin e tyre. Punëdhënësi është i obliguar të mbrojë sinjalizuesin nga çdo veprim i dëmshëm dhe të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të ndërprerë veprimin e dëmshëm si dhe të largojë çdo pasojë të një veprimi të dëmshëm.

Praktikat më të mira ndërkombëtare

1. Objektivi kryesor i sinjalizimit është parandalimi ose ndalimi dhe sanimi i keqbërjes. Prandaj është e rëndësishme që marrësi i informatës së zbuluar të jetë në gjendje që ta adresojë keqbërjen e raportuar. Sinjalizuesit gjithashtu duhet t'i besojnë mekanizmit të raportimit dhe të ndihen të qetë lidhur me shfrytëzimin e informatës. Për këtë arsye, Këshilli i Evropës rekomandon që të jenë në dispozicion disa kanale të brendshme të raportimit dhe që rrethanat e secilës rast të përcaktojnë se cili është kanali më i përshtatshëm për t'u përdorur[105].
2. Parimet e TI mbi legjislacionin e sinjalizimit theksojnë se rregulloret dhe procedurat e sinjalizuesve duhet të jenë shumë të dukshme dhe të kuptueshme; ta ruajë konfidencialitetin ose anonimitetin (nëse nuk hiqet haptazi nga sinjalizuesi); të sigurojë hetime të hollësishme, në kohë dhe të pavarur të zbulimeve të sinjalizuesve; dhe të ketë mekanizma transparentë, të përmbarueshëm dhe në kohë për t'i ndjekur ankesat e hakmarrjes së sinjalizuesve, përfshirë një proces për disiplinimin e autorëve të hakmarrjes).
3. Parimet e TI për Legjislacionin e Sinjalizuesve theksojnë se organizatat duhet të ofrojnë një gamë të gjerë të kanaleve dhe mjeteve të hapura të zbulimit duhet t'u vihen në dispozicion punonjësve dhe punëtorëve të agjencive qeveritare dhe kompanive

105 Counsel of Europe, (2014), Principle 14.

të tregtuara publikisht, duke përfshirë linjat e këshillave, linjat kujdestare, portalet online, zyrat e pajtueshmërisë dhe ombudsperson të jashtëm. Mekanizmat duhet të sigurohen për zbulime të sigurta, konfidenciale ose anonime të informacionit.

4. Ky Ligj përcakton kërkesa të qarta, përfshirë mekanizmin e feedback-ut për procedurën e raportimit të brendshëm. Sidoqoftë, ai nuk përshkruan kanale të shumta raportimi që ruajnë konfidencialitetin ose anonimitetin, dhe për këtë arsye nuk përmbushë plotësisht praktikën e mirë aktuale.

Neni 17

Obligimet e punëdhënësit

1. **Punëdhënësi publik i cili ka më shumë se pesëmbëdhjetë (15) të punësuar, dhe punëdhënësi privat, i cili ka më shumë se pesëdhjetë (50) të punësuar janë të obliguar të caktojnë zyrtarin përgjegjës.**
2. **Punëdhënësi është i obliguar të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme në lidhje me sinjalizimin, përfshirë mbrojtjen e dokumentacionit dhe provave nga zhdukja, fshehja, ndryshimi, falsifikimi si dhe veprime të tjera të cilat synojnë dëmtimin ose asgjësimin e tyre.**
3. **Punëdhënësi është i obliguar të mbrojë sinjalizuesin nga çdo veprim i dëmshëm dhe të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të ndërprerë veprimin e dëmshëm si dhe të largojë çdo pasojë të një veprimi të dëmshëm.**
4. **Përjashtimisht sinjalizuesi mund t'i drejtohet drejtpërdrejtë drejtuesit të punëdhënësit, në rastet kur:**
   - **4.1. punëdhënësi nuk ka zyrtar përgjegjës;**
   - **4.2. punëdhënësi nuk ka përcaktuar dhe publikuar procedura të brendshme për pranimin dhe trajtimin e sinjalizimeve;**
   - **4.3. sinjalizuesi ka dyshime të arsyeshme se zyrtari përgjegjës është ose mund të përfshihet në praktikën e dyshuar të sinjalizimit;**
   - **4.4. sinjalizuesi ka dyshime të arsyeshme se zyrtari përgjegjës për shkak të çfarëdo marrëdhënie ose shoqërie me një person që është ose mund të jetë i përfshirë në çështjen e pretenduar në sinjalizim, nuk është personi i përshtatshëm për t'u informuar me sinjalizimin;**
   - **4.5. sinjalizuesi ka dyshime të arsyeshme se procedurat e brendshme të sinjalizimit nuk janë efektive.**
5. **Qeveria, sipas propozimit të Ministrisë së Drejtësisë, e përcakton procedurën për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit, me akt nënligjor.**
6. **Subjektet private e përcaktojnë procedurën për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit me akt të brendshëm, në pajtim me këtë ligj.**

Koment, neni 17

1. Fryma e ligjit është që, fillimisht, sinjalizimi duhet të bëhet brenda organizatës, tek zyrtari përgjegjës. Sinjalizimi i brendshëm konsiderohet si mënyra më e mirë për të marrë informacione relevante të cilat mund të kontribuojnë në zgjidhjen e hershme dhe efektive të rreziqeve për interesin publik dhe shmangien e pasojave. Ligji detyron

të gjitha institucionet e sektorit publik dhe subjektet e sektorit privat të krijojnë kanalet e raportimit të brendshëm në përpjesëtim me madhësinë e tyre.

2. Institucionet publike të cilat kanë më shumë se (15) pesëmbëdhjetë persona të punësuar janë të detyruara të caktojnë zyrtarin përgjegjës si kanal të brendshëm raportimi. Ky detyrim vlen për të gjitha organet, autoritetet dhe agjencitë publike si të nivelit qendror ashtu edhe atij lokal, të cilat ushtrojnë kompetenca legjislative, administrative, gjyqësore, prokuroriale apo institucione të tjera publike të përcaktuara me ligje të veçanta.
3. Subjektet private të cilat kanë më shumë se (50) pesëdhjetë persona të punësuar janë të detyruara të caktojnë zyrtarin përgjegjës si kanal të brendshëm raportimi. Subjekte të sektorit privat janë: a) shoqëritë tregtare,[106] b) personat juridikë sipas ligjit për lirinë e asociimit,[107] dhe c) persona tjerë juridikë të përcaktuar me ligj.[108]
4. Ligji, parimisht, përcakton se sinjalizimi bëhet tek zyrtari përgjegjës, por përjashtimisht, sinjalizuesi mund t'i drejtohet drejtpërdrejt drejtuesit të punëdhënësit, në rastet kur: 1) punëdhënësi nuk ka zyrtar përgjegjës; 2) punëdhënësi nuk ka përcaktuar dhe publikuar procedura të brendshme për pranimin dhe trajtimin e sinjalizimeve; 3) sinjalizuesi ka dyshime të arsyeshme se zyrtari përgjegjës është ose mund të përfshihet në praktikën e dyshuar të sinjalizimit; 4) sinjalizuesi ka dyshime të arsyeshme se zyrtari përgjegjës për shkak të çfarëdo marrëdhënie ose shoqërie me një person që është ose mund të jetë i përfshirë në çështjen e pretenduar në sinjalizim, nuk është personi i përshtatshëm për t'u informuar rreth sinjalizimit; 5) sinjalizuesi ka dyshime të arsyeshme se procedurat e brendshme të sinjalizimit nuk janë efektive. Në këto raste, drejtuesi (titullari) i institucionit është personi përgjegjës për trajtimin e sinjalizimit.
5. Tek detyrimet e punëdhënësit lidhur me procedurat e sinjalizimit, në kuadër të këtij neni, është paraparë nxjerrja e aktit nënligjor i cili detajisht rregullon procedurën e sinjalizimit të brendshëm. Autoritet kompetent për nxjerrjen e këtij akti për sektorin publik është Qeveria, sipas propozimit të Ministrisë së Drejtësisë,[109] ndërsa për sektorin privat përcaktohet që secili entitet në kuadër të këtij sektori të nxjerrë aktin e brendshëm.[110]
6. Lidhur me caktimin e zyrtarit përgjegjës dhe ushtrimin e funksionit të tij, nga përmbajta e këtij neni dhe Ligjit në përgjithësi, dalin disa detyrime të rëndësishme për punëdhënësin edhe pse nuk janë të përcaktuara shprehimisht. Lidhur me caktimin e zyrtarit përgjegjës, punëdhënësi duhet të marrë në konsideratë këto kritere: a) të jetë

106 Neni 3 (1.1.22.) i Ligjit për Shoqëri Tregtare përcakton se "Shoqëria tregtare përfshin çfarëdo lloji të shoqërisë tregtare të themeluar në Kosovë sipas këtij ligji apo të një ligji tjetër duke përfshirë bizneset individuale, ortakëritë e përgjithshme, ortakëritë e kufizuara, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare." Ligji Nr. 06/L -016 për Shoqëritë Tregtare/ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 9 / 24 Maj 2018, Prishtinë.

107 Neni 3 (1.1.2) i Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare përcakton "Organizata Joqeveritare (OJQ)"- është person juridik i pavarur dhe jo për përfitim, i themeluar për realizimin e qëllimeve të ligjshme për përfitim publik ose interes të ndërsjellë." Ligji Nr.06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare/Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.11/24 Prill 2019, Prishtinë.

108 Lidhur me sinjalizimin në sektorin privat, shih doracakun e shkëlqyer të Lëvizjes FOL me titull "*Doracak me 10 skenarë të reagimit për rastet e sinjalizimit në sektorin privat,"* (Prishtinë, 2020). https://levizjafol.org/wp-content/uploads/2020/11/Doracak-me-10-skenar%C3%AB-t%C3%AB-reagimit-p%C3%ABr-rastet-e-sinjalizimit-n%C3%AB-sektorin-privat.pdf.

109 Ky akt nënligjor është Rregullore (QRK) - Nr. 03/2021 për Përcaktimin e Procedurës për Pranimin dhe Trajtimin e Rasteve të Sinjalizimit, i aprovuar në mbledhjen e Qeverisë, më datë 30.04.2021, me Vendimin nr. 01/10.

110 Për modelin e një akti të brendshëm për trajtimin e sinjalizimeve në subjektet e sektorit privat, shih: Udhëzues për sinjalizimin në sektorin privat, Shtojca A. Akti për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimeve, (Lëvizja FOL, 2020, Prishtinë). fq. 19. https://levizjafol.org/wp-content/uploads/2020/11/Udh%C3%ABzues-p%C3%ABr-sinjalizimin-n%C3%AB-sektorin-privat.pdf.

në pozitë udhëheqëse; (b) të ketë arsimim të lartë në fushën e drejtësisë apo shkencave tjera sociale; (c) të ketë përvojë në shqyrtimin e çështjeve disiplinore, hetimore, inspektuese, të auditimit të brendshëm, kontrollit financiar, etj. Detyrimi tjetër për punëdhënësin lidhet me sigurimin e kushteve të përshtatshme të punës për zyrtarin përgjegjës: (a) hapësirën e përshtatshme për punë; (b) pajisje teknike të veçanta, si: kompjuter, telefon, i cili është i qasshëm vetëm nga zyrtari përgjegjës; (c) regjistër dhe vulë të veçantë; c) sef për sigurimin e informacionit të sinjalizuar.

Praktikat më të mira ndërkombëtare

1. Shtetet duhet të marrin në konsideratë ndëshkimet civile dhe sanksionet tjera për punëdhënësit të cilët dështojnë në zbatimin e një mekanizmi të brendshëm të sinjalizimit brenda një periudhe të caktuar kohe pasi ligji të hyjë në fuqi.[111] Për shembull, legjislacioni francez parashikon sanksione të larta financiare për ndërmarrjet private dhe shtetërore me më shumë se 500 të punësuar dhe një qarkullim më të lartë se 100 milion €, si dhe për kryeshefin e tyre, nëse nuk vendosin procedura të brendshme të sinjalizimit për të zbuluar informacion në lidhje me veprimet e korrupsionit dhe ushtrimit të ndikimit (deri në 1 milion € për kompaninë dhe 200,000 € për kryeshefin personalisht).[112] Në Itali, nëse administrata publike nuk i zbaton procedurat e sinjalizimit siç parashikohet nga legjislacioni, Autoriteti Antikorrupsion mund ta sanksionojë zyrtarin antikorrupsion të këtij institucioni me gjobë deri në 50,000 €.[113]
2. Përtej kërkimit nga organizatat që të miratojnë mekanizma të fuqishëm të mbrojtjes së sinjalizuesve të brendshëm, ka mënyra të tjera në të cilat qeveritë mund të stimulojnë miratimin e mekanizmave të tillë. Në disa shtete, programi para-ekzistues i etikës dhe përputhshmërisë dhe i efektshëm i kompanisë mund të konsiderohet si një faktor lehtësues në sanksionimin ndaj sjelljes së keqe të korporatave, ose si një faktor në përcaktimin nëse duhet apo jo të hyni në një zgjidhje.[114]

Neni 18

Sinjalizimi i jashtëm

1. **Sinjalizuesi mund të bëjë sinjalizim të jashtëm pasi ka kryer sinjalizimin e brendshëm, apo drejtpërdrejtë sinjalizim të jashtëm në rastet kur:**
   1.1. Sinjalizimi ka të bëjë me drejtuesin e punëdhënësit;
   1.2. Sinjalizimi ka karakter urgjent që ndërlidhet me një rrezik të rëndë dhe të menjëhershëm ose dëme të pakthyeshme;
   1.3. Ka dyshime të arsyeshme se mund të ndërmerren veprime të dëmshme ndaj sinjalizuesit, provat mund të fshihen ose asgjësohen nëse ky do të kryente sinjalizim të brendshëm;

111 Blueprint for Free Speech, (2016), https://www.blueprintforfreespeech.net/en/library/reports.
112 Neni 17, i Ligjit Sapin II, (Ligji francez, Nr. 2016-1691 për transparencën, luftimin e korrupsionit dhe modernizimin e jetës ekonomike).
113 Itali, Dispozitat për mbrojtjen e individëve që raportojnë krime ose parregullsi që kanë dalë në dritë në kontekstin e marrëdhënies publike ose private të punës, neni 1.6.
114 OECD, *"Corporate Governance and Business Integrity, A Stocktaking of Corporate Practices".* (2015), fq. 80. https://www.oecd.org/daf/ca/Corporate-Governance-Business-Integrity-2015.pdf.

1.4. kur sinjalizuesi ka dyshime të arsyeshme se procedurat e brendshme të sinjalizimit nuk janë efektive.

2. Procedura për sinjalizim të jashtëm për sektorin publik iniciohet me raportimin e informacionit tek Agjencia Kundër Korrupsionit. Agjencia Kundër Korrupsionit zbaton procedurën e paraparë me nenin 16 të këtij ligji.

3. Agjencia Kundër Korrupsionit shqyrton rastet e sinjalizimit që bien në fushëveprimin e vet.

4. Nëse Agjencia Kundër Korrupsionit nuk ka kompetencë për të vepruar, e përcjellë pa vonesë informatën tek autoriteti kompetent, si dhe e informon sinjalizuesin për një veprim të tillë.

5. Në rastet kur sinjalizuesi nuk pranon t'i zbulohet identiteti, dhe Agjencia kundër Korrupsionit nuk ka kompetencë për ta trajtuar informatën, para se ta përcjellë informatën tek autoriteti tjetër kompetent, ajo kërkon miratimin e sinjalizuesit, përveç nëse është paraparë ndryshe me ligj.

6. Me kërkesë të sinjalizuesit, autoriteti kompetent i jep atij informata për statusin e procedurës dhe të gjitha veprimet e ndërmarra, si dhe i mundëson atij që të ketë qasje në shkresat e lëndës dhe të marrë pjesë në veprime gjatë procedurës në pajtim me ligjin.

7. Autoriteti kompetent e njofton sinjalizuesin për rezultatin e procedurës pas përfundimit të saj.

8. Autoritetet kompetente për sinjalizimin e jashtëm zbatojnë afatet e përcaktuara në nenin 16 të këtij ligji.

Koment, neni 18

1. Neni 18 ka për qëllim të përcaktojë procedurën e paraqitjes së sinjalizimit të jashtëm në sektorin publik, edhe pse titulli i nenit i referohet sinjalizimit të jashtëm në përgjithësi. Sinjalizimi i jashtëm është raportimi që sinjalizuesi bën në një institucion tjetër jashtë institucionit ku ai punon. Standardet ndërkombëtare kërkojnë që ky institucion të jetë i themeluar me ligj dhe të ketë pavarësi në funksionimin e tij. Këto institucione duhet të kenë aftësinë operuese që të sigurojnë integritetin dhe konfidencialitetin e informacionit të raportuar dhe të parandalojnë qasjen e personave jokompetentë në këtë informacion.

2. Një element shumë i rëndësishëm që duhet të theksohet është se autoritetet të cilat pranojnë raportime të tilla, pra të jashtme, nuk janë të dizajnuara që të veprojnë si shkallë institucionale e organeve që trajtojnë sinjalizim të brendshëm. Pra, ato janë të pavarura dhe nuk kanë mandat të ndryshojnë dhe plotësojnë vendimet e nxjerra nga procesi i sinjalizimit të brendshëm. Mirëpo kjo nuk pengon apo përjashton mundësinë që institucionet të cilat trajtojnë sinjalizimin e jashtëm të shqyrtojnë një rast të njëjtë, i cili paraprakisht është shqyrtuar brenda institucionit të sektorit publik apo privat si sinjalizim i brendshëm, dhe të kenë gjetje apo përfundime të tjera.

3. Sipas këtij neni, sinjalizimi i jashtëm mund të bëhet në dy *rrethana*: e para, pasi sinjalizuesi ka kryer sinjalizimin e brendshëm paraprakisht, por për shkaqe të ndryshme ky sinjalizim është refuzuar; sinjalizuesi nuk është njoftuar me statusin e rastit; apo ka pasur një përfundim jo meritor të sinjalizimit të brendshëm sipas vlerësimit të sinjalizuesit. *E dyta* përmban katër kushte sipas të cilave sinjalizimi i jashtëm mund të

bëhet drejtpërdrejt: 1) sinjalizimi ka të bëjë me drejtuesin e punëdhënësit; 2) sinjalizimi ka karakter urgjent për shkak të një rreziku të rëndë dhe të menjëhershëm ose me dëme të pakthyeshme; 3) ka dyshime të arsyeshme se mund të ndërmerren veprime të dëmshme ndaj sinjalizuesit, se provat mund të fshihen ose asgjësohen nëse ky do të kryente sinjalizim të brendshëm; 4) kur sinjalizuesi ka dyshime të arsyeshme se procedurat e brendshme të sinjalizimit nuk janë efektive. Para se të bëjë një sinjalizim të jashtëm të drejtpërdrejtë, sinjalizuesi duhet të vlerësojë nëse rasti konkret plotëson një nga këto kushte apo disa nga to.

4. Për gjithë sektorin publik procedura e sinjalizimit të jashtëm iniciohet me raportimin e informacionit në Agjencinë Kundër Korrupsionit (AKK). Për trajtimin e rasteve të sinjalizimit të jashtëm AKK zbaton procedurën e hetimit administrativ, siç përcaktohet me dispozitat e nenit 16 të Ligjit.[115] Në dukje, ka një konfuzion për sa i përket afatit kohor për shqyrtimin e rasteve të sinjalizimeve të jashtme nga AKK-ja. Ligji, në nenin 16, përcakton afatin e përgjithshëm prej 90 ditësh (45+45) brenda së cilit duhet të përfundojë procedura e trajtimit të rasteve të sinjalizimit, ndërsa Ligji për AKK-në përcakton afatin 6 mujor për hetime paraprake (përjashtimisht + 6 muaj tjerë). Në rastet e trajtimit të sinjalizimeve të jashtme, AKK-ja zbaton procedurën e paraparë me nenin 16 të Ligjit, ndërsa pas përfundimit të rastit, nëse shkelja e raportuar bie në fushëveprim të AKK-së (parandalim të korrupsionit apo shmangie të konfliktit të interesit) do të shqyrtohet *"in meritum"* nga AKK-ja. Ky është momenti kur përcaktohet natyra e shkeljes dhe shqyrtimi i saj i nënshtrohet afatit procedural për hetimet paraprake.

5. Një pyetje e cila meriton të ngritet lidhur me këtë nen ndërlidhet me atë se cili është autoriteti kompetent për sinjalizim të jashtëm për punonjësit e AKK-së. Dispozitat e Ligjit janë të heshtura në këtë aspekt. Mirëpo, nisur nga modelimi dhe natyra e AKK-së si institucion i themeluar dhe i mbikëqyrur nga Kuvendi i Kosovës, autoritet përgjegjës për rastet e sinjalizimit të jashtëm për punonjësit e AKK-së duhet të konsiderohet Komisioni Parlamentar përgjegjës për mbikëqyrjen e AKK-së.[116]

6. Në rastet kur AKK-ja nuk ka mandat për të vepruar, atëherë rastin e përcjell tek autoriteti kompetent. Në kuptim të këtij neni, autoritet kompetent është institucioni publik në kornizën e të cilit bie trajtimi i rastit konkret të sinjalizimit. Në rastet kur AKK-ja dërgon rastin tek autoritetet tjera, e informon sinjalizuesin për një veprim të tillë. Në rastet kur sinjalizuesi nuk pranon t'i zbulohet identiteti, dhe Agjencia Kundër Korrupsionit nuk ka kompetencë për ta trajtuar informatën para se ta përcjellë informatën tek autoriteti tjetër kompetent, ajo kërkon miratimin e sinjalizuesit, përveç nëse është paraparë ndryshe me ligj.[117] Me kërkesë të sinjalizuesit, autoriteti kompetent i jep atij informata për statusin e procedurës dhe për të gjitha veprimet e ndërmarra, si dhe i mundëson atij që të ketë qasje në shkresat e lëndës dhe të marrë pjesë në veprimet gjatë procedurës, në pajtim me ligjin. Autoriteti kompetent e njofton sinjalizuesin për rezultatin e procedurës pas përfundimit të saj.

115 Shih komentin e nenit 16.
116 Neni 14 [Kompetencat e Komisionit] të Ligjit për AKK.
117 Shih komentin e nenit 11.

Praktikat më të mira ndërkombëtare

1. Nëse raportimi i brendshëm nuk ka qenë efektiv - për shembull, ka pasur ndonjë vendim për të mos hetuar, ose hetimi nuk ka përfunduar brenda një periudhe të caktuar kohe, ose nuk është ndërmarrë asnjë veprim pavarësisht nga rezultatet pozitive të hetimit, ose sinjalizuesi nuk ka marrë informacion në lidhje me çështjen brenda një periudhe të caktuar kohe - sinjalizuesit duhet të jenë në gjendje që t'u drejtohen autoriteteve në mënyrë që shkeljet të mund të adresohen.[118]
2. Ka edhe shumë arsye valide pse një sinjalizues mund të preferojë raportimin e keqbërjes direkt tek autoritetet sesa të përdorë mekanizma të brendshëm të raportimit. Për shembull, nëse ata kanë frikë ose kanë arsye të besojnë se do të pësojnë ndonjë trajtim të padrejtë, se konfidencialiteti/ anonimiteti i tyre nuk mund të garantohet, ose mund të mbulohet keqbërja.[119] Kjo është arsyeja pse është praktikë e mirë që të lejohet qasja dhe mbrojtja e barabartë e raportimit brenda vendit të punës dhe pranë autoriteteve. Nuk duhet të ketë kufizime ose ngarkesa shtesë për sinjalizuesit që dëshirojnë të raportojnë drejtpërdrejt tek rregullatorët dhe autoritetet. Shembuj të kësaj qasjeje mund të gjenden në Kanada, Ganë dhe Serbi.
3. Ky ligj nuk e përmbushë praktikën më të mirë në lejimin e qasjes së barabartë në raportimin e brendshëm dhe të jashtëm pasi përcakton kërkesa shtesë për raportimin e jashtëm tek autoritetet.

Neni 19

Sinjalizimi i jashtëm në sektorin privat

Në lidhje me sinjalizimin në sektorin privat tek rregullatorët sipas fushave të përgjegjësisë zbatohet përshtatshmërisht procedura e paraparë në nenin 16 të këtij ligji.

1. Dispozitat e nenit 19 përcaktojnë procedurën për paraqitjen dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit të jashtëm në sektorin privat, i cili bëhet tek rregullatorët sipas fushës së përgjegjësisë. Procedura e trajtimit të sinjalizimit të jashtëm është e njëjtë me atë të sinjalizimit të brendshëm.[120] Formulimi i kësaj dispozite nga ligjvënësi nuk është i qartë dhe nuk mbulon qëllimin të cilin në vetvete e ka norma. Sipas legjislacionit, *agjencitë rregullatore bëjnë rregullimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së operatorëve të tregut."*[121] Sektori privat është shumë i ndërlikuar, dhe fushëveprimi i tij nuk mund të mbulohet në rastin e sinjalizimit të brendshëm vetëm nga rregullatorët. Disa agjenci tjera që kanë statusin e agjencisë ekzekutive, mbulojnë aspekte të rëndësishme në lidhje me sinjalizimin e jashtëm (p.sh. Administrata Tatimore e Kosovës).
2. Sinjalizimi i jashtëm për sektorin privat raportohet te institucionet që shërbejnë si rregullatorë përgjegjës në fushat e ndryshme si në vijim: Administrata Tatimore e Kosovës; Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve; Oda e Avokatëve; Oda e Mjekëve;

118 OECD, (2015), fq. 25.
119 OECD, (2015), fq. 53
120 Shih komentin e nenit 16.
121 Shih Nenin 14 të Ligjit nr. 06/l -113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 7 / 01 mars 2019, Prishtinë.

Banka Qendrore; Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik; Inspektoratet; Divizionet apo Departamentet e ndryshme në kuadër të ministrive. Lidhur me procedurën, afatet dhe trajtimin e rasteve, rregullatorët zbatojnë procedurat e trajtimit të sinjalizimit të brendshëm.

3. *Shënim:* Neni 19 do të jetë vështirë i zbatueshëm, për shkak se të punësuarit në sektorin privat mund të mos jenë në dijeni se cili është rregullatori përkatës për fushën të cilën ata duan të sinjalizojnë. Do të ishte mirë që ligjvënësi ta konsideronte plotësimin dhe ndryshimin e kësaj dispozite, duke vendosur në kompetencë tek AKK-ja sinjalizimin e jashtëm për sektorin privat. Raportimi tek ky institucion, përveç adresimit të saktë, i jep besim sinjalizuesit për shkak të eksperiencës që ka Agjencia. Kjo kompetencë shtesë sigurisht krijon vështirësi për punën e Agjencisë, por Kuvendi dhe Qeveria duhet të konsiderojnë rritjen e buxhetit dhe shtimin e personelit të AKK-së.

Praktikat më të mira ndërkombëtare

1. Pasja e shumë autoriteteve kompetente për të marrë zbulime të informacioneve ofron një sërë kanalesh për sinjalizuesit, por potencialisht mund të çojë në konfuzion se ku ata duhet të shkojnë për të bërë një zbulim. Për më tepër, sistemet e tilla mund të provojnë se janë mjaft të ndara, me juridiksione të mbivendosura dhe mandate të paqarta për institucionet e ndryshme.
2. Mungesa e mekanizmave të referimit do ta vendoste detyrimin te sinjalizuesi që të vazhdojë të bëjë zbulimin derisa të arrijnë rregullatorin e duhur.[122] Nuk duhet të jetë barrë e sinjalizuesit sigurimi se ankesa t'i përcillet agjencisë së duhur rregullatore ose organit hetimor të duhur.
3. Prandaj, ky Ligj nuk i përmbushë praktikat më të mira në lidhje me zbulimin pranë rregullatorëve dhe autoriteteve në sektorin privat.

Neni 20

Sinjalizimi publik

1. **Përveç rasteve të sinjalizimit të brendshëm dhe të jashtëm, sinjalizuesi mund të bëjë edhe sinjalizim publik, në rastet kur:**
   - **1.1. Në kohën kur sinjalizuesi që bën shpalosjen, me arsye beson se ai do t'i nënshtrohet ndëshkimit nëse bën raportim të brendshëm apo të jashtëm;**
   - **1.2. Sinjalizuesi me arsye beson se ka gjasa që dëshmitë në lidhje me veprimet e dëmshme përkatëse do të fshihen ose do të shkatërrohen nëse sinjalizuesi bën raportim në mënyrën e përcaktuar në nenin 16 dhe 18 të këtij ligji.**
   - **1.3. Në rast të kërcënimit të menjëhershëm për jetën, shëndetin publik, sigurinë, mjedisin, apo kur shkaktohen dëme në shkallë të gjerë apo të pariparueshme;**
   - **1.4. Autoritetet përgjegjëse nga neni 16 dhe 18 të këtij ligji nuk kanë ndërmarrë veprimet përkatëse në lidhje me sinjalizimin brenda afatit prej gjashtë (6) muaj nga momenti i raportimit të informacionit të sinjalizuar.**

122 Shih Arron Phillips and David Lewis, *"Whistleblowing to Regulators: Are Prescribed Persons Fit for Purpose?"* (Middlesex: University Research Repository Project Report, 2013). https://minhalexander.files.wordpress.com/2018/08/whistleblowing-to-regulators-are-prescribed-persons-fit-for-purpose-david-lewis-2013.pdf.

2. **Sinjalizuesi i cili shpalos informacionin tek publiku, në pajtim me këtë ligj, është i obliguar të respektojë parimin e prezumimit të pafajësisë të personit të akuzuar, të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe të mos pengojë zhvillimin e procedurave gjyqësore**.

Koment, neni 20

1. Shpalosja publike e informacionit, apo sinjalizimi publik, mund të ndërmerret nëse ekzistojnë rrethana të arsyeshme apo nëse është shterruar mundësia e sinjalizimit të brendshëm dhe të jashtëm. Neni 20 përcakton kriteret sipas të cilave bëhet sinjalizimi publik apo shpalosja e informacionit. Sipas dispozitave të këtij neni, janë përcaktuar disa raste në të cilat sinjalizuesi mund të bëjë shpalosje të informacionit, si: (1) beson se do të ndëshkohet nëse bën sinjalizim të brendshëm apo të jashtëm; (2) ekziston dyshimi i arsyeshëm se dëshmitë në lidhje me veprimet e dëmshme përkatëse do të fshihen ose do të shkatërrohen; (3) kërcënim i menjëhershëm për jetën, shëndetin publik, sigurinë, mjedisin, apo dëme në shkallë të gjerë apo të pariparueshme; (4) autoritetet përgjegjëse për trajtim të sinjalizimit të brendshëm apo jashtëm nuk kanë zhvilluar procedurën e hetimit administrativ brenda afatit prej gjashtë (6) muaj nga momenti i raportimit të informacionit të sinjalizuar.
2. Shpërndarja e informacioneve në sferën publike obligon sinjalizuesin ta respektojë supozimin e pafajësisë, ta respektojë të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe të ketë kujdes që të mos kërcënojë zhvillimin e procedurave gjyqësore. Pasoja juridike e kësaj dispozite është se sinjalizuesi duhet të jetë i vetëdijshëm se do të rezultojë me humbjen e së drejtës për mbrojtje konform Ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve.
3. *Shpalosja e informacionit, është afirmuar edhe nga GJEDNJ.* Rasti i parë lidhur me mbrojtjen e sinjalizuesve i trajtuar nga GJEDNJ-ja, në vitin 2008, është rasti i njohur *Guja v. Moldavisë.* Parashtrues i kërkesës ishte Iacob Guja, i kishte dërguar shtypit dy letra, asnjëra prej të cilave nuk ishte e shenjëzuar si konfidenciale. Letrat mbështesnin pretendimet se ka pasur ndërhyrje të politikës në punën e prokurorisë. Si rezultat i këtij zbulimi, parashtruesi i kërkesës më vonë është shkarkuar nga posti i tij. Guja ishte i mendimit se letrat nuk ishin konfidenciale për shkak se ato zbuluan ndikimin e parlamentit dhe të politikës në punën e prokurorisë. Të gjitha gjykatat në Moldavi kishin vendosur kundër tij duke mos e kthyer në punë. Duke u mbështetur në nenin 10 të Konventës, ai u ankua në GJEDNJ duke paditur shtetin moldav për shkelje të lirisë së shprehjes në vendin e punës. GJEDNJ-ja vendosi në favor të tij dhe në të njëjtën kohë vendosi standardet thelbësore lidhur me mbrojtjen e sinjalizuesve. Sipas gjykatës, sinjalizuesi gëzon mbrojtje nëse institucioni nuk ka procedurë për sinjalizimin dhe nëse procedurat nuk ishin të përshtatshme. Gjykata vendosi edhe standardin se interesi publik është më i lartë se interesat tjera.[123] Sipas GJEDNJ-së, shërbyesi civil është i vetmi person, ose, pjesë e një grupi të vogël të personave që kanë dijeni se çfarë ndodh, atëherë ata janë në pozitën më të mirë që të ndërmarrin veprime. Mirëpo, nëse merret parasysh obligimi i shërbyesve civilë për të qenë diskret, raportimi në raste të tilla, fillimisht, duhet të bëhet te mbikëqyrësi, ose ndonjë autoritet kompetent. Vetëm

123 Rasti mund të shkarkohet në: https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-85016.

kur qartësisht nuk është praktike, atëherë, ajo informatë si mundësi e fundit mund t'i zbulohet publikut. Për këtë arsye, gjatë vlerësimit të proporcionalitetit të ndërhyrjes në lirinë e shprehjes së shërbyesit civil, gjykata shqyrtoi nëse parashtruesi kishte pasur mjete tjera efektive në dispozicion për të adresuar parregullsinë në fjalë. Në rastin konkret, për shkak të mungesës së ndonjë legjislacioni vendor që rregullon raportimin e parregullsive, parashtruesi nuk kishte në dispozicion kanale për raportim.

Praktikat më të mira ndërkombëtare

1. Duke ndjekur praktikat më të mira për zbulimin publik të përmendura në Nenin 13, shumë shtete mundësojnë zbulimin publik por vendosin kufizime. Këshilli i Evropës pranon se mbrojtja e interesit të palëve të treta, të tilla si punëdhënësit, duhet të jetë e ekuilibruar me interesin e publikut për t'u mbrojtur nga dëmtimi, keqbërja ose eksploatimi.[124] Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vuri në dukje se "interesi që publiku mund të ketë në informacionin e caktuar mund të jetë nganjëherë aq i fortë sa të tejkalojë edhe detyrën e vendosur ligjërisht të besimit".[125]
2. Transparency International konsideron se sinjalizuesit duhet të mbrohen për zbulimet publike në raste të rrezikut urgjent publik ose personal ose të rëndë, ose shkelje të vazhdueshme të pa adresuara që mund të ndikojnë në interesin publik, pa kërkesa shtesë.Rastet me shuma të mëdha parash mund të jenë shumë të ndjeshme dhe politike. Është e rëndësishme që sinjalizuesit ta kenë mundësinë t'u drejtohen palëve të jashtme. Marrësit tjerë të mundshëm të jashtëm të zbulimeve të informacioneve duhet të përfshijnë shoqatat ligjore, sindikatat, shoqatat e biznesit dhe organizatat profesionale. Legjislacioni duhet gjithashtu të mbrojë zbulimet e bëra pranë OJQ-ve, siç është Transparency International.
3. Megjithëse ky Ligj siguron mundësinë e zbulimit publik, është kufizues në kuptim se kërkon që zbulimi të jetë kërcënim për jetën, shëndetin publik, sigurinë, mjedisin, ose kur shkaktohet dëm i madh ose i pariparueshëm. Prandaj, nuk i plotëson plotësisht praktikat aktuale të mira për zbulimet publike.
4. *Rasti i sinjalizuesve nga praktika e vendeve tjera:* Në vitin 2009, një punonjës i qeverisë në Republikën Çeke kontaktoi zyrën kombëtare të Transparency International për fryrje masive të çmimit në një projekt të pastrimit të mjedisit. Pas fushatës së avokimit, dy procese të njëpasnjëshme të ofertimit u anuluan, duke ia kursyer shtetit më shumë se 2 miliardë euro. Kjo u bë e mundur nga fakti që Republika Çeke mundëson sinjalizuesit që të bëjnë zbulime pranë organizatave joqeveritare. Pas skandalit, qeveria Çeke bëri ndryshime të mëdha në legjislacionin e prokurimit publik, duke sjellë më shumë transparencë dhe efikasitet. Sinjalizuesi ishte përpjekur t'u ankohej eprorëve të tij për procesin e ofertimit, por ata i kishin hedhur poshtë pretendimet e tij.[126]

124 Counsel of Europe (2014) fq. 28.
125 Guja v. Moldova [GC], nr. 14277/04, ECHR 2008.
126 Transparency International, *"Hidden Costs"*, www.transparency.org/news/story/hidden_costs.

Neni 21

Sinjalizimi lidhur me sigurinë kombëtare, mbrojtjen, inteligjencën dhe marrëdhëniet ndërkombëtare

1. **Kur sinjalizimi i brendshëm apo jashtëm sipas këtij ligji ka të bëjë me informacionin e klasifikuar, sigurinë kombëtare, mbrojtjen, inteligjencën dhe marrëdhëniet ndërkombëtare, sinjalizuesi ia paraqet organit kompetent në këto fusha.**
2. **Brenda gjashtë (6) muajve, institucionet përgjegjëse sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të përcaktojnë rregulla dhe procedura për pranimin dhe trajtimin e llojeve të sinjalizimeve. Nëse nuk përcaktohen rregullat dhe procedurat, aplikohen rregullat e përgjithshme në përputhje me këtë ligj.**

Koment, neni 21

1. *Siguria kombëtare është përgjegjësia themelore e shtetit*, për arsye se pa një nivel përkatës të sigurisë nuk mund të flitet as për pushtet demokratik, as për rend shoqëror stabil. Me qëllim të garantimit të sigurisë dhe rendit juridik, shtetet krijojnë institucione përgjegjëse të cilat e përbëjnë sektorin e sigurisë. Thelbi i shtetit është zbatimi, apo aftësia bazë për të çuar dikë me uniformë dhe me armë për t'i detyruar njerëzit t'u binden ligjeve të shtetit.[127] Për shkak të natyrës së organzimit dhe fushëveprimit të insitucioneve të sigurisë, në disa raste ekziston një tension ndërmjet pretendimit të qeverisë për të mbajtur informacionet sekrete dhe të drejtës së lirisë së shprehjes. Por, informimi i publikut për aktivitetet shtetërore është në funksion të mbrojtjes së interesave të sigurisë kombëtare dhe mirëqeverisjes së sektorit të sigurisë.[128] Në këtë kornizë, shtetet demokratike për një kohë të gjatë kanë vepruar me këmbëngulje për të vendosur një pajtueshmëri midis kërkesave të sigurisë kombëtare dhe sundimit të ligjit.
2. Neni 21 i Ligjit përcakton mekanizmat institucional (apo kanalet e raportimit) për sinjalizimin e brendshëm dhe të jashtëm lidhur me fushat që prekin sigurinë kombëtare dhe marrëdhëniet ndërkombëtare, siç janë: 1) informacioni i klasifikuar; 2) siguria kombëtare; 3) inteligjenca, dhe 4) marrëdhëniet ndërkombëtare. Sipas kësaj dispozite, informacioni për shkeljen lidhur me këto fusha i paraqitet drejtpërdrejt organit kompetent.
3. Informacion i klasifikuar sipas legjislacionit përkatës është *"çdo informacion dhe material, publikimi i paautorizuar i të cilave do të cenonte në shkallë të ndryshme interesat e sigurisë së Republikës së Kosovës."*[129] Në rast të sinjalizimit të informacionit të klasifikuar, konsiderojmë se autoriteti (apo organi) kompetent është Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI).[130] AKI-ja është organi kompetent edhe për trajtimin e sinjalizimit lidhur me fushën e inteligjencës. Në trajtimin e sinjalizimit që ka të bëjë me informacionin e klasifikuar dhe inteligjencën përdoren dispozitat e legjislacionit përkatës për AKI-në dhe informacionin e klasifikuar dhe ligjit për sinjalizimin.

127 Francis Fukuyama, *'Ndërtimi i shtetit' (Botimi shqip,* Tiranë, 2010) fq. 30
128 Shih "Global Principles on National Security and the Right to Information" (2013, South Africa) https://issat.dcaf.ch/Learn/Resource-Library2/Policy-and-Research-Papers/GLOBAL-PRINCIPLES-ON-NATIONAL-SECURITY-AND-THE-RIGHT-TO-INFORMATION-THE-TSHWANE-PRINCIPLES.
129 Neni 3 (1.1.5) [informacion i klasifikuar] i Ligjit për klasifikimin e informacioneve të klasifikuara dhe verifikimit të sigurisë.
130 Ibid. Neni 7.

4. *Siguria dhe mbrojtja kombëtare* kanë të bëjnë me ruajtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial dhe rendit kushtetues të Republikës së Kosovës dhe marrëdhënieve me jashtë. Në rast të sinjalizimit lidhur me këto fusha, sinjalizuesi duhet të paraqes informacionin tek Forca e Sigurisë, Policia e Kosovës, Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, Këshilli i Kosovës për Siguri, dhe Autoriteti Civil i Aviacionit, si autoritete kryesore kushtetuese në garantimin e sovranitetit dhe integritetit territorial të vendit.[131] Por, para sinjalizimit lidhur me këto fusha, sinjalizuesi duhet të vlerësojë rrethanat e rastit duke identifikuar se cili nga këto institucione është organi kompetent për rastin në fjalë.
5. *Marrëdhëniet ndërkombëtare ja*në marrëdhëniet midis shteteve, organizatave ndërkombëtare dhe subjekteve tjera të komunitetit ndërkombëtar. Pavarësisht se bartin pjesë të sovranitetit shtetëror në funksion të bashkëpunimit dhe forcimit të ligjit ndërkombëtar, në organizata rajonale dhe globale,[132]shtetet vijojnë të jenë akterët kryesorë në marrëdhëniet ndërkombëtare. Dispozitat kushtetuese dhe ligjore mandatojnë tri institucione kryesore si organe kompetente në fushëveprim të marrëdhënieve ndërkombëtare: Presidentin, Qeverinë dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme. Nga konteksti në lidhje me sinjalizimin në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, si organ kompetent është Ministria e Punëve të Jashtme, për shkak të mandatit dhe funksionit bashkërendues që kjo Ministri ka me institucionet tjera në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare.[133]
6. Ligji nuk përcakton shprehimisht se cili është organi kompetent për sinjalizim të jashtëm në rastet kur subjekt i sinjalizimit mund të mund të jenë titullarët e këtyre institucioneve. Nga konteksti i këtij neni dhe Ligji, atëherë organ kompetent për sinjalizim të jashtëm mund të jenë Kryeministri, Presidenti, Komisionet Parlamentare për Mbikëqyrjen e AKI-së dhe Komisioni për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes.
7. Për faktin se sinjalizimi lidhur me sigurinë kombëtare dhe marrëdhëniet ndërkombëtare është specifik, Ligji ka përcaktuar detyrimin e organeve përkatëse kompetente, që në afat prej gjashtë (6) muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, të përcaktojnë rregulla dhe procedura për pranimin dhe trajtimin e llojeve të sinjalizimeve. Nëse këto institucione nuk përcaktojnë rregullat dhe procedurat e tilla, aplikohen rregullat e përgjithshme në përputhje me këtë ligj. Duke pasur parasysh ndjeshmërinë e trajtimit të informacionit të sinjalizimit lidhur me këto fusha, nxjerrja e rregullave dhe procedurave të veçanta nga organet kompetente duket e domosdoshme. Kjo për faktin se këto rregulla dhe procedura do të integronin dispozitat e këtij Ligji dhe legjislacionit përkatës, dhe kjo do të mundësonte lehtësimin e sinjalizuesve për të raportuar mirëpo edhe lehtësimin e trajtimit të rasteve të raportuara.
8. Por institucionet e sigurisë, duhet te kryejnë aktivitetin e vet brenda mandatit te dhenë ligjor . Ne rast te tejkalizimit te autorizimeve te tyre, apo keqpërdorimit, ato nuk mund te mbulohen me aryetimin për ruajtjen e sigurisë kombetare. GJENDJ *ne rastin Bucur and Toma v. Rumanisë,* ka theksuar se "interesi i përgjithshëm në aktivitetet e paligjshme të shërbimit të inteligjencës është aq i rëndësishëm në një shoqëri demokratike sa tejkalonte interesin e ruajtjes së besimit të publikut në atë

131 Shih: Kapitulli XI, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Sektori i Sigurisë.
132 Neni 20 (1) i Kushtetutës së Kosovës përcakton: "Republika e Kosovës, në bazë të marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare, për çështje të caktuara mund të kalojë kompetenca shtetërore organizatave ndërkombëtare.
133 Shih Nenin 3 të Ligjit Nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti III / Nr. 26 / 02, qershor 2008.

institucion". Rasti kishte te bënte me shtetasin rumun Constantin Bucur, i cili më 1996 punonte në Departamentin për Monitorimin e Komunikimit në Agjencinë Rumune të Inteligjencës (SRI), me bazë në Bukuresht, dhe ishte përgjegjës për përgjime. Gjatë punës së tij, ai vërejti që disa gazetarë, politikanë dhe biznesmenë po përgjoheshin në mënyrë të paligjshme. Bucur-i njoftoi mbikëqyrësin e tij për parregullsitë e evidentuara, por u qortua nga ai. Ai pastaj kontaktoi një deputet që ishte edhe anëtar i Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrjen e SRI-së dhe së bashku mbajtën konferencë për media ku publikuan 11 audiokaseta që përmbanin komunikime telefonike të disa gazetarëve dhe politikanëve. Konferenca u raportua nga mediat botërore. Bucur u dënua me dy vjet burg për vjedhje dhe publikim të paligjshëm të informatave sekrete. Bazuar në nenin 10, Bucur-i u ankua se dënimi i tij përbënte shkelje të këtij neni. Dy parashtruesit tjerë, gazetari Mircea Toma dhe vajza e tij Sorana Toma, duke u bazuar në nenin 8, u ankuan për përgjim të bisedave të tyre. Në SRI nuk ekzistonte asnjë procedurë zyrtare për raportimin e parregullsive. Parashtruesi mund të kishte informuar vetëm mbikëqyrësit e tij, mirëpo parregullsitë që ai kishte zbuluar kishin të bënin me ata. Prandaj, vështirë se një ankesë e brendshme e parashtruesit do të rezultonte me hetim apo ndalim të praktikave të paligjshme. Rrjedhimisht, zbulimi i informacioneve drejtpërsëdrejti në publik justifikohej. GJENDJ më tutje vërejti se komunikimet telefonike kishin një rëndësi të veçantë në shoqëri, e cila gjatë regjimit komunist ishte mësuar me një politikë të fshehtë të përgjimit nga shërbimet sekrete. Sa i përket dëmit ndaj institucionit, interesi i përgjithshëm në aktivitetet e paligjshme të shërbimit të inteligjencës ishte aq i rëndësishëm në një shoqëri demokratike sa tejkalonte interesin e ruajtjes së besimit të publikut në atë institucion. Po ashtu, nuk kishte arsye të besohej që parashtruesi ishte i shtyrë nga motive tjera përveç bërjes publike të shkeljeve ligjore. Rrjedhimisht, ndërhyrja në të drejtën e parashtruesit për liri të shprehjes, sidomos në të drejtën e tij për të dhënë informacione, nuk ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike.

Praktikat më të mira ndërkombëtare

1. Zbulimi i interesit publik që përfshinë çështje të sigurisë kombëtare ose sekrete zyrtare janë ndër fushat më të diskutueshme të sinjalizimit.[134] Kjo është zona ku mbrojtja e sinjalizuesve është më e dobëta dhe sinjalizuesit e sigurisë kombëtare shpesh pësojnë hakmarrjen më të ashpër: jo vetëm që ata humbin punën e tyre, ata përballen me hetime penale, ndjekje penale dhe dënime të ashpra.[135]
2. Shumica e instrumenteve ndërkombëtare e pranojnë që e drejta për lirinë e shprehjes mund t'i nënshtrohet disa kufizimeve për mbrojtjen e sigurisë kombëtare ose të rendit publik.[136] Por këto kufizime nuk duhet të jenë aq tepër të gjera sa të parandalojnë vëzhgimin dhe debatin efektiv publik në lidhje me vendimmarrjen dhe aktivitetet e qeverisë dhe ta bëjnë shumë më të vështirë detektimin dhe adresimin e keqbërjeve. Siç është theksuar nga UNODC, zbulimi i informacionit që tregon keqbërje ose është

134 Benjamin Buckland and Aidan Wills, "*Blowing in the Wind,Whistleblowing in the Security Sector"* (DCAF, 2013) fq.1. https://www.right2info.org/resources/publications/pretoria-finalization-meeting-april-2013-documents/whistleblowing-and-security-sector-buckland-and-wills.
135 Kombet e Bashkuara, "*Promotion and protection of the right to freedom of opinion and expression"* (2015) fq. 18 https://digitallibrary.un.org/record/805706/files/A_70_361-EN.pdf.
136 P.sh: Neni 19(3)(b)i KNDCP & Neni 13(1)(d) të KKBKK.

çështje me interes të konsiderueshëm publik duhet të konsiderohet "i mbrojtur", pavarësisht nëse informacioni është klasifikuar ose jo, dhe duhet të ketë kanale efektive për ta raportuar një informacion të tillë.[137]

3. Siç është rasti i sinjalizuesve "të rregullt", individët që dëshirojnë të bëjnë një zbulim që përfshinë informacione "sekrete" duhet të jenë në gjendje ta bëjnë këtë brenda ose të shkojnë drejtpërdrejt pranë një autoriteti kompetent.
4. Këshilli i Evropës e din se mund të aplikohet një skemë apo rregulla të veçanta për informacionin në lidhje me sigurinë kombëtare, mbrojtjen, inteligjencën, rendin publik ose marrëdhëniet ndërkombëtare. Nëse një sinjalizues bën një zbulim në përputhje me ato rregulla, ata duhet të marrin mbrojtje të plotë.
5. Ky Ligj njeh rëndësinë e procedurave të veçanta që aplikohen për llojet e ndryshme të informacionit në lidhje me sigurinë kombëtare, mbrojtjen, inteligjencën dhe marrëdhëniet ndërkombëtare, dhe për këtë arsye plotëson praktikat e mira aktuale.

Neni 22

Mbrojtja nga veprimet e dëmshme

1. **Sinjalizuesi mbrohet nga çdo veprim i dëmshëm, i marrë ndaj tij nga punëdhënësi për shkak të sinjalizimit, në pajtim me dispozitat e këtij ligji, duke përfshirë por pa u kufizuar në:**
   1.1. Shkarkimin nga puna;
   1.2. Pezullimin nga puna ose të një ose më shumë detyrave;
   1.3. Transferimin brenda ose jashtë institucionit publik ose subjektit privat pa pëlqimin e tij;
   1.4. Uljen në pozitë;
   1.5. Zvogëlimin e pagesës;
   1.6. Humbjen e statusit dhe privilegjeve;
   1.7. Mos ngritjen në pozitë;
   1.8. Heqjen e të drejtës për të marrë pjesë në trajnime;
   1.9. Vlerësime negative në marrëdhënien e punës;
   1.10. Anulimin e një licence ose leje;
   1.11. Përfundimin e një kontrate për mallra apo shërbime;
   1.12. Veprime të tjera të dëmshme në lidhje me marrëdhënien e punës.
2. **Çdo veprim i dëmshëm ndaj sinjalizuesit është i pavlefshëm.**
3. **Sinjalizuesi në cilësinë e të punësuarit, i cili u është nënshtruar veprimeve të dëmshme në vendin e punës, ka të drejtë që t'i drejtohet gjykatës kompetente.**

Koment, neni 22

1. Mbrojtja e sinjalizuesit është thelbi i Ligjit, dhe personi që raporton ose shpalos informata bazuar në dispozitat ligjore nuk mund të jetë subjekt i përgjegjësisë penale, civile apo disiplinore. Sinjalizuesi gëzon të drejtën e mbrojtjes nga veprimet e dëmshme në rastet kur me arsye beson se informacioni i raportuar apo i shpalosur është i vërtetë. Ligji përcakton se mbrojtja e garantuar për sinjalizuesin nuk duhet

137 P.sh.: Neni 19 (3)b i KNDCP; Neni 13 (1)d i KKBK & UNODC (2015) fq. 27-28.

të paragjykohet nëse kërcënimi apo cenimi i interesit publik i pretenduar përmes sinjalizimit nuk është materializuar.

2. Neni 22 përcakton mbrojten e sinjalizuesit nga çdo veprim i dëmshëm i cili mund të ndërmerret nga punëdhënësi për arsye të sinjalizimit të bërë. Për më tepër, dispozitat e këtij neni listojnë në mënyre taksative dymbëdhjetë (12) veprime të dëmshme nga të cilat mbrohet sinjalizuesi. Qëllimi i këtyre dispozitave është që t'u garantohet mbrojtje e plotë juridike personave që sinjalizojnë se nuk do të ndëshkohen nga punëdhënësi i tyre. Në kuadër të këtyre veprimeve të ndaluara nga të cilat janë të mbrojtur sinjalizuesit, janë përfshirë veprimet si: shkarkimi, pezullimi, ulja e pozitës apo pagës, vlerësimi i dobët i performancës, mospjesëmarrja në trajnime apo ngritja në karrierë.
3. Përveç veprimeve të dëmshme të cilat janë të listuara në mënyre taksative, neni 22 përcakton gjithashtu mbrojtjen e sinjalizuesve edhe nga veprime të tjera, çfarëdo qofshin, të cilat mund të ndërmerren ndaj sinjalizuesit nga punëdhënësi për shkak të sinjalizimit.
4. Lidhur me kategorinë e veprime tjera të dëmshme të mundshme, mund të jenë: (1) sjellja armiqësore; (2) ngacmimi; (3) përhapja e thashethemeve; (4) vërejtje zyrtare; (5) lista e zezë; (6) sulmi fizik; (7) censura e shkrimit; (8) mosdhënia e referencës pozitive; (9) refuzimi i punësimit; etj. Hakmarrja më e zakonshme në vendin e punës është krijimi i mjedisit armiqësor për sinjalizuesin. Ai refuzohet nga bashkëpunëtorët, të cilët mund të kenë frikë të flasin me të sepse shefat mund t'i kenë paralajmëruar që të mos e bëjnë. Marrëdhëniet miqësore janë të rëndësishme për kryerjen me sukses të detyrave dhe performancën në punë.
5. Në rast se sinjalizuesi ka pësuar nga një veprim i dëmshëm si pasojë e sinjalizimit, ai ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës kompetente, sipas dispozitave përkatëse të nenit 24.[138]

Praktikat më të mira ndërkombëtare

1. Trajtimi i padrejtë ndodh kur një individ trajtohet në mënyrë negative, sepse kanë ngritur një brengë. Trajtimet e padrejta mund të marrin forma të ndryshme - nga hakmarrja te disavantazhi ose diskriminimi. Llojet më të dukshme dhe formale të trajtimeve të padrejta përfshijnë shkarkimin, masën disiplinore ose uljen e pagave. Format tjera nuk janë aq të dukshme dhe më tepër joformale, siç është tëhuajëzimi i sinjalizuesit ose mosdërgimi në trajnime. Frika nga trajtimi i padrejtë është një nga arsyet kryesore pse njerëzit nuk bëjnë zbulime.[139]
2. Sipas Parimit 6, të Transparencës Ndërkombëtare, shtetet duhet të ndalojnë të gjitha format e hakmarrjes, disavantazhit ose diskriminimit. Duhet të shmangen listat shteruese të llojeve të veprimeve ose mosveprimeve të ndaluara, pasi është aktivitet i vështirë dhe mundet të mos arrijë t'i kapë të gjitha format e dëmit.[140] Format e trajtimeve të padrejta do të ndryshojnë varësisht natyrës së marrëdhënies së sinjalizuesit me organizatën: një vullnetar nuk mund të pësojë ulje të pagës, kështu që hakmarrja ka më shumë gjasa që të shkojë drejt ndalimit të shfrytëzimit të shërbimeve të vullnetarit ose t'i japin atij referenca negative për punësim në të ardhmen.[141]

138 Shih komentin e nenit 24.
139 Hayden Teo and Donella Caspersz, "*Dissenting discourse: Exploring alternatives to the whistleblowing/silence dichotomy", Journal of Business Ethics*, 104(2), 2011, fq. 237-249.
140 Transparency International, (2013)
141 Counsel of Europe, (2014), f. 38

3. Dispozitat në këtë ligj në lidhje me mbrojtjen nga veprimet e dëmshme përpiqen që t'i rendisin llojet e akteve të ndaluara, por për shkak të shtimit të shprehjes "përfshirë, por pa u kufizuar në", ajo pasqyron praktikë të mirë aktuale.

Neni 23

Dëmshpërblimi në rast të veprimeve të dëmshme

Çdo person i cili mund të ketë pësuar veprim të dëmshëm si pasojë e sinjalizimit, ka të drejtë të kërkojë në gjykatën kompetente shpërblim për dëmin e pësuar nga veprimi i dëmshëm në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Koment, neni 23

1. Neni 23 garanton të një të drejtë shumë të rëndësishme lidhur me procesin e sinjalizimit. Sipas dispozitave të këtij neni, secili person i cili mund të ketë pësuar nga një veprim i dëmshëm si pasojë e sinjalizimit, ka te drejtë te kërkoi shpërblimin e dëmit, në gjykatën kompetente. Në kuptim të ketij neni fjala *"person"* përfshijnë jo vetëm personat fizik por edhe ata juridik. Procederu lidhur me zbatimin e kesaj te drejte percaktohet ne nenin 24.
2. Kjo e drejtë e garantuar me këtë nen, është e drejtë gjenerale, dhe gjatë zbatimit kokretë të saj vie në shprehje zbatimi *mutatis mutandis* i legjislacionit për marrëdheniet e detyrimeve[142], të konfliktit administrativ dhe procedurës kontestimore. Procedura e parshtrimit të kërkeses për shperblimin e dëmit përcakohet me dispozitat e nenit 24.

Praktikat më të mira ndërkombëtare

1. Praktika më e mirë është që detyrimet e mbrojtjes së punëdhënësve të bëhen të përmbarueshme duke siguruar të drejta për kompensim jo vetëm kur dikush ndërmerr veprime të dëmshme kundër sinjalizuesit për arsyen specifike se i fryjnë bilbilit, por edhe kur një person ose punëdhënësi nuk arrin ta përmbushë një detyrë për mbrojtjen e sinjalizuesit nga trajtimi i padrejtë.
2. Sipas TI-së Parimeve Ndërkombëtare të për Legjislacionin për Sinjalizues, sinjalizuesve që kanë pësuar dëm duhet t'u ofrohet gama e plotë e mjeteve juridike: gama e plotë e mjeteve juridike duhet të mbulojë të gjitha pasojat e drejtpërdrejta, indirekte dhe të ardhshme të çdo hakmarrjeje, me synim të rimëkëmbjes së sinjalizuesit. Kjo përfshinë masa të përkohshme dhe mbrojtëse; tarifat e avokatit dhe ndërmjetësimit; transferimin në departament ose mbikëqyrës të ri; kompensim për fitimet dhe statusin e humbur në të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen; dhe kompensimin e dhimbjeve dhe vuajtjeve përfshirë shpenzimet mjekësore. Duhet të konsiderohet një fond për të dhënë asistencë për procedurat ligjore dhe për t'i përkrahur sinjalizuesit në nevojë serioze financiare.[143]
3. Australia është një shembull udhëheqës në këtë rast me një dispozitë gjithëpërfshirëse për mjetet juridike civile për të kompensuar objektivin për humbjen, dëmtimin ose

142 Ligji Nr. 04/l-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë / Nr. 16 / 19 qershor 2012, NËNKREU 7, Shpërblimi i dëmit.
143 Transparency International, (2013).

lëndimin si rezultat i hakmarrjes ose kërcënimit.[144]**3** Ky ligj mjafton me praktikën e mirë aktuale për kompensimin në rast të veprimeve të dëmshme. Sidoqoftë, kërkesa për dëmshpërblim mund të jetë e vështirë në praktikë pasi marrëdhënia e punës është kryesisht aq e dëmtuar, saqë rikthimi i sinjalizuesit në gjendjen paraprake shpesh është i pamundur. Ligjvënësi duhet të konsiderojë të shtojë "ose një kusht në nivel të krahasueshëm".

4. *Rasti i sinjalizuesve të huaj:*Në shtator 2020, Gjykata e Rrethit e Hagës, Holandë, ka fajësuar dëmin dhe shkarkimin e sinjalizuesit, i cili ekspozoi ish-Ambasadorin Holandez në Nigeri. Sinjalizuesi, i cili punoi për Ambasadën Holandeze në Nigeri, u shkarkua pasi zbuloi se si ish Ambasadori Holandez në Nigeri nxori informacione konfidenciale në lidhje me një hetim të gjerë të korrupsionit në operacionet e Shell tek kompania e naftës. Për ta fshehur shkarkimin e sinjalizuesve, Ambasada Holandeze pretendoi se ajo kishte sjellje të çuditshme dhe ishte jopopullore me stafin. Gjyqtari e hodhi poshtë këtë sugjerim me vendim. "Është konstatuar mjaftueshëm se largimi i punonjëses ka të bëjë me raportin e sinjalizuesit të bërë nga ajo", tha aktgjykimi. Gjyqtari gjithashtu fajëson ministrinë për valëvitjen e përsëritur të një raporti mbi abuzimet në Abuja në të cilat pjesë të mëdha ishin bërë të palexueshme. Sinjalizuesi pranon rrogën për dy vjet si kompensim.[145]

144 Australi, Akti i Punës Fer (2009). Australi, www.legislation.gov.au/Details/C2017C00147.

145 Shih Vendimin e Gjykatës së Qarkut të Hagës, ECLI:NL:RBDHA:2020:8886, https://uitspraken.rechtspraak.nl/inziendocument?id=ECLI:NL:RBDHA:2020:8886&showbutton=true.

KAPITULLI IV - Procedura Gjyqësore

Neni 24

Mbrojtja gjyqësore

1. **Sinjalizuesi dhe personi i lidhur me sinjalizuesin i cili ka pësuar nga veprimet e dëmshme në lidhje me sinjalizimin, ka të drejtë në mbrojtje gjyqësore pa qenë i detyruar të shterojë mjetet juridike të brendshme në procedurë administrative.**
2. **Padia kundër veprimit të dëmshëm i paraqitet gjykatës në afat prej gjashtë (6) muajsh nga dita kur sinjalizuesi është vënë në dijeni, por jo më vonë se tri (3) vite nga dita kur është ndërmarrë veprimi i dëmshëm.**
   - **2.1. Për rastet që kanë të bëjnë me shërbyes civil, padia dorëzohet në Departamentin për Çështje Administrative në Gjykatën Themelore në Prishtinë.**
   - **2.2. Për rastet që kanë të bëjnë me kategori tjera të të punësuarve, padia dorëzohet në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatës Themelore, ku ndodhet selia e punëdhënësit apo ku sinjalizuesi e ka vendbanimin.**
3. **Krahas padisë nga paragrafi 2 i këtij neni, sinjalizuesi mund të bëjë edhe kërkesë për kompensim të dëmit.**
4. **Në rastet kur gjykata kompetente vërteton se sinjalizuesi në kontekst të marrëdhënies së punës ka pësuar nga veprime të dëmshme për shkak të sinjalizimit, vendos, sipas rastit, që ta kthejë në vendin e tij të punës, t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar dhe të urdhërojë institucionin publik apo subjektin privat të ndërmarrë veprime të caktuara.**
5. **Të gjitha lëndët që kanë të bëjnë me sinjalizimin, trajtohen me prioritet nga Gjykata.**

Koment, neni 24

1. Mbrojtja efikase gjyqësore e sinjalizuesit paraqet një prej elementeve më të rëndësishme të këtij Ligji. Për të gëzuar mbrojtjen ligjore, sinjalizuesit duhet të kenë arsye të besojnë - në dritën e rrethanave dhe informacionit të disponueshëm për ta në kohën e raportimit apo shpalosjes së informacionit të tyre - se çështjet e sinjalizuara janë të vërteta. Dispozitat e Ligjit përcaktojnë se sinjalizuesi i cili u nënshtrohet veprimeve të dëmshme në vendin e punës, apo dëmtohet për shkak të sinjalizimit, ka të drejtë që t'i drejtohet gjykatës kompetente duke kërkuar edhe dëmshpërblim për dëmin e pësuar bazuar në legjislacionin në fuqi. E drejta jonë pozitive përcakton qartë rregullat për dëmshpërblim. Në bazë të numërimit taksativ të veprimeve të dëmshme, të përcaktuara në nenin 22 të Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, shihet se shumica e tyre janë të kategorisë së dëmshpërblimit jo material, pra, kanë të bëjnë me cenimin e të drejtës së personalitetit.[146]

146 Shih Ligji Nr. 16-L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (nenet 169-192). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 16 / 19 qershor 2012, Prishtinë.

2. Ligji garanton se sinjalizuesi ka të drejtë në mbrojtje gjyqësore, drejtpërdrejt, pa qenë i detyruar të shterojë mjetet juridike të brendshme të procedurës administrative. Ligji përcakton se kushdo që në cilësinë e sinjalizuesit pëson nga një veprim i dëmshëm mund të parashtrojë padi në gjykatë. Padia mund t'i parashtrohet gjykatës në afat prej gjashtë (6) muajsh nga dita kur sinjalizuesi është vënë në dijeni, por jo më vonë se tri (3) vite nga dita kur është ndërmarrë veprimi i dëmshëm. Krahas parashtrimit të padisë, i dëmtuari mund të parashtrojë edhe kërkesën padinë për kompensim të dëmit të pësuar nga veprimi i dëshem.
3. Ligji përcakton dy procedura te ndryshme lidhur me parashtrimin e padive në gjykatë rreth mbrojtjes së sinjalizuesve nga veprimet e dëmshme. Për rastet që kanë të bëjnë me *shërbyesit civilë* (nëpunësit civilë)[147]padia parashtrohet në *Departamentin për Çështje Administrative në Gjykatën Themelore në Prishtinë.* Ky departament ka juridiksion në gjithë territorin e vendit dhe, gjykon dhe vendos në konfliktet administrative sipas padive kundër akteve administrative përfundimtare dhe për çështjet e tjera të përcaktuara me ligj.[148]
4. *Ligji emërton "nëpunësit civilë" si "shërbyes civil",* ndërsa legjislacioni përkatës për zyrtarët publikë përcakton katër kategori të zyrtarëve publikë: 1) nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); 2) nëpunësi i Shërbimit Publik; 3) nëpunësi i Kabinetit; dhe 4) nëpunësi administrativ dhe mbështetës. Në kontekst të mbrojtjes gjyqësore të sinjalizuesit, padi në konflikt administrativ mund të parashtrojnë vetëm nëpunësit civilë dhe jo kategoritë tjera të zyrtarëve publikë.
5. Tri kategoritë tjera të zyrtarëve publikë dhe të punësuarit në sektorin privat mund të parashtrojnë padi lidhur me mbrojtjen gjyqësore nga veprimet e dëmshme lidhur me sinjalizimin në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatës Themelore. Lidhur me kompetencën territoriale, Ligji përcakton se gjykatë kompetente mund të jetë Gjykata Themelore ku ndodhet selia e punëdhënësit apo ku sinjalizuesi e ka vendbanimin.[149] Lëndët që kanë të bëjnë me sinjalizimin trajtohen me prioritet nga Gjykatat.
6. Ligji ka përcaktuar se në rast se gjykata vërteton se sinjalizuesi ka pësuar nga veprimet e dëmshme, ajo mund të vendosë sipas rastit, si vijon: 1) ta kthejë në vendin e punës; 2) t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar; dhe 3) ta urdhërojë institucionin publik apo privat të ndërmarrë veprime të caktuara. Sa i përket veprimeve të caktuara të cilat mund t'i theksojë gjykata në vendimin e saj, ato mund të jenë: 1) ndërmarrja e masave adekuate lidhur me krijimin e kushteve për kthim në vend të punës, apo 2) respektimi i vendimit të organit i cili ka urdhëruar kthimin e tij në vend të punës, etj. Lëndët që kanë të bëjnë me sinjalizimin trajtohen me prioritet nga Gjykatat.

Praktikat më të mira ndërkombëtare

1. Sinjalizuesit mund të presin kohë të gjatë për ditën e tyre në gjykatë për të provuar se kanë pësuar ndonjë trajtim të padrejtë. Prandaj, është e rëndësishme që sinjalizuesit

147 Sipas përkufizimit ligjor: "Nëpunës civil - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë." Neni 2, i Ligjit nr. 06/l -114 për Zyrtarët Publikë/ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /nr. 8 /11 mars 2019, Prishtinë

148 Neni 17(1) i Ligjit Nr. 06/L- 054 për Gjykatat / Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 22 /18 dhjetor 2018, Prishtinë.

149 Neni 17(1) i Ligjit Nr. 06/L - 054 për Gjykatat.

të kenë një formë të sanimit që nga dita e parë, për t'i kufizuar dëmet e mundshme të pësuara. Sinjalizuesit nuk duhet të kenë humbje financiare nëse iu duhet të parashtrojnë padi për realizimin e të drejtave të tyre ose për të kërkuar kompensim nga shkeljet. Tarifat ligjore mund të paraqesin kosto të konsiderueshme për sinjalizuesit. Përderisa sinjalizuesit mund t'i rimarrin këto pagesa në fund të lëndës, është e mundur që nuk janë në gjendje t'i mbulojnë tarifat paraprakisht, veçanërisht nëse janë të papunë dhe në listën e zezë. Nëse sinjalizuesit nuk janë në gjendje që t'i përballojnë shpenzimet për zbatimin e të drejtave të tyre, kjo vë në dyshim realitetin e këtyre të drejtave.

2. Prandaj, sinjalizuesve që nuk kanë të ardhura të mjaftueshme dhe/ose nuk mund të përfitojnë ngamasa përkatëse e përkohshëm, duhet t'u sigurohet ndihma juridike ose financiare derisa të përfundojë procedura ligjore. Sllovakia siguron ndihmë juridike në procedurë.
3. Parimi 21 i TI nënvizon rëndësinë e seancës dëgjimore fer ("ditë e mirëfilltë në gjykatë"): Sinjalizuesit që besojnë se të drejtat e tyre janë shkelur, kanë të drejtë në seancë dëgjimore fer përpara një forumi të paanshëm, me të drejtë të plotë ankese. Vendimet duhet të jenë në kohë, sinjalizuesit mund të thërrasin dëshmitarë dhe të marrin në pyetje të tërthortë, dhe rregullat e procedurës duhet të jenë të ekuilibruara dhe objektive.[150]
4. Nën këtë dritë, ky Ligj plotëson praktikën e Parimit 21, pasi garanton të drejtën e sinjalizuesve për mbrojtje gjyqësore. Sidoqoftë, në rast se një sinjalizues nuk ka burime për procedurat ligjore, nuk i ofrohet asistencë financiare ose ligjore. Pra, në praktikë, ky Ligj nuk i plotëson tërësisht praktikat më të mira aktuale për mbrojtjen gjyqësore.

Neni 25

Barra e provës

Në të gjitha rastet kur sinjalizuesi ose personi i lidhur me sinjalizuesin konsideron se ka pësuar nga veprime të dëmshme për shkak të sinjalizimit, punëdhënësi e ka barrën e provës të provojë se veprimi i dëmshëm nuk ka lidhje shkakore me sinjalizimin.

Koment, neni 25

1. Barra e provës (onus probandi) është e drejta dhe detyrimi i palës që në një proces ligjor të provojë atë që pretendon mbi një fakt ose të dhëna që kanë ndikim përcaktues në zgjedhjen përfundimtare të çështjes.
2. Dispozitat e nenit 25 përcaktojnë një të drejtë shumë të rëndësishme, e cila ka të bëjë me barrën e provës në rastet e sinjalizimit. Neni 25 përcakton se në të gjitha rastet kur sinjalizuesi apo personi i lidhur me sinjalizuesin pretendon se ka pasuar veprime të dëmshme për shkak të sinjalizimit, barra e provës i takon punëdhënësit i cili duhet të argumentojë apo provojë se veprimi i dëmshëm nuk është ndërmarrë për shkak të sinjalizimit, por për shkaqe tjera.

150 Transparency International, *"A Best Practice Guide for Whistleblowing Legislation",* Principle 2. (2018) fq.6.

Praktikat më të mira ndërkombëtare

1. Mund të jetë shumë e vështirë për punonjësit të demonstrojnë se kanë pësuar trajtim negativ sepse kanë sinjalizuar. Nga ana tjetër, punëdhënësit zakonisht kanë procese për të dokumentuar veprimet e ndërmarra kundër punonjësve dhe pse, dhe kanë qasje më të lehtë te dëshmitarët. Meqenëse punëdhënësi ka fuqi dhe burime më të mëdha, barra duhet të vendoset mbi ta për të provuar se veprimi i ndërmarrë nuk ishte për shkak të sinjalizimit që ngriti shqetësim. Kjo është arsyeja pse standardet ndërkombëtare rekomandojnë që legjislacioni i sinjalizimit të anulojë barrën e provës mbi punëdhënësin.
2. Kjo do të thotë që punonjësi duhet të krijojë vetëm një rast *prima facie* që (1) ai ose ajo ka bërë zbulimin dhe (2) ka pësuar trajtim negativ. Atëherë i takon punëdhënësit që të provojë se trajtimi ishte fer dhe nuk ishte i lidhur në asnjë mënyrë me sinjalizimin, domethënë se do të kishte ndodhur sidoqoftë. Një qasje e ngjashme është marrë në ligjin anti-diskriminim në disa shtete dhe në legjislacionin e BE.[151]
3. Parimi 8 i TI, përcakton barrën e provës si më poshtë: për të shmangur sanksionet ose ndëshkimet, punëdhënësi duhet të demonstrojë qartë dhe bindshëm se çdo masë e marrë ndaj punonjësit nuk ishte në asnjë kuptim e lidhur ose e motivuar nga zbulimi nga ana e sinjalizuesit.[152]
4. Kjo dispozitë në Ligj i përmbushë praktikat e mira mbi barrën e provës dhe madje e shtrinë këtë të drejtë tek personi i lidhur me sinjalizuesin.

Neni 26

Sigurimi i kërkesëpadisë dhe masa e sigurimit

1. Sinjalizuesi dhe personi i lidhur me sinjalizuesin, mund të paraqesin propozim për caktimin e masës së sigurimit të kërkesëpadisë dhe masës së sigurimit në gjykatën kompetente.
2. Në lidhje me masën e sigurimit të kërkesëpadisë dhe masën e sigurimit zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e ligjit për procedurën kontestimore dhe të ligjit për konfliktet administrative.
3. Sinjalizuesi lirohet nga detyrimi për deponimin e garancisë në gjykatë për shkak të paraqitjes së propozimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Koment, neni 26

1. Dispozita e nenit 26 përcakton mundësinë që sinjalizuesi dhe personi i lidhur me sinjalizuesin të parashtrojnë propozimin për masë të sigurimit të kërkesëpadisë në gjykatën kompetente. Në përputhje me karakterin e tyre të përkohshëm, masat e sigurimit apo "masat e përkohshme" siç edhe njihen ndryshe në literaturën juridike, janë instrument i domosdoshëm për administrimin e drejtësisë. Më konkretisht, qëllimi i tyre është ruajtja e një situate ligjore dhe faktike pa efekt *res judicata* lidhur me meritat e rastit konkret.[153]

151 Cousiul of Europe, (2014), fq. 40
152 Transparency International, (2013).
153 Haxhi Xhemajli,"*Interim Measures for Securing the Claim in Civil Proceedings in Kosovo: Legal and Practical Aspects"*

2. Vendimi lidhur me masat e sigurimit vlen deri në vendosjen në mënyrë meritore nga ana e gjykatës. Pra, propozimi për masë të sigurimit ka për qellim: a) shmangien e shkaktimit të dëmit të pariparuesshëm; dhe b) kur nevoja për ruajtjen e *staus quo*-s është urgjente. Lidhur me këtë, pala/propozuesi duhet të paraqesë prova të mjaftueshme që tregojnë se, në qoftë se propozimi për caktimin e masës së sigurimit nuk do të pranohet nga ana e gjykatës, atëherë, asaj do t'i shkaktohet dëm i pariparuesshëm. Në këtë rast, propozuesi duhet ta bëjë të besueshëm ekzistimin e kërkesës apo të drejtës së tij subjektive, si dhe të arsyetojë se ekziston rreziku që pa caktimin e masës së këtillë, pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesë së tij.[154]
3. Paragrafi 2 i nenit 26 jep referencë në Ligjin për Procedurën Kontestimore dhe në Ligjin për Konfliktet Administrative sa i përket zbatimit të rregullave lidhur me shqiptimin e masës së sigurimit të kërkesëpadisë. Ligji për Procedurën Kontestimore përcakton kategorizimin e këtyre masave në dy lloje, siç janë: a) masa e sigurimit, dhe b) masa e përkohshme e sigurimit të kërkesëpadisë.[155] Natyra e këtyre masave është e përkohshme për faktin se vlejnë deri në momentin kur gjykata e nxjerr aktgjykimin lidhur me çështjen në gjykim. Në bazë të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore, masa e sigurimit të kërkesëpadisë dhe masa e përkohshme për sigurim të kërkesëpadisë kryesisht dallojnë sa i përket ofrimit të mundësisë së dëgjimit të palëve në kontest, propozuesit dhe kundër propozuesit.
4. Masa e sigurimit në procedurë kontestimore ushtrohet kryesisht *inter partes*, d.m.th. pas dëgjimit të palëve në kontest rreth kërkesës për caktimin e masës nga ana e gjykatës dhe kundërshtimit të paraqitur nga ana e kundërshtuesit të propozimit. Gjykata duke vepruar sipas kundërshtimit të palës së paditur mund të caktojë seancën e shqyrtimit të masës. Në seancën e shqyrtimit të masës gjykata shqyrton provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, dhe mund të dal në vend shikim dhe të dëgjoj dëshmitarë.[156]
5. Ndërsa, masat e përkohshme caktohen *ex parte,* pa njoftim dhe dëgjim paraprak të kundërshtarit të sigurimit, po që se propozuesi i sigurimit e bën të besueshëm pretendimin se masa e sigurimit është e bazuar dhe urgjente dhe se me veprim ndryshe do të humbte qëllimi i masës së sigurimit.[157] Në këtë rast gjykata bën shikimin e shkresave të lëndës dhe vendos që ta caktoj masën e përkohshme të sigurisë, pasi të bindet se paditësi (propozuesi) e ka arsyetuar dhe bazuar propozimin e tij në masën që të jetë i besueshëm për gjykatën edhe në kuptimin e urgjencës edhe në kuptimin e vendosjes për masë të përkohshme të sigurisë.[158]
6. Përmbajtja e dispozitës së nenit 26 (2) jep të kuptohet se masat e përkohshme për sigurimin e kërkesëpadisë do të vlejnë në rastet kur në gjykatë parashtrohen padi për kontestet nga marrëdhënia e punës, ndërsa referenca në Ligjin për konfliktet administrative mundëson zbatimin e dispozitave të këtij ligji përshtatshmërisht në rastet e kontesteve të cilat rezultojnë nga kontestet të cilat kanë për bazë marrëdhëniet e punës nga shërbimi civil.
7. Ndërsa dispozitat e paragrafit 3 kanë për qëllim inkurajimin e sinjalizuesve që të bëjnë raportimin e rasteve të shkeljes ligjore, duke përcaktuar mundësinë që sinjalizuesi të lirohet nga detyrimi i deponimit të garancisë në gjykatë në rastet kur ai parashtron

(Balkan Social Science Review, Skopje) fq. 23. https://js.ugd.edu.mk/index.php/BSSR/article/view/3977/3565
154 Shih Neni 297(1)(b) i Ligjit për Procedurën Kontestimore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 38/20 Shtator 2008,
155 Shih për më tepër neni 306(1) i LPK.
156 Rasti C.nr. 3372/12, Gjykata Themelore në Prishtine.
157 Shih LPK, 306(1).
158 Rasti, C.nr. 255/15, Gjykata Themelore në Prishtinë.

propozimin për masë të sigurimit. Ligji për Procedurën Kontestimore kërkon që propozuesi për caktimin e masës së përkohshme të deponojë një shumë të caktuar të mjeteve (garancionit) brenda afatit të caktuara nga gjykata, me qëllim që të sigurohet kompensimi për ndonjë dëm eventual që mund t'i shkaktohet të paditurit (kundërshtarit të propozimit) me caktimin dhe ekzekutimin e masës së sigurimit.[159] Mirëpo, në rastin e paraqitjes së propozimit nga ana e sinjalizuesit për sigurimin e kërkesëpadisë, sinjalizuesi në bazë të kësaj dispozite, është i liruar nga një detyrim i tillë, dhe nuk kërkohet që ai me këtë rast të bëjë paraprakisht edhe deponimin e mjeteve të nevojshme brenda një afati të caktuar nga ana e gjykatës.

Praktikat më të mira ndërkombëtare

1. Siç u shpjegua më sipër, sinjalizuesit mund të presin kohë të gjatë për ditën e tyre në gjykatë për të provuar se kanë pësuar ndonjë trajtim të padrejtë. Prandaj, është e rëndësishme që sinjalizuesit të kenë një formë të sanimit që nga dita e parë, për t'i kufizuar dëmet e mundshme të pësuara. Disa forma të trajtimeve të padrejta, veçanërisht largimi nga puna, mund të jenë të vështira për t'u kthyer mbrapsht nëse ka kaluar një periudhë e gjatë kohore. Ndihma e përkohshme mund të ndihmojë në ruajtjen e marrëdhënies së punës dhe të parandalojë prishjen e saj plotësisht.[160]
2. Kur një sinjalizues të jetë shkarkuar, ai duhet të ketë të drejtën që të kërkojë masa të përkohshme, të tilla si rikthimi në punë ose vazhdimi i pagesës, derisa kërkesa ligjore të gjykohet ose të zgjidhet.
3. Nësesinjalizuesi është ende i punësuar, ai mund të merr formën e një urdhri që kërkon që punëdhënësi të veprojë ose të ndalojë së vepruari në një mënyrë të caktuar. Pa masë të përkohshme, sinjalizuesi mund të mos jetë në gjendje ta ruajë statusin profesional dhe financiar derisa të përfundojë procedimi gjyqësor. Siç theksohet nga GAP, një sinjalizues mund të falimentojë duke pritur përfundimin e proceseve të apelimit, edhe nëse e kanë fituar seancën e parë gjyqësore ose gjykimin.[161] Kjo mund të jetë pengesë serioze për sinjalizuesit e mundshëm dhe u jep avantazh të padrejtë punëdhënësve, të cilët zakonisht kanë mjete shumë më të mëdha financiare sesa individët.
4. Masa e përkohshme mund të sigurohet nga gjykatat përmes urdhrave të përkohshëm. Duket se kjo është në këtë Ligj

Neni 27

Dispozitat kundërvajtëse

1. **Gjykata kompetente shqipton gjobë prej pesëqind (500) euro deri në njëzetmijë (20.000) euro për institucionin publik apo subjektin privat si dhe autoritetin kompetent përkatës, në rast se:**
   1.1. Nuk mbron sinjalizuesin nga ndonjë veprim i dëmshëm ose nuk ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për ndërprerjen e veprimit të dëmshëm, si dhe eliminimin e çdo pasoje të veprimit të dëmshëm, brenda kompetencave të veta;

159 Shih LPK, 297(2).
160 UNODC, (2015), fq. 64.
161 GAP, (2013), Parimi 15.

1.2. Nuk njofton me shkrim të gjithë të punësuarit, lidhur me të drejtat që parashihen me këtë ligj;
1.3. Nuk cakton zyrtarin përgjegjës;
1.4. Nuk ndërmerr veprime pas raportimit të informacionit brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj;
1.5. Nuk informon sinjalizuesit për rezultatin e procedurës, brenda afatit të përcaktuar;
1.6. Nuk informon sinjalizuesit, sipas kërkesës së tij, lidhur me ecurinë dhe veprimet e ndërmarra në procedurë, ose nuk i mundëson sinjalizuesit që të ketë qasje në shkresat e lëndës dhe që të marrë pjesë në veprimet e ndërmarra gjatë procedurës së sinjalizimit.
1.7. Në rast se pengon sinjalizimin, siç përcaktohet me nenin 6 të këtij ligji;
1.8. Në rast se vepron në kundërshtim me nenin 11 të këtij ligji.

2. Zyrtari përgjegjës i institucionit publik, subjektit privat si dhe i autoritetit kompetent përkatës dënohet me gjobë prej treqind (300) euro deri në dymijë (2.000) euro në rastet kur është përgjegjës sipas nënparagrafëve 1.1, 1.2 dhe 1.4 deri në 1.6 të paragrafit 1 të këtij neni.
3. Kërkesa për fillimin e procedurës së kundërvajtjes paraqitet në gjykatën kompetente nga Agjencia Kundër Korrupsionit për sektorin publik, dhe Inspektorati i Punës për sektorin privat.
4. Nëse brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve institucionet përgjegjëse nuk ndërmarrin asnjë veprim apo refuzojnë të veprojnë, atëherë sinjalizuesi mund të iniciojë vetë procedurën.
5. Nëse personi përgjegjës është recidivist, ndaj tij mund të shqiptohet sanksioni kundërvajtës me gjobë deri në shumën e dyfishuar të paraparë me këtë nen.

Koment, neni 27

1. Neni 27 i Ligjit përcakton gjobat kundërvajtëse dhe procedurat e shqiptimit të tyre. Mirëpo është me rendësi të theksohet fakti se dispozitat e nenit 27 përcaktojnë shqiptimin e gjobave kundërvajtëse lidhur me zbatimin e ligjit për personat fizikë dhe juridikë, dhe jo për personat të cilët kryejnë shkelje ligjore apo shkelin standardet profesionale të punës dhe etikës.
2. Kundërvajtje është sjellja me të cilën shkelet ose rrezikohet rendi dhe qetësia publike dhe vlerat shoqërore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, mbrojta e të cilave nuk është e mundur pa sanksionimin kundërvajtës.[162]Sipas Ligjit për Kundërvajtje, gjoba është sanksioni kryesor kundërvajtës. Gjykata mund të shqiptojë dënim me gjobë për personin juridik (punëdhënësin) të sektorit publik apo privat dhe për personin fizik të personit juridik.
3. Për punëdhënësin e sektorit privat apo publik dhe organin (autoritetin) kompetent, gjykata shqipton gjobë prej pesëqind (500) deri në njëzetmijë (20.000) euro në rastet si vijon: 1) punëdhënësi nuk e mbron sinjalizuesin nga ndonjë veprim i dëmshëm, nuk ndërmerr masat për ndërprerjen e tij apo eliminimin e pasojave t**ë** dëmshme; 2) nuk njofton me shkrim të gjithë të punësuarit lidhur me të drejtat që parashihen në këtë ligj; 3) nuk cakton zyrtarin përgjegjës;[163] 4) nuk ndërmerr veprime pas raportimit të informacionit brenda

162 Neni 2 (1) i Ligjit Nr. 05/l-087 për Kundërvajtje / Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /nr. 33 /8 shtator 2016, Prishtinë.
163 Shih Raporti Vjetor i Punës së AKK-së për vitin 2020, fq- 16-21. Sipas të dhënave të këtij raporti, viti 2020, AKK ka paraqi-

afatit të përcaktuar me këtë ligj; 5) nuk informon sinjalizuesit për rezultatin e procedurës brenda afatit të përcaktuar; 6) nuk informon sinjalizuesin, sipas kërkesës së tij, lidhur me ecurinë dhe veprimet e ndërmarra në procedurë, ose nuk i mundëson sinjalizuesit që të ketë qasje në shkresat e lëndës dhe që të marrë pjesë në veprimet e ndërmarra gjatë procedurës së sinjalizimit; 7) në rast se pengon sinjalizimin dhe 8) në rast se nuk mbron të drejtat e personit të lidhur me sinjalizuesin.

4. Për zyrtarin përgjegjës të institucionit publik, të subjektit privat, si dhe të autoritetit kompetent përkatës, gjykata shqipton gjobë prej treqind (300) euro deri në dymijë (2.000) euro në rastet si vijon: 1) nuk mbron sinjalizuesin nga ndonjë veprim i dëmshëm ose nuk ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për ndërprerjen e veprimit të dëmshëm si dhe eliminimin e çdo pasoje të veprimit të dëmshëm brenda kompetencave të veta; 2) nuk njofton me shkrim të gjithë të punësuarit lidhur me të drejtat që parashihen me këtë ligj; 3) nuk ndërmerr veprime pas raportimit të informacionit brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj; 4) nuk informon sinjalizuesin sipas kërkesës së tij lidhur me ecurinë dhe veprimet e ndërmarra në procedurë, ose nuk i mundëson sinjalizuesit që të ketë qasje në shkresat e lëndës dhe që të marrë pjesë në veprimet e ndërmarra gjatë procedurës së sinjalizimit.
5. Neni 27 (5) përcakton se: "Nëse personi përgjegjës *është* recidivist, ndaj tij mund të shqiptohet sanksioni kundërvajtës me gjobë deri në shumën e dyfishuar të paraparë me këtë nen." Personi përgjegjës ndaj të cilit është shqiptuar sanksioni kundërvajtës edhe më parë dhe përsërit veprimet kundërvajtëse, gjykata i shqipton dënimin me gjobë deri në katërmijë (4.000) euro. Po ashtu, termi *"person përgjegjës"* në kuptim të këtij neni, nuk përfshin vetëm zyrtarin përgjegjës të punëdhënësit në sektorin publik apo privat, por edhe persona tjerë përgjegjës, si titullari i institucionit në raste të caktuara.
6. *Kërkesa* për fillimin e procedurës së kundërvajtjes paraqitet në gjykatën kompetente nga Agjencia Kundër Korrupsionit - për sektorin publik, dhe Inspektorati i Punës[164] për sektorin privat, si dy agjencitë qendrore për zbatimin e këtij ligji. Nëse brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve institucionet përgjegjëse nuk ndërmarrin asnjë veprim apo refuzojnë të veprojnë, atëherë sinjalizuesi mund të iniciojë vetë procedurën.

Praktikat më të mira ndërkombëtare

1. Parashikimi i sanksioneve kundër autorëve të hakmarrjes do të sigurojë përmbarim efektiv dhe mund të jetë një parandalues efektiv për të ardhmen. Praktika më e mirë dikton sanksione të rrepta për ata që hakmerren ose kërcënojnë sinjalizuesit. Nga punëdhënësit duhet të kërkohet që të marrin masa disiplinore kundër hakmarrësve. Në Itali, hakmarrësit në sektorin publik përballen me gjobë administrative. Në Australi, legjislacioni parashikon sanksione penale.
2. Parimi 29 i TI parashikon që çdo veprim i hakmarrjes ose ndërhyrje në zbulimin e sinjalizuesit do të konsiderohet sjellje e pahijshme, dhe autorët e hakmarrjes do t'i nënshtrohen sanksioneve të punësimit/profesional dhe dënimeve civile.[165]

---

tur 23 kërkesa për fillimin e procedurës së kundërvajtjes në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Kundërvajtje, ndaj institucioneve publike të cilat nuk kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për sinjalizim brenda afatit të paraparë ligjor . https://www.akk-ks.org/assets/cms/uploads/files/Publikimet/Raporte/3.%20Raporti_Vjetor_AKK_2020_Shqip.pdf.

164 Neni 2 i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës përcakton: Inspektorati i Punës mbikëqyr zbatimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore në lëmin e punës në mënyrë gjithëpërfshirëse, duke përfshinë marrëdhëniet e punës, sigurinë në punë, mbrojtjen e shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës. Ligji Nr. 03/l-017 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës nr. 2002/9. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti iii / Nr. 37 / 10 shtator 2008

165 Transparency International, (2018).

KAPITULLI V - Dispozitat Kalimtare dhe Përfundimtare

Neni 28

Vetëdijësimi i të punësuarve

1. **Punëdhënësi është i obliguar t'iu sigurojë të punësuarve udhëzime me shkrim lidhur me procedurat për sinjalizimin.**
2. **Udhëzimet nga paragrafi 1 i këtij neni si dhe çdo informacion tjetër i dobishëm lidhur me sinjalizimin publikohen dhe përditësohen rregullisht dhe shpërndahen përshtatshmërisht në mjediset e punëdhënësit dhe në faqe të internetit kur është e mundur teknikisht.**

Koment i nenit 28

1. Neni 28 përcakton detyrimin e punëdhënësit për të siguruar udhëzimet e duhura me shkrim lidhur me procedurat e sinjalizimit për të punësarit e tyre. Për zbatimin e Ligjit është thelbësore që të punësuarit të kenë njohuri lidhur me procedurat e sinjalizimit. Mekanizmat e raportimit të sinjalizuesve duhet të shoqërohen nga politika efektive të mbrojtjes së sinjalizuesve. Mirëpo, në përgjithësi ligji përcakton se punëdhënësi ka detyrim që të punësuarve t'iu sigurojë udhëzime me shkrim apo çfarëdo informacioni të dobishëm i cili ndihmon në lehtësimin e zbatimit të ligjit.
2. Lidhur me zbatimin në praktik të këtij neni, institucioneve publike u është dërguar nga Agjencia Kundër Korrupsionit përgjegjëse, Udhëzuesi për Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Ky dokument iu është shpërndarë nga njesitë/strukturat përkatëse të burimeve njërzore tek të punësuarit në institucion përkates publik përkatës dhe i një edhe është publikuar në ueb faqet zyrtare të insitucioneve.[166]
3. Për sa i përketë vetëdijesimit të punësuarëve në sektorin privat, në bazë të dhënave hulumtuëse, rezulton se të punësuarit në sektorin privat nuk kishin pranur udhëzime rreth procedurave të sinjalizimit nga punëdhënesi. Për me tepër ata në përgjithësi nuk kishin njohuri as për procedurën e sinjalizimit dhe as të mbrojtjes se tyre.[167]

Praktikat më të mira ndërkombëtare

1. Studime të ndryshme kanë treguar se shumica e sinjalizuesve përdorin së pari mekanizma të brendshëm të raportimit. Punëdhënësi është shpesh vendi më i mirë për t'u marrë me keqbërjet brenda organizatës së tyre. Kjo është arsyeja pse nga organizatat e sektorit publik dhe privat duhet të kërkohet, ose të paktën të inkurajohen fuqimisht nga ligjvënësi, që ta vendosin një mekanizëm efektiv të raportimit të brendshëm. Shumica e ligjeve për mbrojtjen e sinjalizuesve e bëjnë këtë të detyrueshme për organizatat e sektorit publik.

166 Agjencia Kundër Korrupsionit në muajin nëntor 2019, ka shpërndarë tek institucionet publike "Udhëzuesin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve", i përgatitur në bashkëpunim me Projektin Kundër Krimit Ekonomik - PECK II. Udhëzuesi është publikuar në faqet zyrtare të shumë institucioneve publike. Udhëzuesi për Mbrojtjen e Sinjalizuesve.
Autor: Wim Vandekerckhove, Ekspert i Këshillit të Evropës. Udhëzuesi mund të klikohet në linkun si në vijim: https://rm.coe.int/handbook-on-protection-of-whistleblowers-alb/168097ed0c

167 Teuta Zymeri & Nur Çeku, *"A po zbatohet Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në Kosovë?"*,(Qëndra Fit, Prishtinë, 2020). https://fit-ks.org/publikimet-2/.

2. Në Holandë, legjislacioni përfshinë standardet minimale që politika e brendshme duhet të plotësojë.[168] Në Francë, kjo u bë përmes dekretit zbatues.[169]
3. Ky Ligj inkurajon punëdhënësit që të zbatojnë procedurat e sinjalizimit me udhëzimet e duhura me shkrim dhe të shpërndara dhe botuara në mënyrë të përshtatshme. Sidoqoftë, ai nuk përcakton standardet minimale për procedurat e sinjalizimit të brendshëm dhe për këtë arsye nuk plotëson praktikat më të mira aktuale.

Neni 29

Raporti vjetor

1. **Institucionet publike, subjektet private si dhe rregullatorët sipas fushës në të cilën bëhet sinjalizimi, përgatisin raport vjetor lidhur me sinjalizimin për vitin paraprak deri më 31 dhjetor.**
2. **Raporti vjetor nga paragrafi 1 i këtij neni i paraqitet Agjencisë Kundër Korrupsionit më së voni deri me 31 janar të vitit vijues.**
3. **Agjencia Kundër Korrupsionit përgatit dhe publikon raport vjetor të përgjithshëm lidhur me sinjalizimin për vitin paraprak deri më 31 mars të vitit vijues.**
4. **Raporti vjetor nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni përmban:**
   4.1. numrin e raportimeve dhe shpalosjeve në interes publik;
   4.2. veprimet e ndërmarra në lidhje me ato raportime apo shpalosje.

Koment, neni 29

1. Neni 28 ka për qëllim dhe objekt kryesor mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit, përmes raportimit vjetor. Secili institucion publik, subjekt privat apo rregullator i cili ka autoritet për të pranuar sinjalizimin, detyrohet të përgatisë raportin vjetor deri më 31 dhjetor. Ky raport përmban numrin e raportimeve dhe shpalosjeve gjatë periudhës 1 vjeçare dhe veprimet e ndërmarra lidhur me trajtimin e tyre. *Veprimet e ndërmarra* mund të jenë: refuzimi i kërkesës; njoftim i organit kompetent; procedura kundërvajtëse; etj.
2. Këto raporte i paraqiten Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK) si autoriteti kryesor kombëtar për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit. AKK duhet të përgatisë dhe publikojë raportin e përgjithshëm lidhur me sinjalizimin deri më 31 mars të vitit vijues. Sipas standardeve të punës, AKK e publikon raportin vjetor për sinjalizimin në kuadër të raportit të përgjithshëm të punës.[170] Raportimet vjetore lidhur me sinjalizimin janë të rëndësishme, sepse pasqyrojnë nivelin e zbatimit të Ligjit.
3. Në perspektivën e zbatimit të Ligjit, rol të rëndësishëm do të ketë edhe mbikëqyrja nga Komisioni arlamentar përkatës për legjsilacion. Sipas Rregullores së Kuvendit, komisionet parlamentare brenda fushës së përgjegjësive të tyre, janë të autorizuara të mbikëqyrin zbatimin e ligjeve nga Qeveria, përkatësisht nga ministria. Autoriteti i komisionit funksional për zbatimin e ligjit bëhet nën dritën e këtyre kritereve: (a)

168 Teksti i plotë i ligjit (në Holandisht) mund të gjendet në http://wetten.overheid.nl/BWBR0037852/2016-07-01.
169 Dekreti Nr. 2017-564 i datës 19 prill 2017 për procedurat për mbledhjen e informatave shpjeguese të sinjalizuesve në organizata publike ose private ose administratë shtetërore, neni 5. Teksti në frëngjisht është në dispozicion në https://www.legifrance.gouv.fr/eli/decret/2017/4/19/ECFM1702990D/jo/texte..
170 Raportin Vjetor i Punës së AKK-së për vitin 2020, fq- 16-21.

efektiviteti i zbatimit te ligjit dhe propozimi i masave konkrete; (b) përgatisin listën e detyrave që duhet të ndërmerren nga qeveria që duhet të zbatohen nga Qeveria, listën e vendimeve të Qeverisë se këto dispozita zbatohen. (c) raportojnë me shkrim dhe me gojë një herë në vit në mbledhjet plenare të Kuvendit.[171]

4. Poashtu edhe vlerësimi *ex post* nga Ministria e Drejtësisë, në të ardhmen, mund të ketë rol të rëndësishëm lidhur me nivelin e zbatimit të ligjit. Vlerësimi *ex post* i referohet kryesisht vlerësimit të performancës nëse objektivat, efektet e ndërmarra, kostot dhe përfitimet e një pjese të një legjislacioni janë aktualizuar, dhe të identifikojë çfarëdo vështirësie apo efekti që ka rezultuar nga legjislacioni.[172]

Praktikat më të mira ndërkombëtare

1. Sipas Parimit 25 të TI, autoriteti i ankesave të sinjalizuesit duhet të mbledhë dhe publikojë rregullisht (të paktën çdo vit) të dhëna dhe informacione në lidhje me funksionimin e ligjeve dhe kornizave të sinjalizuesve (në përputhje me ligjet përkatëse të privatësisë dhe mbrojtjen e të dhënave). Ky informacion duhet të përfshijë numrin e rasteve të pranuara; rezultatet e lëndëve (d.m.th. pushohen, pranohen, hetohen, vërtetohen); kompensimi dhe rikuperimi (ruajtja e konfidencialitetit, nëse kërkohet nga sinjalizuesi); përhapja e keqbërjes në sektori publik dhe privat; ndërgjegjësimi dhe besimi në mekanizmat e sinjalizuesit; dhe kohën e nevojshme për të proceduar çështjet.[173]
2. Kjo dispozitë e Ligjit kërkon që autoritetet të mbledhin dhe botojnë për çdo vit të dhëna dhe informacione mbi numrin e zbulimeve dhe veprimet e ndërmarra për ato zbulime. Mungesa është detyrim për të publikuar të dhëna për kompensim dhe rikuperime dhe vetëdijen dhe besimin në mekanizmat e sinjalizuesit. Për më tepër, mungon shënimi se informacioni i botuar po e ruan konfidencialitetin dhe është në përputhje me ligjet përkatëse të privatësisë dhe mbrojtjen e të dhënave. Kjo dispozitë e Ligjit nuk i përmbushë plotësisht praktikat e mira.

Neni 30

Aktet nënligjore

1. **Aktet nënligjore për zbatim të këtij ligji do të nxjerren brenda gjashtë (6) muajve prej ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.**
2. **Në afat prej gjashtë (6) muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, punëdhënësit sipas këtij ligji, caktojnë zyrtarët përgjegjës për sinjalizim dhe e njoftojnë AKK-në për sektorin publik, përkatësisht Inspektoratin e Punës për sektorin privat.**
3. **Agjencia Kundër Korrupsionit dhe Inspektorati i Punës obligohen të fillojnë procedurat sipas ligjit për kundërvajtje ndaj punëdhënësve dhe zyrtarëve përgjegjës të cilët nuk i kanë përmbushur obligimet sipas këtij ligji, jo më vonë se gjashtë (6) muaj.**

171 Neni 73 [Autoriteti i komisioneve për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve] të Rregullores së Kuvendit (2010), https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Files/6/Rr_K_RK_29_04_2010_1_EDbu8aqXYd.pdf.
172 Udhërrëfyes për vlerësimin *ex-post* të legjislacionit në Republikën e Kosovës, (2014). http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Udherrefyesi_per_vleresimin_ex-post_te_legjislacionit_ne_Republiken_e_Ko....pdf.
173 Transparency International, (2013).

